



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 715 Akti

Nr. 786 Vendimi
Tiranë, më 18.7.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Genta Tafa (Bungo)	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 16.7.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Neritan Hoxha**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës të Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në

vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Neritan Hoxha, aktualisht me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës të Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, është subjekt rivlerësimi që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Neritan Hoxha, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 24.12.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuesja, komisionerja Suela Zhegu, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga asnjë prej anëtarëve të trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Neritan Hoxha.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin Neritan Hoxha nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V “Kontrolli i figurës” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI “Vlerësimi i aftësive profesionale” të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK); Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP).

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Neritan Hoxha. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurive;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11. Agjencia Kombëtare për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar fillimisht një raport me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 14.10.2022, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës. Në vijim, AKSIK-ja ka dërguar raportin me shkresën nr. *** prot., datë 23.1.2023, deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së nr. **, datë 30.1.2023, me konstatimin për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit, z. Neritan Hoxha, për vazhdimin e detyrës.

12. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm² e të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 13.6.2024 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes dhe rezultatet e hetimit në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

15. Subjekti i rivlerësimit u njoftua me anë të postës elektronike të datës 13.6.2024 mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 31.12.2019.

² Me shkresën nr. *** prot., datë 7.2.2023.

ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti është pajisur me materialet e dosjes në datën 14.6.2024.

16. Në datën 19.6.2024 me anë të postës elektronike, subjekti paraqiti kërkesën e datës 18.6.2024, me objekt “Urdhërimin dhe/apo kërkimin nga ana e Komisionit të deklasifikimit të informacionit të administruar në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Neritan Hoxha pranë AKSIK-së apo çdo institucioni tjetër; Njohjen dhe vënien në dispozicion të gjithë dokumentacionit të administruar në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Neritan Hoxha, pranë AKSIK-së apo çdo institucioni tjetër”.

16.1 Komisioni në lidhje me këtë kërkesë vlerësoi se në frymën e jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit³, si dhe me qëllim respektimin e të drejtës për t’u mbrojtur dhe dëgjuar, i ka kaluar barrën e provës subjektit në mënyrë të qartë. Nga leximi i integruar i pjesëve të raportit është evidente ndërlidhja e rezultateve të hetimit administrativ për kontrollin e figurës me ato të vlerësimit të aftësive profesionale, për të cilat subjektit i ka kaluar barra e provës. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se mosnjohja e subjektit me të dhënat e plota që pasqyrohen në informacionin e klasifikuar nuk cenon thelbin e të drejtave të tij për t’u mbrojtur, sipas vlerësimit të jurisprudencës së GjEDNJJ-së në çështjen Regner kundër Republikës Çeke, duke e bërë të panevojshëm deklasifikimin e plotë të raportit të AKSIK-së apo vënien në dispozicion të subjektit të informacionit sekret. Për më tepër, trupi gjykues vlerëson se ekspozimi i plotë i këtij informacioni do të cenonte paprekshmërinë dhe sigurinë e burimeve të këtij informacioni. Në këtë kuptim, kufizimi i të drejtës së subjektit për t’u njohur është proporcional dhe në përputhje me garancitë për një proces të rregullt ligjor nën dritën e parashikimeve të KEDNJ-së. Në përfundim, Komisioni vlerëson se kërkesa e subjektit nuk është e mbështetur në ligj dhe në prova dhe, për këtë arsye, duhet të refuzohet.

17. Në datën 24.6.2024, subjekti kërkoi shtyrjen e afatit për të sjellë prova dhe shpjegime lidhur me rezultate e hetimit. Kërkesa e subjektit u pranua, duke iu caktuar si afat data 8.7.2024.

18. Subjekti në datën 09.07.2024 ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit.

19. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore⁴.

II. SEANCA DËGJIMORE

20. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *email* në datën 11.7.2024.

21. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 16.7.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma.

22. Subjekti i rivlerësimit, z. Neritan Hoxha, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer

³ Vendim nr. 38/2023 dhe nr. 31/2022.

⁴ Vendim i ndërmjetëm nr. 4, datë 10.7.2024.

ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

23. Z. Neritan Hoxha ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

24. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

25. Referuar vendimit nr. 2/2017⁵ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

26. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shpresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shpresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ; (e) shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura gjatë seancës dëgjimore.

A. VLERËSIMI I PASURISË

27. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së subjektit. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e

⁵ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

27.1 Subjekti ka filluar detyrën në datën 11.10.2004 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

27.2 Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 30.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se posedojnë pasuritë si vijon:

28. Pasuria nr. *** në z. k. ***, Tiranë, përbërë nga truall me sipërfaqe 300 m² + 100 m² shtëpi banimi mbi të. Vlera: 1.800.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: Kursime personale dhe familjare (pa filluar funksionin).

Konstatimi i ILDKPKI-së:

- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit të shumës 1,800,000 lekë nga kursimet personale dhe familjare, shumë e cila ka shërbyer për blerjen në vitin 1998 të truallit me sip. 300m² + shtëpi banimi me sip. 100 m², Tiranë. Gjithashtu, organet tatimore nuk konfirmojnë të ardhura të realizuara nga aktiviteti privat i prindërve të subjektit.*

Hetimi⁶ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

29. Me kontratë shitjeje nr. ***, datë 28.5.1998, subjekti i rivlerësimit (para fillimit të detyrës) ka blerë truall me sipërfaqe 300 m² dhe shtëpi banimi që ndodhet brenda këtij trualli, me sipërfaqe 100 m², regjistruar me nr. pasurie ***, ndodhur në zonën kadastrale ***, Selitë, Tiranë.

29.1 Në përmbajtje të kontratës së shitblerjes palët kanë përcaktuar se çmimi i shitjes së truallit dhe shtëpisë së banimit është 1,800,000 lekë, i cili është likuiduar dhe palët nuk kanë më detyrime të ndërsjella mes tyre.

29.2 Si burim për blerjen e këtij apartamenti në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar kursime personale dhe familjare.

Nga hetimi i Komisionit në lidhje me të ardhurat familjare të subjektit ka rezultuar:

30. QKB-ja⁷ informon se:

- *R.H figuron i regjistruar si person fizik, pajisur me NIPT K***R.*

Nga verifikimi i ekstraktit rezulton se është regjistruar në datën 19.11.2009, me fushë veprimtarie ripopullim-peshkim, vozitje, shëtitje turistike me varkë në liqenin e Belshit. Adresa e ushtrimit të aktivitetit është Elbasan, Belsh, banesë private, pranë shkollës “N.Sh”.

Subjekti në përgjigje të pyetësorit nr.1 nuk rezulton të ketë deklaruar si pasuri të prindërve të tij këtë banesë duke iu kërkuar shpjegime.

⁶ Shkresë nr. ***prot., datë 28.1.2021, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; shkresë kthim përgjigjeje e ASHK Tirana Rurale 1 nr. *** prot., datë 22.2.2021; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2020, drejtuar ILDKPKI-së; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 11.3.2021, e ILDKPKI-së; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar UKT-së dhe UKE-së; kthim përgjigjeje e UKT-së nr. K-*** prot., datë 9.2.2021; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar FSHU-së; kthim përgjigjeje e FSHU-së nr. *** prot., datë 15.2.2021.

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 9.2.2021.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit⁸, subjekti shpjegoi se⁹ ushtrimi i aktivitetit vë në funksion vetëm përdorimet e varkave dhe vozitjen e tyre në liqen dhe nuk ka një godinë përkatëse që përdoret për qëllime të saj. Ndërkohë që në kushtet kur kërkohet përcaktimi i një vendndodhjeje të saktë, babai i tij ka deklaruar vendin e ankorimit të tyre, që gjendej pranë një banese private në shkollën “N.Sh”, duke e pasqyruar vendndodhjen me qëllim që të jetë lehtësisht e aksesueshme dhe e gjatshme për palë të treta. Kjo është vendndodhja ku ankorohen varkat me qëllim nisjen e tyre për vozitje apo për peshkim. Për aq sa e ka informuar babai, kjo vendndodhje është përcaktuar për efekt të regjistrimit të selisë kryesore të ushtrimit të aktivitetit të tij tregtar.

- *Gjithashtu, R.H, figuron të jetë ortak dhe administrator në shoqërinë “B” sh.p.k., regjistruar me vendimin nr. *** në maj 1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor T, për të cilën nuk u gjend NIPT.*

31. DTR Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 26.2.2021, konfirmon se shtetasi R.H, me NIPT K***R, figuron i regjistruar si tatimpagues pranë këtij institucioni, me datë regjistrimi 19.11.2009, me aktivitet “Tregti me pakicë e peshkut, gaforreve dhe molusqeve”, me status person fizik. Të ardhurat, shpenzimet, humbjet dhe fitimi janë deklaruar në tabelën si më poshtë:

Viti	Të ardhura	Shpenzime	Fitim/humbje
2009	50,000	40,000	1000
2014	0	68,605	-68,605
2015	1,730,631	985,100	755,531
2016	958,240	670,520	287,720
2017	1,947,820	926,770	1,021,050
2018	1,379,225	636,850	742,375
2019	1,257,000	161,965	1,095,035

32. Bashkia Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2017, konfirmon se shtetasi R.H nuk është regjistruar në sistemin e DTTV-së pranë kësaj bashkie.

32.1 Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 1¹⁰ në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie, ka sqaruar se: “Si burim për blerjen e pasurisë nr. **, S, Tiranë, siç edhe kam

⁸ Për më shumë referojuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

⁹ Subjekti ka depozituar kthim përgjigjen e QKB-së nr. *** prot., datë 2.7.2024.

¹⁰ Subjekti ka vënë në dispozicion: (i) kontratë privatizimi datë 20.8.1993, nëpërmjet së cilës prindërit e subjektit kanë blerë apartament 2+1 për shumën 18,020 lekë; (ii) kontratë shitjeje apartamenti datë 17.9.1996, sipas së cilës prindërit e subjektit kanë shitur apartamentin e mësipërm për shumën 670,000 lekë; (iii) shkresë nr. ** prot., datë 26.4.2024, Shoqëritë Huamarrëse në Administrim, Tiranë; (iv) procesverbal datë 13.1.1997 në filialin e fondacionit “P”; (v) procesverbal i dorëzimit të vlerave monetare datë 24.1.1997; (vi) procesverbal datë 26.2.1997; (vii) disa mandate pa datë, të cilat nuk janë të firmosura dhe të vulosura nga shoqëria; (viii) kopje e dosjeve të pensionit për prindërit R e N.H; (ix) shkresë nr. ** prot., datë 19.10.1995, e Këshillit të Rrethit Elbasan; (x) shkresë nr. ** prot., datë 16.10.1992, e Këshillit të Rrethit Elbasan; (xi) leje peshkimi artizanale datë 4.10.1993; (xii) certifikatë regjistrimi në organin tatimor për shoqërinë “B”, viti 1995; (xiii) vendim nr. **, maj 1995, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (xiv) vendim nr. *** prot., datë 27.2.1996, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; (xv) shkresë nr. *** prot., datë 30.4.2024, e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; (xvi) licencë për vitin 1996 në emër të babait të subjektit dhe për vitet 1997 – 1998 në emër të shtetasit F.F dhe babait të subjektit, me nr. peshkatarësh 2; (xvii) formular SVA i vitit 1996, në të cilin shoqëria “B” sh.p.k. deklaroi të ardhura në vlerën 70,000 lekë dhe 13 peshkatarë; (xviii) formular SV2 i viteve 1997 dhe 1999, në të cilët babai i subjektit dhe shtetasi F.F deklaroi të ardhura në shumën 150,000 lekë për vitin 1997 dhe në shumën 640,000 lekë për vitin 1999. Në këto formulare titullar i licencës rezultoi shtetasi F.F; (xix) licencë peshkimi e vitit 1996 në emër të shtetasit R.H; (xx) licencë peshkimi e viteve 1997 – 2000 dhe 2003 në emër të shtetasve R.H dhe F.F; (xxi) licencë peshkimi e vitit 2002 në emër të shtetasve M.H, F.F dhe R.H; (xxii) licencë peshkimi e vitit 2004 në emër të shtetasit R.H; (xxiii) kontratë për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës, datë 28.7.2016; (xxiv) plan biznesi i vitit 2009, ku fitimi parashikohet në vlerën 446,784 lekë; (xxv) shkresë nr. *** prot., datë 7.5.2024, e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Elbasan.

deklaruar më parë, kanë shërbyer të ardhurat e familjes dhe prindërve, si dhe kursimet familjare... Nga dokumentacioni që prindërit kanë ruajtur në banesë, nga babai janë dorëzuar në atë periudhë në ministrinë që lëshonte licencën formularët tip në lidhje me sasitë e peshkut të tregtuar. Sipas këtyre të dhënave të deklaruara rezulton një e ardhur rreth 800,000 – 900,000 lekë minimalisht për periudhën 1995 – 1998... Kursimet e familjes dhe të ardhurat e babait në fondacionin “P” janë investuar në shoqëritë piramidale të asaj periudhe, si në vetë fondacionin “P”, te fondacioni “Xh” dhe shoqëria huamarrëse “V”, ku janë përfutur të ardhura të konsiderueshme, sipas kushteve kontraktore të ofruara nga këto shoqëri në atë kohë.

*Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Shoqëritë Huamarrëse në Administrim, me shkresën nr. ** prot., datë 26.4.2024, rezulton se babai R.H ka depozituar te kompania “V” shumën 500,000 lekë, nga të cila janë tërhequr 160,000 lekë deri në janar 1997. Gjithashtu konfirmojnë faktin se babai ka qenë i punësuar te fondacioni “P”, filiali B, por nuk disponojnë të dhëna në lidhje me pagesën që ai ka marrë si i punësuar. Nga dokumentacioni që disponon babai në banesë rezulton se ai ka punuar te “P” për rreth 4 muaj, ka depozituar në llogarinë e këtij fondacioni një shumë prej 167,890,000 lekësh dhe sigurisht është paguar për këtë periudhë. Siç rezulton nga dokumentacioni bashkëngjitur (të cilin e disponoj në origjinal dhe nëse është e nevojshme jua paraqes), babai dhe familja e tij kanë përfutur minimalisht 1,200,000 lekë.*

Unë, vëllai G.H, si dhe babai R.H kemi shkuar si emigrantë në shtetin grek për periudha të ndryshme kohore, ku dhe kemi siguruar të ardhura nga emigrimi (unë e kam deklaruar qëndrimin tim në Greqi edhe në deklaratën e kontrollit të figurës të vitit 2016)”.

33. Komisioni, në lidhje me shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1, ka konstatuar se:

i. Prindërit e subjektit me kontratë shitjeje apartamenti datë 17.9.1996 kanë shitur apartamentin në pronësinë e tyre për shumën 670,000 lekë.

Bazuar në shkresën nr. ** prot., datë 26.4.2024, të Shoqërive Huamarrëse në Administrim Tiranë, babai i subjektit ka depozituar tek shoqëria “V” shumën 500,000 lekë, në datën 18.9.1996, e cila duket se e ka burimin nga shitja e shtëpisë. Nga kjo shumë ai ka tërhequr shumën 160,000 lekë, duke mbetur gjendje shuma 340,000 lekë.

Bazuar në këto të dhëna, ndryshe nga sa ka deklaruar subjekti, të ardhurat nga shitja e apartamentit nuk kanë shërbyer për blerjen e banesës, pasi vlera prej 340,000 lekësh ka mbetur gjendje në shoqërinë “V”. Në analizën financiare do të përfshihet vetëm shuma 330,000 lekë, e përbërë nga shuma 170,000 lekë (diferenca e çmimit të shitjes së apartamentit) dhe shuma 160,000 lekë, e tërhequr nga shoqëria “V”.

ii. Në lidhje me të ardhurat e përfutuara nga firmat piramidale, bazuar në:

- a. Procesverbalin datë 13.1.1997, në filialin e fondacionit “P”, ku si përfaqësues i filialit rezulton shtetasi R.H, rezulton se janë paguar 47 persona me vlerën e dyfishit të shumës së arkëtuar, pa ardhur afati i maturimit, duke paguar më tepër shumën 4,050,000 lekë;
- b. Procesverbalin datë 26.2.1997, sipas së cilit janë kryer 80 pagesa para afatit, pa urdhër të presidentit të fondacionit “P” dhe në mandate nuk ka asnjë shënim as për datën e pagesës dhe as urdhëruesin e kësaj pagese. Shuma e përfutur padrejhtësisht mbi principalin është 5,918,000 lekë, e cila është dëm pasuror i shkaktuar fondacionit “P”.

Në 19 raste nga misionari R.H janë paguar si vetë, bashkëshortja, vëllai, fëmijët, kunata dhe katër raste miq, ku padrejtësisht është përfituar shuma mbi principalin, në vlerën 1,458,000 lekë.

- Konstatohet se ato janë përfituar padrejtësisht, për rrjedhojë, për sa kohë këto pagesa nuk janë konsideruar si të ligjshme, ato nuk mund të përfshihen në analizën financiare, pasi nuk përmbushin kriteret e përcaktuar nga neni D/3 i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

iii. Në lidhje me të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga aktiviteti i peshkimit, konstatohet se:

- a. Janë deklaruar për efekt të lejes së peshkimit pranë Drejtorisë së Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë.
- b. Për vitet 1997 dhe 1999 janë deklaruar nga shtetasi F.F dhe jo nga babai i subjektit.
- c. Këto të ardhura hipotetikusht nuk i përkasin vetëm babait të subjektit, pasi licencat e peshkimit për këtë periudhë janë lëshuar në emër të babait dhe shtetasit F.F dhe përbëjnë vetëm qarkullim deklarativ për efekt pajisjeje me licencë peshkimi, si dhe nuk përbëjnë fitimin neto pas zbritjes së shpenzimeve të aktivitetit (ku në vitin 1996 shoqëria “B” ka pasur të punësuar 13 peshkatarë) dhe pagimin të detyrimeve përkatëse tatimore.
- d. Në organet tatimore nuk rezulton të jetë deklaruar fitim në lidhje me aktivitetin e peshkimit, si dhe të jenë paguar detyrimet tatimore.

Për sa më sipër, Komisioni nuk do t’i përfshijë në analizën financiare këto të ardhura.

34. Komisioni ka përfshirë në analizën financiare për blerjen e kësaj pasurie vetëm ato të ardhura për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, si dhe provohet krijimi i tyre.

34.1 Nga analiza financiare¹¹ duket se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e pasurisë banesë, në vlerën -1,473,669.40 lekë.

35. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi¹² se: *“Sikundër ka rezultuar nga hetimi i Komisionit, kjo pasuri është krijuar në vitin 1998, në një kohë e periudhë e cila është para fillimit të detyrës, në një kohë kur ai ishte ende student dhe jashtë procesit të rivlerësimit. Nuk mund të penalizohet për pasaktësi apo pamundësi të provuari për shkak të mungesës së dokumentacionit, të cilat i takojnë një periudhe jashtë detyrës dhe për më tepër për veprime të kryera mbi 19 vjet më parë.*

Sa i takon deklarinimit të kësaj pasurie dhe burimit të të ardhurave për krijimin e saj, subjekti sqaron Komisionin se:

- i. *Në kohën e blerjes së këtij apartamenti studionte në Fakultetin e Drejtësisë dhe përfitonte bursë studimi. Për të marrë të dhëna mbi masën e bursës nga të dyja fakultetet përkatëse, i është drejtuar në formë shkresore këtyre institucioneve. Në përgjigje të tyre, fakultetet e kanë informuar se nuk kanë të dhëna mbi bursën. Nga të dyja dokumentet rezulton se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të provuar para Komisionit masën e*

¹¹ Shihni tabelë nr. 1 të rezultateve të hetimit.

¹² Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

bursave të akorduara nga këto dy universitete e, për këtë arsye, deklararon se gjatë vitit shkollor 1996 – 1999 është trajtuar me bursë me një vlerë 6,000 lekë/muaj. Gjithashtu, gjatë studimeve ka jetuar në konvikt, duke paguar një vlerë simbolike, si në qytetin e Elbasanit, ashtu edhe të Tiranës, dhe është trajtuar me ushqim nga mensat e fakulteteve përkatëse. Të dyja këto shpenzime janë të përfshira në shpenzimet e jetesës.

Duke kryer një analizë financiare mbi të ardhurat dhe kursimet gjatë periudhës shtator 1996 – maj 1999, mundësia e tij për kursim ka qenë në vlerën 55,080 lekë.

- ii. Banesa de juro është regjistruar në emrin e tij si djali i madh i familjes, në kushtet kur babai në atë periudhë nuk ka qenë në Shqipëri për shkak të emigrimit të tij në shtetin grek. Ndërkohë që për blerjen e saj ai ka dhënë kontributin modest në familje, duke dhënë çdo tepricë që mbetet, pasi plotësonte shpenzimet e jetesës, si çdo student. Gjithashtu, ka dhënë kontribut në familje edhe nga të ardhurat nga emigracioni në Greqi, ku shkonte të punonte gjatë muajve të verës. Kështu që prindërit i kanë menaxhuar këto të ardhura së bashku me çdo të ardhur tjetër e cila hynte në familje. Duke qenë se kjo pasuri ka vijuar të jetë e regjistruar në emrin e tij edhe në momentin e dorëzimit të deklaratës Vetting, e ka deklaruar atë duke specifikuar detajet përkatëse të saj, ekstremitetet e çmimit dhe të vendndodhjes, si dhe burimin e krijimit të pasurisë.*
- iii. Sikurse rezulton nga aktet e administruara në dosje, që prej datës 4.10.1993 babai i tij, së bashku me 13 ortakë të tjerë, ka krijuar shoqërinë “B” sh.p.k. për ushtrimin e aktivitetit të zënies së peshkut, një aktivitet afatgjatë dhe që ka pasur vijueshmëri për shumë vite në vazhdim... Referuar dokumentacioneve rezulton se shoqëria “B” sh.p.k. dhe personi fizik “R.H” ka ushtruar aktivitetet dhe veprimtari të ligjshme përgjatë gjithë kësaj periudhe, në mënyrë të pandërprerë dhe është pajisur me licencat përkatëse ujore. Sa i takon të ardhurave nga peshkimi për vitet 1994 deri në vitin 1998, kur është blerë banesa, vetë organet publike deklarojnë se ka mungesë informacioni, nisur kjo edhe nga koha e gjatë që ka kaluar, duke u gjendur kështu, deklararon subjekti, në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.*
- iv. Për të përcaktuar fitimin e të gjitha viteve që po analizohen, Komisioni do duhej të ishte bazuar në normën e fitimit të personit fizik “R.H” për vitet në të cilat i disponon këto të dhëna. Bazuar në të dhënat e DRT Elbasan, përcjellë Komisionit, janë pasqyruar të ardhurat dhe fitimi i shoqërisë “B” sh.p.k. për periudhën 2009 – 2014 deri në vitin 2023. Nga këto të dhëna mund të llogaritet norma mesatare e fitimit, bazuar në vitet e vijueshme 2015 – 2023, por duke e përjashtuar vitin 2014. Ky përjashtim i vitit 2014 duhet bërë pasi atë vit babai i tij nuk ka punuar në pjesën më të madhe të vitit, pasi ka bërë një ristrukturim/riorganizim të aktivitetit të tij e prandaj biznesi i tij nuk ka përfituar asnjë të ardhur. Duke përlllogaritur një mesatare të normës së fitimit për vitet 2015 – 2023, të cilat janë 8 vite konsekuetive, duke u bërë kështu përfaqësuese të normës së fitimit nga ky biznes, ajo do të rezultonte në masën 68.42%. Komisioni do të duhet ta aplikojë këtë normë fitimi, e cila shpreh tendencën reale të biznesit, edhe për ato vite kur nuk ka të dhëna mbi fitimin, por vetëm mbi qarkullimin e biznesit (pra edhe për vitet 1995, 1997 dhe 1999), por edhe për vitet 1996 dhe 1998, kur qarkullimi është llogaritur bazuar në vitet e afërta, kur ka të dhëna. Sipas këtyre përlllogaritjeve, të ardhurat neto të babait të tij nga aktiviteti privat për periudhën 1995 – 1999 janë në vlerën 942,792 lekë.*

Konstatimi i Komisionit se të ardhurat “rezultojnë të jenë deklaruar nga z. F dhe jo nga babai i subjektit për vitet 1997 dhe 1999”, është i pasaktë, pasi referuar formularëve përkatës SB5 për të katërta vitet 1996 – 1997 – 1998 rezulton se babai i tij është subjekt dhe titullar i vetëm i licencës për të tria vitet, ku ka deklaruar dhe nënshkruar për vitet 1996 – 1998 dhe natyrshëm do të ishte subjekt deklarues dhe nënshkruer edhe për vitin 1999, ku për këtë vit është deklaruar personi fizik dhe juridik F.F dhe R.H dhe në fund të këtij formulari ka nënshkruar njëri prej tyre.

- v. *Për sa i përket shoqërisë “V”, nga Komisioni aludohet se shuma e depozituar prej 500,000 lekësh në datën 18.9.1996 nga babai i tij duket se e ka burimin nga shitja e shtëpisë një ditë para dhe nga kjo shumë ai ka tërhequr vetëm pjesën prej 160,000 lekësh, duke mbetur gjendje shuma 340,000 lekë... Nuk ka asnjë provë që kjo depozitë buron pikërisht nga shuma e përftuar nga shitja e banesës.*
- vi. *Nga dokumentacioni që ka mundur të ruajë babai në banesë rezulton se ai ka punuar tek “P” për rreth 4 muaj, ka depozituar në llogarinë e këtij fondacioni një shumë prej 167,890,000 lekësh dhe sigurisht është paguar për këtë periudhë, referuar faktit që askush nuk mund të punonte i papaguar. Pra, pavarësisht se është në pamundësi objektive për të disponuar dokumente për të treguar të ardhurat e tij, për shkak të mungesës së dokumentacionit të ruajtur nga këto shoqëri, të paktën Komisioni do të duhej të përlllogariste një pagë minimale dhe referencë për katër muajt përkatës, ku rezulton kryerja e këtyre pagesave.*

Sikurse rezulton nga dokumentacioni i vënë në dispozicion Komisionit në përgjigje të pyetësorit nr. 1, babai dhe familja e tij kanë përfutuar minimalisht 1,200,000 lekë. Sipas logjikës së ndjekur pranë këtyre shoqërive, sa më shumë depozita të tërhiqte një misionar aq më shumë paguhej misionari dhe babai i tij është paguar pranë këtij fondacioni që në momentin e fillimit të marrëdhënies së punës... Veprimet e kryera nga ana e babait të tij në rolin e misionarit pranë kësaj shoqërie janë bërë objekt hetimi edhe referuar vendimit të Prokurorisë të datës 14.4.2001 “Për pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurit R.H”, hetuar pranë Prokurorisë Tiranë, rezulton se “fakti që i pandehuri R.H i ka dhënë 80 personave dyfishin e vlerës përpara afatit të përcaktuar në kontratë, nuk përbën vjedhje, pasi dhënia e lekëve me dyfishin e vlerës ishte një detyrim i misionarit mbi bazën e kontratës që kishte lidhur personi që ka arkëtuar lekët në këtë fondacion me përfaqësues të fondacionit”- shprehet Prokuroria... Pra, konstatimi i Komisionit i cili ka konkluduar në mosnjohje të këtyre të ardhurave, për sa kohë sipas tyre nuk janë konsideruar të ligjshme, është hetuar dhe gjykuar edhe nga Prokuroria e Tiranës, e cila nuk ka konstatuar veprime në shkelje të ligjit, të natyrës penale”.

36. Pasi analizoi shpjegimet dhe provat¹³ e paraqitura nga subjekti, Komisioni vlerëson se:

¹³ Subjekti ka depozituar: (i) shkresë nr. *** prot., datë 28.6.2024, universiteti “A.Xh”, Elbasan; (ii) shkresë nr. *** prot., datë 28.6.2024, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë; (iii) shkresë nr. *** prot., datë 5.7.2024 dhe nr. *** prot., datë 5.7.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; (iv) nxjerrje llogarie R.H, ABI Bank; (v) kontratë depozite datë 4.12.2002, Banka Amerikane, G.H; (vi) mandat tërheqje datë 4.12.2002, Banka Amerikane, G.H; mandat tërheqje datë 28.7.2003, Banka Amerikane, G.H; (vii) kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 4.7.2024 dhe nr. *** prot., datë 13.5.2024, Bashkia Belsh; (viii) kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.5.2024, të Credins Bank; (ix) vërtetim i gjendjes gjyqësore R.H për vitet 2018 dhe 2024; (x) mandatpagesë për licencën e peshkimit, nga ku rezulton se për periudhën 1997 – 2000 pages është dhe z. F; leje higjeno-sanitare; librezë për mjetet matëse; lista e liqeneve ku do të shtrijë aktivitetin shoqëria “B”, viti 1996; (xi) mandatarkëtim i vitit 2010 e në vijim për Bashkinë Belsh; (xii) fatura tatimore për blerjen e rasatit të peshkut; (xiii) nxjerrje llogarie

- a. Në lidhje me të ardhurat e pretenduara nga peshkimi, nuk mund të përfshihen në analizën financiare, pasi subjekti nuk ka depozituar asnjë dokumentacion provues për krijimin e këtyre të ardhurave, si dhe për pagimin e detyrimeve tatimore përkatëse. Për më tepër, bazuar edhe në vetëdeklarimet e subjektit, babai i tij ka qenë në emigracion në këtë periudhë, duke e bërë të pabesueshëm deklarin e subjektit në lidhje me këto të ardhura. Subjekti pretendon se emri i shtetasit F.F është shtuar, ndërkohë nga vetë dokumentacioni i depozituar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1 rezulton se licenca e peshkimit nuk është lëshuar vetëm në emër të babait të subjektit, por edhe të shtetasit F.F, si dhe është firmosur si nga babai i subjektit, ashtu dhe nga z. F. Për më tepër, formulari SV2 i vitit 1999 rezulton i firmosur vetëm nga z. F.

Në seancën dëgjimore në lidhje me shtetasin F.F, subjekti ka dhënë deklarime kontradiktore, duke deklaruar fillimisht që ai ka qenë i punësuar pranë babait të tij dhe më pas ka vijuar të deklarojë se ka abuzuar me licencën e dhënë. Komisioni konstaton se subjekti ka dhënë shpjegime kontradiktore në lidhje me aktivitetin tregtar të babait të tij gjatë viteve 1997 – 1999, me qëllim krijimin e bindjes se babai gjatë periudhës që ka qenë në emigracion ka ushtruar edhe aktivitet tregtar në Shqipëri, deklarime të cilat jo vetëm që nuk janë bindëse, pasi është e pamundur të punosh në dy shtete të ndryshme njëkohësisht, por duket se janë bërë me qëllim përmirësimin e rezultatit financiar të subjektit të rivlerësimit.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti i peshkimit, për sa kohë nuk provohet fitimi i realizuar, pagimi i detyrimeve tatimore, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se subjekti ka deklaruar se babai i tij ka qenë në emigracion për periudhën 1997 – 2000, nuk do të përfshihen në analizën financiare.

- b. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga firmat piramidale, Komisioni i është referuar procesverbaleve të hartuara konform legjislacionit të kohës, duke i konsideruar këto të ardhura si jo të ligjshme. Për sa i përket procedimit penal, ai nuk mund të ligjërojë këto të ardhura, pasi fakti që veprimet e babait të subjektit nuk përbëjnë vepër penale nuk do të thotë që të ardhurat të jenë të ligjshme. Për më tepër, referuar procesverbaleve të dorëzimit datë 26.2.1997, të depozituara nga vetë subjekti së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 1, konstatohet se babai i tij e ka kthyer shumën 776,000 lekë, si dhe ka pranuar të kthejë shumën 1,089,000 lekë. Për sa më sipër, pretendimet e subjektit nuk mbështeten në prova, duke mos u ligjëruar të ardhurat e përfituara nga firmat piramidale.
- c. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e banesës në Belsh, ato janë përfshirë në analizën financiare. Pretendimet e subjektit se shuma 500,000 lekë e depozituar në shoqërinë huamarrëse “V” një ditë pas shitjes së banesës ka një burim të ndryshëm, është në nivel deklarativ dhe i pashoqëruar me dokumentacion provues. Komisioni gjatë hetimit ka përfshirë në analizën financiare çdo të ardhur për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, si dhe çdo shpenzim ku, ndër të tjera, është përfshirë edhe depozitimi

ISP Bank, D.H; (xiv) kërkesë dërguar NBG Bank Greqi; (xv) 3 dokumente në gjuhën greke; vërtetim lëshim vize nga Ambasada Greke; (xvi) kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.5.2024, nga OTP Bank; (xvii) nxjerrje llogarie OTP Bank, R.H; (xviii) vërtetim nr. *** prot., datë 2.7.2024, e QKB-së; (xix) kthim përgjigjeje e DRT Elbasan nr. *** prot., datë 5.7.2024; (xx) mandat tërheqje e Tirana Bank, datë 5.1.2007; (xxi) shkresë e Prokurorisë së Përgjithshme nr. *** prot., datë 14.6.2001.

i shumës 500,000 lekë, duke konstatuar se, me qëllim lehtësimin e pozitës së subjektit, burimi i këtij depozitimi mund të ketë qenë shuma e përfituar nga shitja e banesës.

- d. Në lidhje me bursën e pretenduar nga subjekti si të përfituar gjatë periudhës së studimit, Komisioni vlerëson se:
- Së pari, ajo deklarohet për herë të parë vetëm pas kalimit të barrës së provës, ndërkohë subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar të ardhura nga bursa në deklaratën *Vetting*, por as në pyetësonin nr. 1.
 - Së dyti, universitetet nuk konfirmojnë përfitimin e kësaj burse nga ana e subjektit.
 - Së treti, bursat jepen në dy raste: (i) për studentët e ekselencës, ndërkohë nga ana e subjektit nuk rezulton të jetë depozituar lista e notave; (ii) për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike, shkak i cili nuk mund të aplikohet për subjektin, për aq kohë sa ai ka pretenduar të ardhura të konsiderueshme nga babai tij.

Për sa më sipër, rezulton që subjekti nuk ka depozituar asnjë dokumentacion që të provojë marrjen e kësaj burse. Ky deklaram i subjektit duket se është bërë me qëllim përmirësimin e rezultatit të tij financiar, për rrjedhojë ai do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

- e. Në lidhje me pretendimin e subjektit se banesa është vënë thjesht *de juro* në emrin e tij, ky pretendim i tij nuk e përjashton atë nga detyrimi për të provuar burimin e ligjshëm të saj, por as nuk mbështetet në veprimet e subjektit, i cili jo vetëm e ka dhënë me qira, duke përfituar të ardhura, por nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të ndryshuar pronësinë e kësaj pasurie.
- f. Në lidhje me pretendimin e subjektit për të ardhurat nga emigracioni, Komisioni vlerëson se këto të ardhura nuk janë deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, si dhe nuk provohet jo vetëm krijimi i tyre, por as vlera përkatëse.
- g. Në lidhje me pretendimin e subjektit se ai është në kushtet e nenit 32/2, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive të parashikuar nga neni 32/2 i ligjit nr. 84/2016, pasi asnjë prej institucioneve nuk ka deklaruar humbjen, zhdukjen e dokumenteve apo që ato nuk mund të bëhen përsëri ose të merren në rrugë tjetër. Nga ana e këtyre institucioneve nuk konfirmohet dorëzimi i ndonjë dokumentacioni nga babai i subjektit apo pagimi i detyrimeve tatimore përkatëse.
- h. Në lidhje me pretendimin e subjektit që kjo pasuri është krijuar para detyrës, Komisioni vlerëson se do të merret në konsideratë si rrethanë lehtësuese, por rezultati negativ, si dhe sjellja e subjektit në lidhje me deklaramet e tij për të justifikuar burimin e ligjshëm të kësaj pasurie do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, pasi bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit¹⁴ rivlerësimi është analizë e së shkuarës së një funksionari publik, duke mbajtur në konsideratë që objekt kontrolli është pasuria dhe, për këtë shkak, institucionet e rivlerësimit kontrollojnë burimin në të shkuarën për të cilin është krijuar kjo pasuri dhe rivlerësimi kalimtar *Vetting* mund të përkufizohet si vlerësim i integritetit për të përcaktuar përshtatshmërinë për funksione publike. Legjislacioni i posaçëm për rivlerësimin kalimtar nuk vendos kritere kohore

¹⁴ Vendimet nr. 15/2019, nr. 8/2019, nr. 19/2019 dhe nr. 13/2020.

lidhur me provueshmërinë e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive në pronësi apo përdorim, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

- i. Në lidhje me analizën financiare të kryer nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se subjekti ka përfshirë: (i) të ardhurat nga bursa, për të cilat nuk provohet marrja e tyre; (ii) të ardhurat nga peshkimi, për të cilat nuk provohen as krijimi i tyre dhe as pagimi i detyrimeve tatimore, si dhe minimalisht duhet të pjesëtohen në dy, për sa kohë licenca ka qenë në emër të babait të subjektit dhe shtetasit F.F; (iii) të ardhurat nga firmat piramidale, ndërkohë provohet që të paktën shuma 776,000 lekë është kthyer.

37. Komisioni konstaton se edhe në një rast garantist për subjektin, po të përfshihen të ardhurat nga firmat piramidale, si dhe të ardhurat nga aktiviteti i peshkimit, sërish do të kemi një rezultat negativ për blerjen e kësaj pasurie, në vlerën 1,246,482.39 lekë.

38. Në përfundim, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë, në shumën -1, 473,669.40 lekë.

39. Subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar të ardhura nga dhënia me qira e kësaj pasurie dajës së tij, M.F, në shumën 150,000 lekë.

39.1 Në lidhje me detyrimet tatimore për qiranë, subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1 ka depozituar:

- deklarin e tyre në datën 15.2.2022;
- veprimin në llogari në Credins Bank, datë 15.2.2021, për pagesën e shumës 5,000 lekë si gjobë për deklarin me vonesë;
- veprimin në llogari në Credins Bank, datë 15.2.2022, për pagesën e shumës 27,535 lekë për detyrimet tatimore për periudhën janar – dhjetor 2011.

39.2 Për sa më sipër, duket se këto detyrime janë paguar pas plotësimit të deklaratës *Vetting*, për rrjedhojë nuk do të përfshihen në analizën financiare.

40. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi¹⁵ se: *“Duke qenë se ka qenë një marrëdhënie dajë-nip, nuk kanë nënshkruar një akt shkresor/noterial, pasur parasysht edhe dispozitat e Kodit Civil në nenin 803 e vijues të tij, që nuk normojnë nënshkrimin e një akti shkresor në rast marrëdhënieje qiraje. Pavarësisht kësaj, kishte rënë dakord verbalisht që ky tatim, sikundër ka ndodhur edhe në rastet e tjera të marrëdhënies së qirave, do të paguhej nga qiramarrësi. Për shkak të ndërrimit të jetës së dajës tim, e ka të pamundur të verifikojë nëse prej tij është paguar detyrimi për tatim, apo të kërkonte pagimin e saj në kushtet kur ishte rënë dakord që do të merrej përsipër prej tij. Nga ana tjetër, me qëllim që të tregonte kujdesin e duhur dhe në respektim të kuadrit ligjor të normuar në këtë proces, ka paguar në vitin 2021, sikundër Komisioni konfirmon, tatimin mbi të ardhurat në vlerën 27,535 lekë (detyrim principal + gjobë + interes), si dhe gjoba për vonesë në deklarin, në shumën 5,000 lekë”*. Subjekti ka përmendur disa vendime të Kolegjit në lidhje me mospagimin në kohë të detyrimeve tatimore, por ato nuk lidhen me situatën e tij.

41. Në lidhje me këto të ardhura, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka paguar në kohë detyrimet tatimore, detyrim të cilin e kishte në rolin e qiradhënësit, për sa kohë kemi të bëjmë

¹⁵ Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

me një kontratë të lidhur midis dy individëve. Subjekti ka qenë në dijeni të mospagimit të këtij detyrimi, pasi edhe në deklaratën *Vetting* ka deklaruar të ardhura në vlerën e plotë, pa u zbritur pagesën e detyrimeve tatimore, për rrjedhojë, bazuar edhe në orientimet e Kolegjit në vendimin nr. 15/2021, për sa kohë subjekti i ka paguar detyrimet tatimore me vonesë, e cila është shkaktuar nga veprimet e subjektit dhe jo nga mosdijenja e tij, të ardhurat nga qiraja nuk do të përfshihen në analizën financiare.

42. Në lidhje me mobilimin e banesës, në pyetësonin standard, por edhe në pyetësonin nr. 1, subjekti ka deklaruar se *mobilimi i saj është bërë pjesërisht i ri, pasi janë përdorur një pjesë e mobilieve dhe pajisjeve të banesës paraardhëse.*

42.1 Nga hetimi ka rezultuar se shtëpia në Belsh është shitur në vitin 1996, ndërkohë që shtëpia në Tiranë është blerë në vitin 1998, për rrjedhojë është i paqartë përdorimi i mobilieve të një shtëpie të shitur rreth dy vite më parë për një shtëpi të re dhe, për këtë arsye, iu kërkuan shpjegime subjektit.

43. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi¹⁶ se *fakti që këto mobilie janë përdorur dy vite pasi është shitur banesa paraardhëse, është më se logjik, njerëzor dhe i pranueshëm, për sa kohë mobilet si divanet, krevatet, soba etj. nuk janë mobilie që amortizohen apo konsumohen brenda një afati kohor të shkurtër. Ai ka deklaruar qartësisht që mobilimi në banesën e re ka qenë i pjesshëm, duke deklaruar se nga nëna e tij është bërë kundërbufeja e re, është blerë frigoriferi, ndërsa pjesa tjetër e mobilieve është përdorur nga banesa paraardhëse e Belshit, të cilat kanë qëndruar në ruajtje në banesën e gjyshes së tij A.H, e cila nuk jeton më që prej vitit 2020.*

44. Në lidhje me këtë shpjegim të subjektit konstatohet se ai është në nivel deklarativ dhe i pashoqëruar me prova, të paktën për të provuar pronësinë e banesës së të ndjerës, gjyshes së tij. Komisioni vlerëson se nëse nga ana e subjektit do të deklarohet vetëm në një rast të veçantë përdorimi i mobilieve të një banese të mëhershme në një banesë të mëvonshme, mund të ishte i besueshëm, ndërkohë subjekti në më shumë se një rast ka përdorur të njëjtin deklaram, duke krijuar një lloj sjelljeje, e cila ka pasur për qëllim mosdeklarimin në mënyrë të saktë të mobilimit të banesave, duke u përpjekur të arrijë një rezultat pozitiv, me qëllim shmangien e Komisionit nga një vlerësim i plotë i pasurisë. Këto deklarime të subjektit do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

45. Në lidhje me të ardhurat e prindërve, subjekti ka paraqitur dokumentacion provues për të ardhurat e nënës së tij për vitin 1994, në vlerën 44,320 lekë, të cilat janë marrë në konsideratë nga Komisioni dhe janë përfshirë në analizën financiare të subjektit.

46. Në përfundim, në lidhje me banesën e ndodhur në Selitë, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë, në shumën -1,458,600.60 lekë. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

47. Në lidhje me këtë pasuri, duke marrë në konsideratë faktin që është krijuar në vitin 1998, kohë në të cilën subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në detyrë, Komisioni vlerëson se mungesa e

¹⁶ Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

burimeve të ligjshme nuk mund të përbëjë shkak autonom për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, por do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, në kuptim të nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016.

48. Automjet¹⁷ tip “Mercedes-Benz” me targë TR * S, vit prodhimi 1998. Vlera: 450,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.**

Burimi sipas deklaratës Vetting: kursime personale nga paga si prokuror dhe të ardhura nga shitja e automjetit tip “Ford” me targë TR *** M.

Hetimi¹⁸ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

49. Me kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 11.7.2012, subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz” (vit prodhimi 1998), për çmimin 450,000 lekë.

49.1 Subjekti e ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në DPV/2012, me përshkrimin “Blerje e mjetit tip “Mercedes-Benz” me targë TR *** S, në datën 11.7.2012, në vlerën 500,000 lekë”.

49.2 Në këtë deklaratë subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar si burim të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Ford”, por as pakësim të gjendjes *cash*.

50. Në deklaratën *Vetting*, si burim për blerjen e këtij automjeti subjekti ka deklaruar “Kursime personale nga paga si prokuror dhe të ardhura nga shitja e mjetit tip “Ford” me targë TR *** M”.

Në lidhje me vlerën e përfituar nga shitja e automjetit tip “Ford”

51. Me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 5.12.2006, subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin tip “Ford Fiesta”, për çmimin 500,000 lekë. Në vijim, me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 15.12.2011, subjekti e ka shitur këtë automjet në favor të shtetasës M.M (bashkëjetuesja e tij aktuale), për vlerën 350,000 lekë.

51.1 Nga të dhënat e AMF-së rezulton se subjekti dhe pas shitjes së këtij automjeti ka vijuar të presë polica sigurimi për këtë automjet në emër të tij, në cilësinë e përdoruesit, për periudhat 7.3.2013 – 6.3.2014 dhe 25.2.2012 – 24.2.2013. Gjithashtu, bashkëjetuesja e tij ka prerë polica sigurimi për këtë automjet në cilësinë e përdoruesit, për periudhën 2010 – 2011.

52. Subjekti gjatë hetimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 1 në lidhje me këtë automjet, ka deklaruar: *“Siç edhe kam deklaruar, me bashkëjetuesen jam njohur në kohën që ajo punonte në Komisaratin e Policisë Elbasan. Ajo ka punuar në këtë komisarariat për periudhën shkurt 2005 – korrik 2006. Jam njohur për shkak të detyrës që kishte në këtë komisarariat. Njohja nuk nënkupton lidhjen me të që në këtë periudhë. Në korrik 2006 bashkëjetuesja ka filluar punë në Tiranë, ku edhe unë banoja, dhe fillimisht jemi shoqëruar si miq. Miqësia vijoi më tej me lidhjen, e cila u konsolidua në mesin e vitit 2009.*

Me këtë mjet bashkëjetuesja ka filluar të ushtrojë edhe drejtimin e automjetit e, për këtë arsye, edhe polica e sigurimit është bërë në emër të saj si përdoruese (siguracioni të mbulonte në

¹⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 11.7.2012; (ii) certifikatë pronësie e mjetit rrugor me targë TR *** S; (iii) deklaratë zhdoganimi e automjetit; (iv) kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 15.12.2011; (v) deklaratë zhdoganimi e automjetit; (vi) urdhër çlirimi; (vii) kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 5.12.2006.

¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar DPSHTRR-së; kthim përgjigjeje e DPSHTRR-së nr. *** prot., datë 10.2.2021.

hipotezë të ndonjë aksidenti të demin material palëve të treta), ndonjëse mjete ishte në pronësinë time. Mjetin tip "Ford" e kam shitur te bashkëjetuesja sipas kontratës noteriale, për sa kohë që ishim vetëm të lidhur dhe nuk bashkëjetonim bashkë...".

53. Nga analizimi i deklarimeve të subjektit konstatohet se ai është përpjekur të deklarojë në mënyrë të pasaktë njohjen me bashkëshorten e tij, duke ndryshuar deklaram se lidhjen e ka konsoliduar në vitin 2009, ndërkohë që në pyetësorin standard ka deklaruar: *"...Fëmijët që kanë lindur nga bashkëjetesa me shtetasen M.M janë të regjistruar në përbërjen familjare të saj dhe atësia e fëmijëve është e imja. Bashkëjetesa ka filluar në vitin 2014, por shtetasen M.M e kam njohur më herët, që në periudhën kur punonte në Komisaratin e Policisë Elbasan".*

53.1 Gjithashtu provohet se nga të dhënat e sistemit TIMS subjekti i rivlerësimit dhe shtetasja M.M kanë udhëtuar së bashku nga data 25.12.2007 e në vijim.

53.2 Ky ndryshim në deklaram nga ana e subjektit konsiderohet si përpjekje e tij për të dhënë një deklaram të pasaktë me qëllim justifikimin e veprimeve fiktive të kryera midis tij dhe bashkëjetueses në lidhje me automjetin tip "Ford".

54. Nga hetimi i Komisionit¹⁹ ka rezultuar se në lidhje me këtë automjet është regjistruar procedimi nr. *** nga Prokuroria e Rrethit Elbasan. Bazuar në fashikullin penal rezulton se shtetasi L.D në datë 11.2.2017 ka deklaruar se ka në përdorim automjetin tip "Ford Fiesta" me targë AA *** CK, në pronësi të shtetasës M.M, prej 8 muajsh. Në lidhje me marrëdhënien që ka me znj. M, ai ka deklaruar se e ka njeriun e saj.

54.1 Komisioni në lidhje me këtë shtetas ka pyetur subjektin e rivlerësimit, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 1 ka deklaruar: *"Shtetasi L.D është nga Belshi, vendlindja ime, dhe kemi qenë në shkollën e mesme (gjimnaz) bashkë dhe e kemi ruajtur akoma shoqërinë. Unë dhe shoqëria ime e njohim me emrin G.D. Sipas shkresës së Gjendjes Civile, Bashkia Belsh ka bërë ndryshim të emrit nga G në L.D.*

54.2 Nga ana e subjektit nuk rezulton të jetë deklaruar fakti se automjeti në pronësi të bashkëjetueses së tij është lënë në përdorim të këtij shtetasi, fakt i cili nuk është pasqyruar as në deklaratën *Vetting*.

54.3 Ky automjet, bazuar në vërtetimin nr. *** prot., datë 25.7.2017, është hequr nga qarkullimi përfundimisht në datën 28.7.2017, për arsye jashtë përdorimi.

55. Komisioni, duke marrë në konsideratë:

- a. përpjekjen e subjektit për të dhënë deklaram të pasaktë në lidhje me kohën e njohjes me bashkëjetuesen e tij, si dhe të mosdeklarimit të faktit se ky automjet ka qenë në përdorim të shtetasit L.D, mik i tij;
- b. se automjeti ka vijuar të përdoret nga subjekti edhe pas lidhjes së kontratës së shitjes me bashkëjetuesen e tij, duke u prerë dhe policat e sigurimit;
- c. se automjeti është përdorur nga bashkëjetuesja e subjektit përpara lidhjes së kontratës së shitjes, duke u prerë edhe policat e sigurimit;
- d. se automjeti i është lënë në përdorim shtetasit L.D, me të cilin subjekti ka deklaruar se ka shoqëri;

¹⁹ Kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 29.5.2024, e Prokurorisë së Rrethit Elbasan.

- e. përdorimin e kësaj pasurie si burim për blerjen e një automjeti tjetër në mungesë të burimit të ligjshëm të të ardhurave,

- Ka ngritur dyshime për shitje fiktive të kësaj pasurie.

56. Komisioni konstaton se subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar pakësim të gjendjes *cash* në vitin 2012. Gjithashtu, subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar si burim në DPV/2012 shitjen e automjetit.

57. Në përfundim, duke qenë se ngrihen dyshime për shitje fiktive të automjetit tip “Ford”, si dhe duke marrë në konsideratë se nga ana e subjektit nuk është deklaruar si burim në vitin 2012, por as pakësimi i shumës së shitjes së tij, Komisioni nuk do ta përfshijë në analizën financiare si burim këtë automjet.

57.1 Nga analiza financiare²⁰ duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në vlerën -115,695.93 lekë.

58. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi²¹ se: *“Në deklaratën vjetore periodike të vitit 2011, në rubrikën “Të ardhurat dhe angazhime” kam deklaruar ndër të tjera të ardhura nga shitja e mjetit tip “Ford” me targë TR *** M, në vlerën 350,000 lekë. Në rubrikën “Ndryshime të interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, të së njëjtës deklaratë, kam deklaruar “Shitje të mjetit tip “Ford” me targë TR *** M, me datë 15.12.2011, në vlerën prej 350,000 lekësh”. Në të njëjtën rubrikë, në paragrafin e mëposhtëm, kam deklaruar “Gjendje në shtëpi në vlerën prej 500,000 lekësh, kursime nga paga + të ardhurat nga qiraja e shtëpisë + të ardhura nga shitja e mjetit”. Në vitin 2012, sikundër referova më lart, është fituar prej meje me kontratën e shitblerje automjeti nr. ***, datë 11.7.2012, blerë nga shtetasi M.S, automjeti me një çmim total prej 500,000 lekësh. Kjo pasuri është deklaruar saktësisht në DPV/2012 dhe krahas saj ka deklaruar edhe gjendje në shtëpi në vlerën 100,000 lekë, pra ka rezultuar që kjo gjendje cash është pakësuar si pasojë e blerjes së automjetit në datën 11.7.2012, pakësim në shumën 400,000 lekë... Prerja e policave në emër të shtetases M. M, si dhe nga ana e tij në vitet 2010 – 2011, nuk është asnjë tjetër përveçse tregues i respektimit të nenit 3, pika 6 dhe nenit 6 të ligjit nr. 10076/2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe dispozitave përkatëse të Kodit Rrugor, i cili në rastet kur bëhej i kërkueshëm, policat e sigurimit duhet të priten edhe nga përdoruesit e automjetit... Ai nuk ka pasur detyrim për të deklaruar dhënien në përdorim të automjetit tek shtetasi L.D... Nisur nga përmbajtja e provave dhe fakteve nuk rezulton që ky shtetas ta ketë përdorur këtë automjet, në kushtet kur për shkak të defekteve të mjetit është parkuar përkohësisht në një servis në Belsh, dhe për shkak të vjedhjes së targave, vetëm e ka ndihmuar në kryerjen e një denoncimi në polici...”*

58.1 Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.6.2024, ku shtetasi L.D deklaroi se: *“Në shkurt të vitit 2017 është paraqitur në Komisariatin e Policisë Cërrrik, ku ka bërë një kallëzim penal në lidhje me vjedhjen e targave të mjetit tip “Ford”, ngjyrë e zezë. Këtë mjet rreth 8 muaj para kallëzimit ia kishte lënë subjekti, i cili ka ardhur në Belsh me këtë mjet dhe që i kishte dhënë defekt. Për këtë shkak, mjetin tip “Ford” ia ka lënë në ruajtje”*.

²⁰ Shihni tabelën nr. 2 të rezultateve të hetimit.

²¹ Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

59. Pasi analizoi shpjegimet dhe provat²² e paraqitur nga subjekti, Komisioni vlerëson se deklarata noteriale e depozituar nga subjekti nuk përputhet me deklaratimet e shtetasit L.D në Komisarariat, i cili ka deklaruar se ka në përdorim automjetin tip “Ford Fiesta” me targë AA *** CK, në pronësi të shtetasës M.M, prej 8 muajsh. Komisioni vlerëson se deklarata noteriale është bërë me qëllimin e vetëm për të sjellë pasoja pozitive për procesin e rivlerësimit të subjektit dhe nuk mund të merret në konsideratë. Për më tepër, edhe në këtë deklaratë dyshimi i Komisionit përforcohet, pasi automjeti i shitur tek bashkëjetuesja bazuar në vetëdeklarimet e subjektit dhe shtetasi L.D është përdorur prej tij.

59.1 Subjekti vijon të deklarojë se është lidhur me bashkëjetuesen e tij në vitin 2009, deklarim i cili jo vetëm që nuk përputhet me deklarinimin e tij në pyetësonin standard, por as me të dhënat e sistemit TIMS, nga ku rezulton se ai ka dalë jashtë shtetit me të që nga viti 2007. Ky deklarim i subjektit është bërë me qëllim shmangien e njohjes dhe për rrjedhojë edhe ngarkimin me përgjegjësi të subjektit, për të arritur një rezultat pozitiv në procesin e rivlerësimit. Këto deklarime kontradiktore të subjektit do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

59.2 Në lidhje me shumën 500,000 lekë, ajo është përfshirë në analizën financiare të subjektit, por Komisioni, për të mos rënduar pozitën e subjektit në lidhje me këtë automjet, nuk ka përfshirë në analizën e blerjes së këtij automjeti veprimet e kryera gjatë vitit 2012 të subjektit, që kanë lidhje me pagesën e tokës në Gjinar, si dhe me depozitimin e shumës 1,050,000 lekë, në datën 12.4.2012, për shlyerjen e kredisë.

60. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme në shumën -115,695.93 lekë, e cila nuk mund të shërbejë si shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit për subjektin e rivlerësimit, por duke marrë në konsideratë kryerjen e veprimeve të subjektit me automjetin tip “Ford”, si dhe deklaratimet e tij kontradiktore ky rezultat do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të pasurisë.

61. Pasuria nr. *, z. k. ***,** ndodhur në fshatin Gjinar, Elbasan, përbërë nga tokë bujqësore me sipërfaqe totale 2000 m², bashkëpronar me 4 persona të tjerë. Blerë në vitin 2013. Vlera: 115,150 lekë. Pjese takuese: 17.5%.

Burimi sipas deklaratës Vetting: Të ardhura nga kursimet personale nga paga si prokuror.

62. Blerë 50 m² tokë bujqësore²³ nga bashkëpronari në pasurinë nr. ***, z. k. ***, ndodhur në fshatin Gjinar, Elbasan. Blerë në vitin 2014 me vlerë 50 m² x 263 lekë/m² = 13,150 lekë. Gjithsej në pasurinë nr. ***, z. k. ***, sipërfaqe 400 m². Vlera: 13,150 lekë. Pjese takuese: 20%.

Burimi sipas deklaratës Vetting: Të ardhura nga kursimet personale nga paga si prokuror.

Hetimi²⁴ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

²² Subjekti ka depozituar (i) deklaratë noteriale nr. ***, datë 29.6.2024; (ii) kontratë shitblerjeje dhe vërtetim për nxjerrje jashtë përdorimi; (iii) email datë 18.2.2021; (iv) DIVA e korrigjuar me datë deklarimi 6.5.2021, së bashku me pagesën e detyrimeve tatimore.

²³ (i) Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 1.5.2014; (ii) certifikatë për vërtetim pronësie.

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar ASHK-së; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.2.2021, e ASHK Drejtoria Vendore Elbasan; shkresë nr. *** prot., datë 12.9.2023, drejtuar ASHK Drejtoria Vendore Elbasan; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 18.9.2023, e Drejtorisë Vendore Elbasan.

63. Me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 5.8.2013, subjekti i rivlerësimit së bashku me 4 shtetas të tjerë²⁵ kanë blerë nga shitësit A, L, A dhe D.Sh pasurinë arë me sipërfaqe 2000 m², në zonën kadastrale ***, me nr. pasurie ***, me adresë në Gjinar, Elbasan, për çmimin 658,000 lekë.

63.1 Çmimi i shitjes deklarohet i likuiduar jashtë zyrës noteriale, përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes. Referuar përmbajtjes së kësaj kontrate, subjekti i rivlerësimit ka përfituar sipërfaqen 350 m² të kësaj pasurie të paluajtshme.

64. Subjekti e ka deklaruar blerjen e kësaj pasurie në DPV/2013, me përshkrimin “*Blerë tokë bujqësore në fshatin Gjinar, Elbasan, sipërfaqja totale 2000 m², bashkë me katër persona të tjerë. Sipërfaqja ime 350 m² x 329 lekë/m² = 115,150 lekë. Burimi: të ardhurat nga kursimet. Pjesa në zotërim: 35/200*”.

65. Nga hetimi i Komisionit në lidhje me çmimin dhe likuidimin e kësaj pasurie ka rezultuar:

- a. Në datën 17.9.2012 është lidhur aktmarrëveshja nr. *** (për shitblerje pasurie të paluajtshme) midis blerësit A.B (në cilësinë e përfaqësuesit dhe të z. B.Ç, z. A.Sh, z. Neritan Hoxha dhe z. A.M) dhe shitësve A e D.Sh.

Sipas kësaj aktmarrëveshjeje shitet pasuria tokë arë me sipërfaqe 2000 m², si dhe varosh (tokë arë e trashëguar nga i ndjeri M.Sh) me sipërfaqe 1500 - 1700 m². Çmimi i blerjes 6,000,000 lekë, ku 5,000,000 lekë për sipërfaqe tokë arë 2000 m² dhe 1,000,000 lekë për sipërfaqen varosh (tokë e trashëguar, e paregjistruar). Likuidimi i çmimit është përcaktuar si vijon:

- kësti i parë 1,500,000 lekë është likuiduar në BKT;
- kësti i dytë 500,000 lekë do të paguhet në datën 18.9.2012;
- kësti prej 4,000,000 lekësh me nënshkrimin e kontratës në emër dhe pronësi të palës blerëse.

- b. Me deklaratë noteriale nr. ***, datë 2.8.2013, subjekti dhe shtetasi A.B deklarojnë se i kanë shlyer vlerën e shitjes së sipërfaqes 2000 m² shtetasit A.Sh, sipas aktmarrëveshjes nr. ***, datë 17.9.2012.

Për sa më sipër, rezulton se ndryshe nga sa është parashikuar në kontratën e shitblerjes çmimi real i kësaj pasurie është 6,000,000 lekë, i cili rezulton të jetë paguar përfundimisht në datën 2.8.2013. Gjithashtu, rezulton se së bashku me këtë pasuri është blerë edhe një tokë varosh, e cila nuk rezulton e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

66. Duke u referuar në konstatimet si më lart, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës, pasi duket se subjekti:

- i. Ka fshehur pasurinë tokë me sipërfaqe 1500 - 1700 m², blerë prej tij në vitin 2012.
- ii. Ka fshehur vlerën reale të blerjes së kësaj pasurie, në shumën 6,000,000 lekë.
- iii. Ka kryer deklaram të rremë në deklaratën *Vetting* në lidhje me çmimin real të blerjes së kësaj pasurie.
- iv. Ka fshehur duke mos deklaruar në DPV/2012, por edhe në deklaratën *Vetting*, pagesën e kryer për këtë pasuri në vitin 2012.

²⁵ B.Ç, A.B, A.M dhe A.Sh.

67. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi²⁶ se: “Sikundër edhe Komisioni ka konstatuar, me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 5.8.2013, kam hyrë në marrëdhënie shitblerjeje së bashku me shtetasit B.Ç, A.B, A.M dhe A.Sh, me palët shitëse A, L, A dhe D.Sh, të cilët ishin pronarë të pasurisë arë me sip. 2000 m², e ndodhur në zonën kadastrale ***, me nr. pasurie ***, e regjistruar me volum *, faqe ***, me adresë në Gj, Elbasan, për çmimin 658,000 lekë. Çmimi është paguar jashtë zyrës noteriale, sikundër përcaktohet në kontratë, ndërkohë që kujtoj se kjo pagesë duhet të jetë kryer rreth katër ditë përpara, me të ardhurat e mia nga paga.

Blerjen e kësaj pasurie e kam deklaruar saktësisht në DPV/2013, në rubrikën përkatëse, me përshkrimin “Blerë tokë bujqësore në fshatin Gj, Elbasan, sipërfaqja totale 2000 m², bashkë me katër persona të tjerë. Sipërfaqja ime 350 m² x 329 lekë/m² = 115,150 lekë. Burimi: të ardhurat nga kursimet. Pjesa në zotërim: 35/200”. Për qëllime të kontratës së lidhur në datën 5.8.2013, duke qenë se pagesën e kam kryer më herët, rreth tri ditë përpara, kujtoj se kam nënshkruar paraprakisht, me qëllim pasjen e një dokumenti shkresor lidhur me pagimin e çmimit, deklaratën noteriale nr. ***, datë 2.8.2013, duke deklaruar se kam shlyer pjesën time takuese... Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se midis shtetasit A.B dhe shitësve A dhe D. Sh (dhe jo bashkëpronarët e tjerë) është lidhur një aktmarrëveshje e datës 17.9.2012 (kjo aktmarrëveshje më është prezantuar për herë të parë kur kam lexuar rezultatet e hetimit, dhe si akt shkresor më datë 26.6.2024, kur i kam kërkuar Komisionit vënien në dispozicion të tij)... Aktmarrëveshja e datës 7.9.2012 nuk është nënshkruar absolutisht prej meje, por vetëm prej shtetasit A.B, dhe ky shtetas nuk ka pasur asnjëherë tagra përfaqësimi për të disponuar edhe për mua mbi këtë pasuri, as në momentin e nënshkrimit të kësaj, por as më mbrapa. Gjithashtu, deklaroj se unë në asnjë rast nuk kam aprovuar një vullnet të tillë për të blerë këtë pasuri me çmimin e përcaktuar në këtë aktmarrëveshje të datës 7.9.2012... Pas leximit të rezultateve konstatova gjithashtu që ekstremitetet (data e nënshkrimit) të kësaj aktmarrëveshjeje janë përmendur edhe në deklaratën noteriale të nënshkruar prej meje në datën 2.8.2013, tri ditë përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes noteriale, nëpërmjet së cilës unë kam fituar të drejtat e mia pasurore mbi këtë tokë, për pjesën takuese përkatëse. Dua të deklaroj se referenca e kësaj të dhëne në këtë deklaratë noteriale nuk është vënë re aspak prej meje në momentin kur është nënshkruar, nisur edhe nga fakti që kjo deklaratë është hartuar prej noterit dhe unë kam vajtur në zyrën e tij thjesht për të nënshkruar, në kushtet kur kujtoj se për shkak të angazhimit të madh në punë nuk premtuhej një kohë e mjaftueshme për të lexuar aktin në tërësi dhe vëmendje. Pranoj plotësisht faktin e një neglizhence nga ana ime në leximin e vëmendshëm të tij me qëllim konstatimin e disa të dhënave, të cilat jo vetëm që nuk i kam disponuar si informacion, por as të kem qenë pjesëmarrës i tyre përgjatë hartimit... asnjë prej këtyre pasurive nuk rezulton të jetë pasuri e tjetërsuar prej shtetasve që pretendojnë se disponojnë pronë tokë arë të trashëguar nga i ndjeri M.Sh, me sipërfaqe 1500 - 1700 m², e ashtuquajtur “varosh”. Të gjitha pasuritë kufitare të pronës prej 2000 m² janë të regjistruara në pronësi të palëve ose tokë shtet, madje ka prej tyre që janë edhe sipërfaqe të patjetërsueshme (sikundër pasuria e llojit pyll me sipërfaqe 22352 m² apo pasuria e llojit shkëmbore me sipërfaqe 583 m²). Kjo pasuri e përmendur nga Komisioni nuk rezulton të jetë e regjistruar në emër të këtyre shtetasve dhe, për pasojë, referuar edhe parimit të përgjithshëm se askush nuk mund t’i

²⁶ Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

transferojë të drejta diku tjetër, të cilat ai nuk i ka, ky parashikim i kësaj marrëveshjeje është tërësisht i pavlefshëm. Pavarësisht analizës sime ligjore, theksoj mbi të gjitha që kjo aktmarrëveshje nuk është nënshkruar prej meje dhe unë nuk kam shfaqur asnjë vullnet ligjor apo faktit, për të paguar një çmim të përcaktuar në të, apo për të disponuar për një pasuri të tillë të konsideruar “varosh””.

68. Komisioni pasi analizoi shpjegimet dhe provat²⁷ e paraqitura nga subjekti vlerëson se ato nuk janë bindëse.

68.1 Nga hetimi i Komisionit rezulton e provuar se nga ana e njërit prej bashkëpronarëve të tokës në cilësinë e përfaqësuesit dhe të bashkëpronarëve të tjerë është lidhur aktmarrëveshja nr. *** (për shitblerje pasurie të paluajtshme) midis blerësit A.B (në cilësinë e përfaqësuesit dhe të z. B.Ç, z. A.Sh, z. Neritan Hoxha dhe z. A.M) dhe shitësve A e D.Sh.

69. Sipas kësaj aktmarrëveshjeje shitet pasuria tokë arë me sipërfaqe 2000 m², si dhe varosh (tokë arë e trashëguar nga i ndjeri M.Sh) me sipërfaqe 1500 - 1700 m². Çmimi i blerjes 6,000,000 lekë, ku 5,000,000 lekë për sipërfaqe tokë arë 2000 m² dhe 1,000,000 lekë për sipërfaqen varosh (tokë e trashëguar, e paregjistruar). Likuidimi i çmimit është përcaktuar si vijon:

- kësti i parë 1,500,000 lekë është likuiduar në BKT;
- kësti i dytë 500,000 lekë do të paguhet në datën 18.9.2012;
- kësti prej 4,000,000 lekësh me nënshkrimin e kontratës në emër dhe pronësi të palës blerëse.

69.1 Pra, kjo aktmarrëveshje jo vetëm që është lidhur midis palëve të mësipërme, por ka sjellë edhe pasoja, pasi provohet se kësti i parë në shumën 1,500,000 lekë është likuiduar në BKT. Në lidhje me këtë fakt, subjekti nuk solli asnjë provë shkresore për të provuar të kundërtën e sa është parashikuar në këtë aktmarrëveshje, si dhe pasojave të saj.

69.2 Deklaratat noteriale të depozituara nga subjekti, bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit²⁸, nuk kanë fuqi provuese në këtë proces, pasi janë kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe, e parë në raport me të dhënat e tjera, nuk mbështeten nga rrethanat dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të çështjes, në kuptim të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, çka të krijon bindjen se janë konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se nuk mbështeten nga provat e tjera të administruara në këtë proces.

70. Në vijim të kësaj aktmarrëveshjeje, në datën 2.8.2013, 3 ditë para nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, subjekti me deklaratën noteriale nr. ***, së bashku me shtetasin A.B, ka deklaruar

²⁷ Subjekti ka vënë në dispozicion: (i) kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.10.2010; (ii) kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.5.2012; (iii) kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.7.2012; (iv) kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.8.2012; (v) kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.11.2012; (vi) kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.4.2013; (vii) kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.4.2013; (viii) kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.12.2014; (ix) kontratën e shitblerjes nr. ** rep., nr. ** kol., datë 4.2.2015; (x) kontratën e shitblerjes nr. *** rep. nr. *** kol., datë 9.2.2017; (xi) kontratën e shitblerjes datë 19.6.2023; (xii) shkresën nr. *** prot., datë 1.7.2024, të ASHK Elbasan; (xiii) deklaratën noteriale nr. ***, datë 8.7.2024; (xiv) foto të tokës; (xv) kthim përgjigjen nr. ** dhe nr. ** prot., datë 4.7.2024, të noterit publik F.K.

²⁸ Vendim nr. 6/2018 (JR), datë 12.9.2018, paragrafët 35 dhe 36; vendim nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, paragrafi 27.12.1; vendim nr. 34/2019 (JR), datë 2.12.2019, paragrafi 85.2; vendim nr. 23/2020 (JR), datë 25.9.2020; paragrafi 26.2; vendim nr. 11.2021 (JR) datë 31.03.2021

se i kanë shlyer vlerën e shitjes së sipërfaqes 2000 m² dhe tokës varosh shtetasit A.Sh, sipas aktmarrëveshjes nr. ***, datë 17.9.2012.

70.1 Në vijim të kësaj deklarate noteriale është nënshkruar kontrata e shitblerjes, në të cilën palët shprehen se çmimi është likuiduar jashtë zyrës noteriale, përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes.

71. Për sa më sipër, pavarësisht pretendimeve të subjektit se ai nuk ka pasur dijeni për aktmarrëveshjen, si dhe nuk e ka nënshkruar atë, këto pretendime janë thjesht në nivel deklarativ, pasi nga vetë veprimet e subjektit dhe të shtetasit A.B provohet se subjekti jo vetëm që ka pasur dijeni për këtë aktmarrëveshje, por ka pranuar edhe shlyerjen e plotë të shumës së kësaj aktmarrëveshjeje. Pretendimi i subjektit se nuk e ka lexuar deklaratën noteriale mbetet në nivel deklarativ dhe, për më tepër, bazuar në paragrafin e fundit të kësaj deklarate citohet tekstualisht: *“Për sa më sipër, ju lexua me zë të lartë dhe të qartë deklaruesve dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre nënshkruhet pa vërejtje para meje noteres”*.rezulton se ajo është lexuar më zë të lartë nga noteri.

72. Pavarësisht deklarimeve të subjektit në lidhje me tokën varosh, rezulton e provuar bazuar edhe në akte të nënshkruara prej tij se subjekti ka blerë edhe një tokë varosh, e cila nuk është e regjistruar në regjistrat publikë. Për këtë tokë, bazuar në aktmarrëveshjen nr. ***, është paguar dehe shuma 1,000,000 lekë, duke u provuar në këtë mënyrë blerja e saj. Në lidhje me blerjen e kësaj toke, subjekti ka konfirmuar pagesën në deklaratën noteriale të nënshkruar prej tij.

73. Në lidhje me tokën varosh, subjekti ka kryer fshehje të pasurisë, pasi së pari ajo nuk është e regjistruar në ASHK, duke e bërë të pamundur evidentimin e saj, është blerë nga subjekti dhe bashkëpronarët e tjerë si pjesë e pandarë e tokës arë, duke qenë në posedim dhe shfrytëzim të tyre, si dhe nuk rezulton të jetë deklaruar ndonjëherë nga ana e subjektit.

74. Me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 1.5.2014, subjekti i rivlerësimit së bashku me shtetasit B.Ç dhe A.B kanë blerë nga shitësit A.Sh e L.L sipërfaqet e tokave arë, si vijon: *“A.Sh dhe L. L i shesin Neritan Hoxha 50 m², B.Ç 100 m² dhe A.B 50 m² nga pjesa takuese e pasurisë tokë arë me sipërfaqe 2000 m², e ndodhur në zonën kadastrale ***, me nr. pasurie ***, me adresë në Gj, Elbasan”*. Çmimi total i shitjes së sipërfaqeve si më sipër është 52,600 lekë, ku çmimi për metër katror është 263 lekë.

74.1 Si rrjedhojë e kësaj kontrate, subjekti i rivlerësimit është bërë bashkëpronar në tërësi i 400/2000 pjesë në pasurinë nr. *** në Gj, Elbasan dhe është pajisur me certifikatën e pronësisë datë 17.7.2014.

75. Në datën 19.6.2023, me kontratën nr. ***, subjekti ka blerë 100 m² të tjera të kësaj pasurie për shumën 111,000 lekë, duke pasur në bashkëpronësi në tërësi 500/2000 pjesë.

76. Në lidhje me këto çmime të përcaktuara në kontratat e shitblerjes duket se ato janë fiktive, pasi janë shitur në një vlerë shumë më të ulët se vlera reale e blerjes së tyre në vitin 2013.

Për sa më sipër, duket se subjekti ka fshehur vlerën reale të blerjes së sipërfaqeve të mësipërme.

77. Subjekti në lidhje me këtë barrë prove nuk ka dhënë shpjegime të veçanta, por është referuar në shpjegimet më lart. Komisioni, mbështetur edhe në argumentimin e tij në pikën 68 më sipër, vlerëson se subjekti ka fshehur vlerën reale të blerjes së sipërfaqeve të mësipërme, duke kryer deklaram të rremë në deklaratën *Vetting* vetëm për pjesën e pasurisë të blerë në vitin 2014,

ndërkohë për pjesën tjetër të blerë në vitin 2023 ajo do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, por nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*.

78. Komisioni, bazuar në të dhënat e administruara gjatë hetimit, ka konsideruar çmimin e blerjes së kësaj pasurie në shumën 6,000,000 lekë dhe të paguar sipas përcaktimeve të aktmarrëveshjes nr. ***. Kjo pagesë është konfirmuar edhe nga subjekti në deklaratën noteriale nr. ***. Gjithashtu, si çmim blerjeje për 50 m² të kësaj pasurie të blerë në vitin 2014, në kushtet kur çmimi në kontratë duket se është fiktiv, Komisioni ka konsideruar si çmim vlerën 2,500 lekë/m², e cila përkon me çmimin e blerjes në vitin 2013.

79. Nga analiza financiare²⁹ duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vlerën totale prej 1,285,637.34 lekësh, në vitin 2012 – 2013. Ndërkohë, për blerjen në vitin 2014 të sipërfaqes 50 m² ai ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme.

Në lidhje me këtë barrë prove, subjekti u referua në shpjegimet e dhëna në pikën 67 të këtij vendimi.

80. Pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, Komisioni vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nga ana e tij nuk u provua se pagesa e kryer është ajo e përcaktuar në kontratën e shitblerjes. Bazuar në këtë kontratë përcaktohet se çmimi i shitjes deklarohet i likuiduar jashtë zyrës noteriale, përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes. Ky çmim bazuar në aktmarrëveshjen nr.*** ka qenë në vlerën 6,000,000 lekë dhe pagesa e tij është konfirmuar me deklaratë noteriale të nënshkruar nga subjekti në vitin 2013.

80.1 Në përfundim rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, në shumën 1,285,637.34 lekë.

81. Në lidhje me këtë pasuri, subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1 ka sqaruar se: *“Toka nuk është përdorur përveçse për ndonjë piknik në natyrë me familjen, nga unë apo bashkëpronarët e tjerë. Në këtë tokë asnjë prej bashkëpronarëve nuk ka kryer asnjë investim. Aktualisht nuk ka ndonjë plan zhvillimi për këtë pasuri, kjo e konfirmuar edhe nga shkresa nr. *** prot., datë 29.4.2024, e Bashkisë Elbasan. Nga unë nuk është nënshkruar ndonjë kontratë sipërmarrjeje për këtë sipërfaqe toke. Në dijeninë time edhe asnjë prej bashkëpronarëve nuk ka nënshkruar ndonjë kontratë sipërmarrjeje për këtë tokë”*.

81.1 Subjekti ka vënë në dispozicion foto të kësaj pasurie, ku në një pjesë të saj, që duket se përkon me pasurinë varosh të blerë nga subjekti, konstatohen ndërtime.

81.2 Duke qenë se fotot nuk janë të plota dhe të qarta, Komisioni dyshon se subjekti mund të ketë fshehur investimet e kryera në një pjesë të tokës bujqësore, e cila rezulton të mos jetë e deklaruar prej tij.

82. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi³⁰ se: *“Ju paraqes në vijim foto të qarta të gjithë pronës, ku ndërtimi i pikasur prej Komisionit është një ndërtim i vjetër, i realizuar shumë kohë përpara nga vetë pronarët e trualli, për të cilën unë nuk kam asnjë lidhje. Ky ndërtim duhet të përkojë me pasurinë nr. *** të llojit truall me sip. 300 m², nga ku 80 m² ndërtesë e*

²⁹ Shihni tabelën nr. 3 të rezultateve të hetimit.

³⁰ Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

ndodhur në z. k. ***, Gj, e regjistruar në vol. *, fq. **, në pronësi të shtetasit A.Sh, sikundër dhe shkresa kthim përgjigjeje e ASHK-së Zyra Vendore Elbasan informon. Ose mbase Komisioni i referohet një objekti tjetër të vjetër, i cili rezulton se ndodhet në pasurinë nr. ***, të llojit arë me sip. 625 m², në pronësi të shtetasit D.Sh, apo në pasurinë nr. ***, e cila nuk është as kufitare me pronën time. Nga unë SR Komisionit i janë vënë në dispozicion edhe pamje satelitore të kësaj pasurie tokë arë si nga aplikacioni Google Maps, ku pasqyrohet gjendja aktuale reale e saj, si dhe nga portali ASIG. Pamjet janë të qarta edhe në këto foto, ku rezulton se në pjesën përreth tokës arë që kemi blerë nga A.Sh janë gjurmët e dy ndërtimeve të vjetra, të vendosura jo në sipërfaqen e tokës së blerë. Pra, konstatimi i Komisionit lidhur me dyshimet për investime të kryera nuk qëndron. Së pari, nuk qëndron për shkak se, siç duket nga pamjet fotografike, i vetmi ndërtim në atë zonë është kjo ndërtesë e vjetër e regjistruar në pronësi të shtetasit A.Sh. Së dyti, unë nuk mund të provoj një konstatim që nuk ekziston”.

83. Në përfundim në lidhje me këtë pasuri rezulton se subjekti ka (i)mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e saj, (ii)kryer deklarim të rremë në lidhje me çmimin dhe kohën e blerjes së saj, (iii)kryer fshehje të pasurisë (duke mos deklaruar tokën varosh), në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “b”, “c” dhe “ç” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

84. Automjet tip “Opel Astra”³¹ me targë AA *** OJ, blerë në vitin 2016, në shumën 350,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës Vetting: Të ardhura nga kursimet personale nga paga si prokuror.

Hetimi³² dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

85. Me kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 16.9.2016, subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin tip “Opel Astra” (vit prodhimi 2006) për çmimin 350,000 lekë, shumë e cila deklarohet e likuiduar nga subjekti përpara nënshkrimit të kontratës.

85.1 Subjekti e ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në DPV/2016 me të njëjtin përshkrim si në deklaratën Vetting.

85.2 Subjekti me kontratën nr. ***, datë 8.3.2018, ka shitur automjetin tip “Opel Astra” për shumën 300,000 lekë.

85.3 Nga analiza financiare³³ rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

85.4 Në përfundim rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, si dhe deklarimi i tij është i saktë.

86. Pasuria nr. *, z. k. ***, Tiranë,** përbërë nga apartament me sipërfaqe 62.1 m² + 14.5 m² verandë.

³¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 16.9.2016; (ii) deklaratë doganore datë 22.8.2016.

³² Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar DPSHTRR-së; kthim përgjigjeje e DPSHTRR-së nr. *** prot., datë 10.2.2021.

³³ Shihni tabelën nr. 5 të rezultateve të hetimit.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: Kursime personale pa filluar funksionin + kursime personale nga paga dhe depozita bankare të deklaruara më parë në ILDKPKI, si dhe hua në NGB Bank në shumën 20,000 euro. Vlera: 27,000 euro ose 3,375,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi³⁴ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

87. Me kontratë sipërmarrjeje datë 13.1.2007, subjekti i rivlerësimit ka porositur nga sipërmarrësi “R” sh.p.k. një apartament banimi me sipërfaqe 85.1 m², i përbërë nga 1+1, plus ambiente ndihmëse, kati i pestë i objektit të banimit në Q, Komuna D, Tiranë.

87.1 Në përmbajtje të kontratës së sipërmarrjes palët kanë përcaktuar se çmimi i apartamentit është 27,000 euro (3,375,000 lekë) dhe se kësti i parë prej 6,880 euro është paguar në datën e lidhjes së kontratës, sipas mandatarkëtimit nr. **, datë 13.1.2007.

87.2 Në vijim, subjekti ka nënshkruar kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 28.12.2015, për blerjen e këtij apartamenti, të regjistruar në pronësi të shoqërisë “R” sh.p.k., me nr. pasurie **, me sipërfaqe 62.1 m². Referuar rubrikës së *përshkrimeve të veçanta* në kartelën e pasurisë, apartamenti përfshin një verandë me sipërfaqe 14.5 m².

88. Subjekti si burim për këtë pasuri ka deklaruar kursime personale pa filluar funksionin + kursime personale nga paga dhe depozita bankare të deklaruara më parë pranë ILDKPKI-së.

89. Në DPV/2007, subjekti ka deklaruar “Kontratë sipërmarrjeje datë 13.1.2007. Ndërtim shtëpi banimi 1+1 85 m², me vlerë totale 27,000 euro, shoqëria “Rr” sh.p.k. Shlyer 6,880 euro. Gjendja e mbetur e detyrimit 20,120 euro”. Në këtë deklaratë ai ka deklaruar se ka tërhequr shumën 627,000 lekë, në datën 5.1.2007, nga llogaria e tij në Tirana Bank.

90. Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në Tirana Bank rezulton se ai është mbajtës i llogarisë nr. *** EA në lek, e cila ka shërbyer si llogari mbështetëse për depozitat e krijuara ndër vite.

- Në datën 16.4.2004, në llogarinë nr. *** EA subjekti depoziton në arkë nën komentin “Depozitë në arkë Neritan Hoxha” shumën 200,000 lekë. Këtë shumë e kalon në depozitë me afat maturimi 6-mujor, nr. 104743.
- Në datën 16.12.2004, në llogarinë nr. *** EA subjekti depoziton në arkë nën komentin “Depozitë në arkë Neritan Hoxha” shumën 100,000 lekë. Këtë shumë e kalon në depozitë me afat maturimi 6-mujor, nr. ***.
- Në datën 2.8.2005, në llogarinë nr. *** EA nëna e subjektit, znj. N.H, depoziton në arkë nën komentin “Depozitë në arkë N. H” shumën 200,000 lekë. Këtë shumë e kalon në depozitë me afat maturimi 6-mujor, nr.***.
- Në datën 5.1.2007, pas maturimit të depozitave nr. ***, nr. *** dhe nr. *** gjendja në llogarinë nr. *** EA është 627,675.71 lekë. Në këtë datë subjekti kryen tërheqjen e plotë të shumës 627,000 lekë.

³⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 22.2.2021, e ASHK Tirana Rurale 1; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar UKT-së dhe UKE-së; kthim përgjigjeje nr. K-*** prot., datë 9.2.2021, e UKT-së; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave të nivelit të dytë; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 2.2.2021, e ABI Bank; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 11.2.2021, e Tirana Bank.

91. Komisioni ka kryer një analizë financiare³⁵ mbi mundësinë e krijimit të kësaj depozite, e cila pjesërisht është krijuar përpara fillimit të detyrës, por ndërkohë që subjekti ishte në stazh. Në lidhje me depozitimin e nënës së tij në vitin 2005, nga analiza e kryer në lidhje me krijimin e depozitës në NBG rezulton se prindërit e subjektit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për këtë depozitim (shihni pikat 96 e në vijim vendimi).

91.1 Nga analiza financiare duket se subjekti dhe prindërit e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për të krijuar depozitën, për këtë arsye ajo nuk mund të shërbejë si burim për shlyerjen e detyrimit ndaj shoqërisë “R” sh.p.k. për blerje apartamenti, në masën 6,880 euro.

91.2 Për rrjedhojë, duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në vlerën 831,860 lekë (6,880 euro) për kryerjen e pagesës së këstit të parë të kësaj pasurie.

92. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi³⁶ se: *“...kursime personale pa filluar funksionin kanë ardhur nga pagesa e Shkollës së Magjistraturës, nga e cila ka përfutuar gjithsej shumën 772,790 lekë, për periudhën tetor 2002 – shtator 2004. Gjatë periudhës së studimeve, gjatë muajve prill 2001 – shtator 2002, ka punuar në Censusin 2001 i quajtur ***, i organizuar nga INSTAT, por nuk mund të siguroj dokumentacion për të ardhurat e përfutuara, pasi nga interesimi i bërë në këtë institucion rezulton pagesa e sigurimeve shoqërore vetëm për 4 muaj dhe jo për gjithë periudhën. Kursimet nga paga si prokuror kanë shërbyer për krijimin e 1/2 të depozitës prej 100,000 lekësh të krijuar në datën 15.12.2004, pra pasi kishte përfutuar vetëm 2 paga nga puna si prokuror... Komisioni ka konsideruar si burim një pjesë të bursës së Shkollës së Magjistraturës vetëm atë nga janari deri në 16 prill 2004... Ndërkohë që Komisioni duhej të kishte përdorur logjikën e analizës kumulative... babai ka ushtruar aktivitet privat për peshkim, duke hapur licencë dhe duke u regjistruar në Gjykatë e pastaj në organet tatimore qysh në vitin 1993... Kështu, duke përfshirë në analizën financiare të rishikuar të ardhura nga PF R.H për vitet 1994 deri në fund 2004, familja e tij e analizuar më vete rezulton me një mundësi për kursime në vlerën +3,522,049 lekë”.*

93. Komisioni pasi analizoi shpjegimet dhe provat³⁷ e paraqitur nga subjekti konstaton se ai është i paqartë në lidhje me burimin e krijimit të depozitave, pasi ai pretendon të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës, por edhe kursimet familjare të prindërve të tij, duke krijuar vështirësi në realizimin e një analize të plotë financiare. Pavarësisht këtij fakti, Komisioni për të mos rënduar pozitën e subjektit vlerëson të përfshijë në analizën financiare mundësinë për kursim të subjektit nga të ardhurat nga Magjistratura, në vlerën 584,879.50 lekë, por nuk do të përfshijë të ardhurat e familjarëve të tjerë për të cilat, sikundër do të trajtohet në vijim, nuk provohet burimi i ligjshëm i të ardhurave dhe përfshirja e tyre në analizë do të rëndonte pozitën e subjektit.

94. Në përfundim në lidhje me këtë pasuri, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme në shumën -68,345.00 lekë, e cila nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, por do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

³⁵ Shihni tabelën nr. 6 të rezultateve të hetimit.

³⁶ Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

³⁷ Subjekti ka depozituar: (i) mandatdepozitë të Tirana Bank datë 4.8.2008, 3.11.2004, 24.3.2009, 16.5.2005 dhe 29.9.2005; (ii) vërtetim nr. *** prot., datë 26.1.2017, Shkolla e Magjistraturës.

95. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti në datën 28.1.2008 ka lidhur kontratë kredie me NBG Bank, me afat 15-vjeçar, në shumën 20,000 euro. Në nenin 9 të kontratës përcaktohet se dorëzanësit marrin përsipër detyrimin për të bllokuar në favor të bankës shumën prej 22,000 euro që ato mbajnë në NBG Bank si garanci financiare për sigurimin e përmbushjes së detyrimeve kundrejt bankës.

95.1 Kjo kredi më pas është garantuar me kontratë hipoteke nr. ***, datë 27.1.2010, me pasurinë nr. ****, z. k. ***, apartament me sipërfaqe 131 m².

95.2 Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në NBG Bank rezulton se në datën 26.2.2008 është disbursuar kredia në shumën 20,000 euro dhe në të njëjtën datë subjekti ka transferuar shumën 19,720 euro, me shënimin “Pagesë për blerje apartamenti”. Nga analiza financiare³⁸ duket se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për pagesën e këstit të dytë.

96. Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se kredia e subjektit është garantuar me depozitën e prindërve në shumën 22,000 euro, ka kryer një hetim në lidhje me këtë depozitë, pasi bazuar në të dhënat e administruara gjatë hetimit për të ardhurat e prindërve ka konstatuar se ata nuk kanë pasur të ardhura të konsiderueshme, për rrjedhojë ngrihen dyshime se kjo depozitë është në fakt e subjektit të rivlerësimit.

97. Nga hetimi rezulton se babai i subjektit ka pasur një depozitë në shumën 22,530 euro pranë NBG Bank, duke filluar nga data 31.12.2007.

97.1 Subjekti në pyetësorin nr. 1³⁹ ka dhënë shpjegime në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve të tij, që kanë shërbyer për krijimin e kësaj depozite.

97.2 Komisioni pasi ka analizuar dokumentacionin e depozituar nga subjekti ka kryer një analizë⁴⁰ në lidhje me mundësinë e krijimit të depozitës në NBG Bank me depozitim *cash* nga babai i subjektit në datën 28.12.2007, në shumën 22,530 euro. Nga analiza financiare duket se prindërit e subjektit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në vlerën -8,241,452.90 lekë.

98. Në lidhje me këtë llogari bankare, duke marrë në konsideratë:

- i. mungesën e burimit të ligjshëm të prindërve të tij;
- ii. kohën e krijimit të saj;
- iii. qëllimin e përdorimit të saj për t’u vënë si garanci për kredinë e marrë nga subjekti;
- iv. pretendimin e subjektit për marrjen e kredisë në shumën 3,100,000 lekë, ndërkohë që prindërit e subjektit kishin kursime në këtë llogari;

³⁸ Shihni tabelën nr. 7 të rezultateve të hetimit.

³⁹ Subjekti ka depozituar: (i) vizë e shtetit grek për nënën e subjektit për periudhën 27.8.1998 – 26.12.1998; (ii) leje kalimi e motrës A.H, e datëlindjes 27.7.1988, me vlefshmëri deri më 30.6.1999; (iii) kërkesë drejtuar NBG Bank në Greqi dhe Ambasadës Greke; (iv) vërtetim datë 4.7.2002, e Komisaritit Kurbin; (v) vërtetim për bazën e vlerësuar për shtetasin G.H; (vi) letër referencë lëshuar nga *** Group; (vii) vërtetim i lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., datë 19.11.2008; (viii) vërtetim nr. ***, datë 26.11.2008, lëshuar nga DRT-ja; (ix) librezë pune me nr. regj. themeltar ***, lëshuar në emër të vëllai të subjektit, G.H; (x) lëvizje të llogarisë së z. G.H në Intesa Sanpaolo Bank; (xi) nxjerrje llogarie në Tirana Bank të z. G.H dhe prindërve (e cila është administruar e plotë për prindërit e subjektit gjatë hetimit); (xii) vërtetim kontributësh për babain R.H për vitet 2012 – 2024; (xiii) nxjerrje llogarie të subjektit në Raiffeisen Bank, Tirana Bank dhe ISP Bank; (xiv) kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.4.2024, e ABI Bank; (xv) kontratë nr. ***, datë 1.9.1993; (xvi) kontratë nr. ***, datë 26.12.2003; (xvii) kontratë shitjeje nr. ***, datë 19.7.2004.

⁴⁰ Shihni tabelën nr. 8 të rezultateve të hetimit.

- v. përpjekjen e subjektit për të përfshirë të ardhurat e çdo familjari të tij për krijimin e burimeve të ligjshme të pasurive që përdoren vetëm për interesa të tij,

- Ngrihen dyshime se të ardhurat e kësaj llogarie janë të ardhura të subjektit të rivlerësimit, të fshehura në emër të prindërve.

99. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi⁴¹ se: *“Kjo shumë e krijuar nga ana e prindërve në vlerën prej 22,000 euro, si rezultat i kursimeve të tyre ndër vite, nuk i është dhënë hua apo dhuruar, në mënyrë që të mbartë detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të tyre, pasi në këtë marrëdhënie juridike ai nuk ka pasur në përdorim këtë shumë dhe prindërit e tij nuk kanë statusin e personit tjetër të lidhur në kuptim të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”. Mbështetur në praktikën tashmë të konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, çmon se marrëdhënia juridiko-civile e cash-kolateralit nuk përmbush kriteret e parashikuara nga dispozitat e sipërcituara, në kuptim të të cilave të mund të kualifikojë prindërit e tij si persona të tjerë të lidhur.*

Nga sa i kujtohet, idenë për të vënë cash kolateral, nëse do të ishte e mundur, ia ka dhënë punonjësja e bankës që e ka asistuar në aplikimin e kredisë. Sipas saj, edhe për bankën do të ishte më e preferuar të ofronte dy produkte, një kredi dhe një depozitë, duke siguruar komisione më të larta, pra fitim për bankën dhe njëkohësisht edhe garanci të plotë në rast të mosshlyerjes së kredisë. Për bankën ishte më e thjeshtë që në rast mosshlyerjeje të ekzekutonte depozitën cash-kolateral që do e kishte të ngurtësuar në bankë sesa të ndiqte procedura gjyqësore dhe pastaj përmbartimore për ekzekutimin e detyrueshëm të një prone të vendosur si kolateral... Babai e informoi se ata e kishin mundësinë ta mbështesnin në këtë mënyrë (kishin depozituar te Tirana Bank në datën 17.12.2009 shumën 16,000 euro) dhe kështu babai tërhoqi këtë shumë së bashku me kursime në banesë e depozita të tjera në banka, hapi një llogari në euro tek NBG Bank në datën 28.12.2007 dhe depozitoi shumën 22,530 euro... Kjo vlerë monetare, së bashku me shuma të tjera në lek, janë mbajtur prej babait cash në banesë dhe janë përdorur për të kryer pagesën e ndërtimit të shtesës së apartamentit të prindërve tek rruga “M.T”, si dhe për shlyerjen e kredisë së marrë në NBG Bank, në vitin 2009... Në analizën financiare të paraqitur nga Komisioni për prindërit nuk janë marrë parasysh disa të ardhura, për të cilat ka vënë në dispozicion aq sa prova ka mundur, për shkak të kohës së largët dhe për shkak të mosdetyrimit për të deklaruar, e aq më tepër të prindërve të tij. Subjekti më pas ka vijuar të sqarojë burimin e kësaj depozitë, duke dhënë të njëjtat deklarime si në pyetësin nr. 1. Ai ka pretenduar të ardhura nga emigracioni të babait të tij në vlerën 5 milionë dhrahmi, të cilat konvertuar me kursin mesatar të vitit 2000 (vit kur prindërit janë kthyer në Shqipëri), 100 lekë = 39.41 dhrahmi, rezulton që ata të kenë krijuar kursime nga puna e tyre e ndershme në emigracion në vlerën 1,970,500 lekë, të ardhurat nga aktiviteti i peshkimit për të përcaktuar sasinë e të ardhurave në këtë interval, janë bazuar tek qarkullimi i viteve 2015 – 2023, për të cilat ka informacion nga DRT Elbasan. Qarkullimi mesatar gjatë këtyre viteve është rreth 1,500,000 lekë në vit, vlerë kjo që duhet të konsiderohet si e ardhur bruto gjatë viteve 2007 – 2013... Duke bërë llogaritjet rezulton që të ardhurat neto/fitimi nga ushtrimi i aktivitetit të babait janë në vlerën 12,614,987 lekë, për periudhën 1995 – 31.12.2016. Ndërsa fitimi i babait për periudhën e analizuar, pra 1995 – 28.12.2007, ka qenë 6,539,102 lekë, të ardhura të tjera të vëllait dhe

⁴¹ Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

nënës, për të cilat ata nuk kanë qenë të regjistruar në skemat e pagesave të sigurimeve shoqërore, nga ana e punëdhënësve të tyre (një problematikë e njohur kjo në tregun shqiptar të punësimit), por jo për faj të tyre. Në analizën e Komisionit, kur ishte analizuar mundësia financiare për krijimin e shumës 22,530 euro, kjo shumë ishte vendosur në analizë dy herë: një herë veçmas si “depozita 22,000 euro” dhe përsëri si pjesë e likuiditeteve të prindërve. Po ashtu, ishte përdorur një kurs këmbimi i gabuar (ai i USD/lek), i cili është korrigjuar në këtë analizë të rishikuar”.

100. Komisioni pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti⁴² vlerëson se ato nuk janë bindëse.

100.1 Për sa i përket burimeve të kësaj depozite, ato janë trajtuar gjerësisht në pikën 36 të këtij vendimi. Komisioni do të ndalet në mënyrën e analizimit të subjektit për të ardhurat e pretenduara nga babai nga aktiviteti i peshkimit. Në lidhje me këto të ardhura, subjekti pretendon që të merren në mënyrë hipotetike, duke u bazuar në të dhënat e viteve 2015 – 2023 dhe duke u përjashtuar të dhënat e viteve 2009 – 2014. Ky pretendim i subjektit jo vetëm që nuk mbështetet në dokumentacionin e kohës për të provuar krijimin e tyre, për më tepër nëse i referohemi të dhënave nga organet tatimore të ardhurat për vitin 2009 janë 10,000 lekë (e njëjta vlerë pretendohet nga subjekti), ndërkohë sipas llogaritjeve të subjektit viti 2008 duhet të ketë një fitim prej 1,026,348 lekësh, por ai vijon duke pretenduar që vitet 2010 – 2013 të kenë një fitim mesatar prej 1,000,000 lekësh dhe më pas viti 2014 fitim 0 (zero), sikundër është deklaruar nga babai i tij në organet tatimore. Kjo mënyrë llogaritjeje e subjektit nuk ka asnjë mbështetje ekonomike dhe financiare, ku nga të dhënat e organeve tatimore rezulton se babai i subjektit ka deklaruar të ardhura nga ky aktivitet pas vitit 2015, ndërkohë për vitet 2009 dhe 2014 rezulton e provuar se babai i subjektit ka deklaruar një fitim prej 10,000 lekësh në vitin 2009 dhe një humbje prej 68,605 lekësh në vitin 2014. Për rrjedhojë, argumentimi i subjektit për të llogaritur në mënyrë hipotetike të ardhurat me një marzh fitimi të viteve 2015 e në vijim nuk mund të merret në konsideratë. Gjithashtu, në lidhje me këto të ardhura, nuk ka asnjë të dhënë për krijimin e tyre, por as për pagimin e detyrimeve tatimore për periudhën kur është krijuar kjo depozitë.

101. Për sa i përket të ardhurave nga emigracioni, subjekti nuk ka depozituar asnjë dokument për krijimin e tyre, duke mbetur në nivel deklarativ. Lidhur me pretendimin e subjektit për pasqyrimin e shumës 22,530 euro në analizë dy herë, një herë veçmas si “depozita 22,000 euro” dhe përsëri si pjesë e likuiditeteve të prindërve, konstaton se ky pretendim qëndron dhe ka kryer sistemimet përkatëse në analizën financiare.

102. Lidhur me vlerat e paraqitura nga subjekti në prapësime mbi shtesën e apartamentit tek rruga “M.T”, të kryera në vitet 2006 – 2007 në shumën 1,480,385.15 lekë, për të mos rënduar pozitën e subjektit, Komisioni vlerëson të mos i përfshijë në analizën financiare.

103. Në përfundim, rezulton se prindërit e subjektit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite, në shumën 5,517,350.60 lekë.

104. Subjekti pretendon se në lidhje me depozitën prindërit e tij nuk kanë statusin e personit tjetër të lidhur, pasi nuk i kanë dhënë hua apo dhuruar këtë shumë. Në parashtrimet e tij ai citon

⁴² Për më shumë referojuni provave dhe shpjegimeve të subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

edhe disa vendime të Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁴³. Komisioni vlerëson se bazuar në jurisprudencën e Kolegjit⁴⁴, si dhe duke marrë në konsideratë se subjekti ka përfshirë pasuri të prindërve të tij më shumë se një herë në interes të tij, e ka zgjeruar hetimin dhe i ka kaluar subjektit barrën e provës për fshehje pasurie dhe jo për mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e depozitës. Parashikimi i pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në vlerësim të trupit gjykues është një parashikim i cili lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me elementet përbërëse të fshehjes së pasurisë dhe të deklarimit të rremë për efekt të procesit të rivlerësimit, sipas të cilit përcaktohet si fshehje apo deklarim i rremë çdo deklarim i subjektit të rivlerësimit që tenton të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë, duke deklaruar të dhëna të pavërteta apo të pasakta, ose duke mos i deklaruar fare ato, me qëllim që procesi i kontrollit e verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të subjektit të rivlerësimit, rezultat që do të ishte i kundërt nëse do të bazohej në të dhënat e faktet e vërteta. Ky parashikim kushtetues është reflektuar në përcaktimet e nenit 33, pika 5, shkronjat “ç” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016. Bazuar në këto dispozita ligjore, si dhe duke marrë në konsideratë: (i) mungesën e burimeve të ligjshme të babait të subjektit për të justifikuar shumën 22,530 euro; (ii) deklarimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me burimin e kësaj shume; (iii) periudhën e depozitimit të kësaj shume në bankë, e cila përkon me momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes së subjektit, si dhe marrjen e kredisë vetëm 1 muaj më vonë; (iv) përdorimin e kësaj shume si garanci për kredinë e marrë nga subjekti; (v) tërheqjen e saj nga prindërit në vitin 2010 dhe përdorimin e pretenduar të subjektit për të shlyer kredinë prej 3,100,000 lekësh, e cila rezulton e marrë nga subjekti, si dhe për apartamentin në rrugën “M. T”, për të cilin ngrihen dyshime që është pasuri e fshehur e subjektit – vlerëson se kjo shumë mund të jetë në pronësi të fshehur të subjektit.

104.1 Komisioni do t’i trajtojë konstatimet e mësipërme në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

105. Në lidhje me pasurinë apartament, në datën 16.9.2019 është lidhur kontrata e shitjes me kusht kreditimi nr. ***, sipas së cilës subjekti e ka shitur këtë pasuri për vlerën 46,000 euro.

106. Gjendje *cash* në banesë në shumën 500,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: Kursime personale nga paga si prokuror.

107. Komisioni ka kryer një analizë⁴⁵ në lidhje me mundësinë e krijimit të gjendjes *cash* në deklaratën *Vetting*.

107.1 Nga analiza financiare duket se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash* prej 500,000 lekësh.

PASURITË E BASHKËJETUESES SË SUBJEKTIT – M.M

108. Blerje automjeti tip “Ford”. Kontrata noteriale datë 15.12.2011, noteri B. B, Elbasan. Regjistruar në DRSHTRR Elbasan me targa AA ** CK. Çmimi: 350,000 lekë. Pjesa takuese: 100%

⁴³ Vendim nr. **, datë 8.9.2020, nr. **, datë 10.9.2020 dhe nr. **, datë 9.2.2021.

⁴⁴ Vendim nr. **/2020, nr. **/2020 dhe nr. **/2022.

⁴⁵ Shihni tabelën nr. 9 të rezultateve të hetimit.

Burimi i krijimit: Kursime personale nga paga si juriste dhe specialiste personeli pranë *** Tiranë.

Trajtuar në pikën 51 e në vijim të këtij vendimi.

109. Blerë shtëpi banimi⁴⁶ 1+1 me sipërfaqe 60.00 m². Pasuria nr. ***, rruga “M.Gj”, Tiranë. Çmimi: 6,420,000 lekë.

Burimi sipas deklaratës Vetting: Depozita bankare të deklaruara më parë në ILDKPKI + kursime të prindërve + hua pa interes.

Konstatimi i ILDKPKI-së:

- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit të shumës 2,430,713 lekë nga kursimet e prindërve të bashkëjetueses, shumë e cila ka shërbyer për blerjen në vitin 2006 të apartamentit me sip. 74.29 m², Elbasan. Shitja e këtij apartamenti ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit aktual në pronësi të bashkëjetueses.*
- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për blerjen e apartamentit me sip. 60 m², rruga “M.Gj”, Tiranë, me burim kursimet e prindërve. Gjithashtu, organet tatimore nuk konfirmojnë të dhëna financiare nga aktiviteti i tyre.*

Hetimi⁴⁷ **dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni**

110. Me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 2.10.2015, bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit ka blerë apartamentin e banimit me sipërfaqe 60 m², ndodhur në rrugën “M.Gj”, Tiranë, për çmimin 6,420,000 lekë.

110.1 Me kërkesë për transfertë fondesh datë 2.10.2015 të Tirana Bank, ajo ka transferuar në llogarinë bankare të noterit I.Q në Alpha Bank shumën 6,420,000 lekë, me përshkrimin pagese “Sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 2.10.2015”. Në kërkesën për transfertë, fondet e transferuara janë deklaruar me burim nga “shitja e apartamentit dhe kursime familjare”.

⁴⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë nr. ***; (ii) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 2.10.2015; (iii) transfertë bankare datë 2.10.2015; (iv) aktmarrëveshje datë 15.5.2014; (v) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 21.8.2014; (vi) depozitë në arkë datë 21.8.2014, Alpha Bank; (vii) vërtetim nr. ***prot., datë 16.1.2017, nga ALUIZNI Elbasan; (viii) vërtetim nr. *** prot., datë 16.1.2017, nga ALUIZNI Elbasan; (ix) vetëdeklarim nr. ** prot., datë 25.3.2006, për objektin lokal (byrektore), e ndërtuar në vitin 1998; (x) planvendosje e sheshit të ndërtimit; (xi) vendim për dhënie shesh ndërtimi nga Bashkia Përrenjas; (xii) vendim datë 19.10.1998, nga Bashkia Përrenjas; (xiii) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 25.4.2006; (xiv) certifikatë për vërtetim pronësie; (xv) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 15.1.2007; (xvi) nxjerrje llogarie bankare datë 25.10.2016; (xvii) nxjerrje llogarie bankare datë 25.10.2016 në Raiffeisen Bank; (xviii) derdhje cash në arkë, Raiffeisen Bank, datë 9.1.2009; (xix) shkresë nr. ** prot., datë 25.10.2016, nga ISSH; (xx) vërtetim për bazën e vlerësueshme datë 1.10.1995; (xxi) pasqyra e derdhjes së kontributit në emër të shtetasit P.M; (xxii) pasqyra për kontrollin mujor, viti 2008; (xxiii) pasqyra për kontrollin mujor për vitet 2002 – 2003 dhe vitin 2007; (xxiv) vendim nr. **, datë 1.6. 2016, për rishqyrtim të të ardhurave nga ISSH; (xxv) ekstrakt regjistrimi në QKR, të subjektit “A”, me NIPT J***N; (xxvi) vërtetim nr. *** prot., datë 28.10.2016, nga A; (xxvii) vendim nr. *** regj., datë 16.1.1998, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Librazhd; (xxviii) shkresë nr. ** prot., datë 25.10.2016, nga ISSH; (xxix) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për periudhën 1.5.1993 – 28.2.1994; (xxx) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për periudhën 1.3.1998 – 31.12.1998; (xxxi) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për periudhën 1.9.1999 – 15.1.2013.

⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje e ASHK Drejtoria Vendore Tirana Jug nr. *** prot.; kthim përgjigjeje e ASHK Drejtoria Vendore Elbasan nr. *** prot., datë 23.2.2021; shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar UKT-së dhe UKE-së; kthim përgjigjeje e UKT-së nr. K-** prot., datë 9.2.2021; kthim përgjigjeje e UKE-së nr. ** prot., datë 5.2.2021, shkresë nr. ** prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave të nivelit të dytë; kthim përgjigjeje e Tirana Bank nr. *** prot., datë 11.2.2021; kthim përgjigjeje e Raiffeisen Bank nr. *** prot., datë 15.2.2021.

110.2 Bashkëjetuesja e subjektit është pajisur me certifikatë pronësie datë 6.10.2015, sipas së cilës apartamenti është me nr. pasurie ***, z. k. ***.

111. Komisioni ka hetuar burimet e deklaruara nga subjekti në deklaratën *Vetting*, si vijon:

A. Depozita bankare

112. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dokumentacionin e shitjes së pasurisë së paluajtshme apartament nr. ***, nga e cila bashkëjetuesja e tij ka përfituar të ardhurat e vendosura si depozitë bankare në Tirana Bank, e të përdorura si burim pjesor për blerjen e apartamentit në rrugën “M.Gj”, Tiranë.

112.1 Nga analizimi i këtij dokumentacioni, si dhe i atij të administruar gjatë hetimit, rezulton se në datën 26.5.2005 bashkëjetuesja e subjektit ka lidhur kontratë sipërmarrjeje për porositjen e një apartamenti me sipërfaqe 80.1 m², me vlerë 3,200,000 lekë. Në kontratë përcaktohet se është paguar shuma 2,700,000 lekë dhe shuma prej 500,000 lekësh do të paguhet brenda muajit qershor.

112.2 Në kontratë gjendet shënimi “Sot, më datë 12.7.2005, u pagua shuma 500,000 lekë”, i cili është nënshkruar nga shtetasi E.Sh.

112.3 Në datën 21.6.2006 është lidhur kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 21.6.2006, për blerjen e apartamentin me nr. pasurie ***, ndodhur në lagjen “K.E”, Elbasan, me sipërfaqe 74.29 m², për çmimin 2,430,713 lekë, vlerë e cila deklarohet e shlyer jashtë zyrës noteriale.

112.4 Në DPV/2014, bashkëjetuesja e subjektit nuk ka deklaruar çmimin e kontratës së sipërmarrjes për këtë apartament, por çmimin e kontratës së shitjes në shumën 2,430,713 lekë.

113. Në lidhje me këtë pasuri, subjekti në pyetësin nr. 1⁴⁸ ka deklaruar: *“Fillimisht dua të theksoj faktin se ky apartament është blerë nga bashkëjetuesja para se unë të njihesha me të, e si rrjedhojë unë nuk kam qenë në dijeni se çfarë veprimesh apo transaksionesh janë kryer. Në momentin që unë kam filluar bashkëjetesën me të, e kam deklaruar këtë bashkëjetesë në DPV-në përkatëse, ku edhe kam bërë deklarinimin e pasurisë së bashkëjetueses në atë kohë.*

*Sipas shpjegimeve të bashkëjetueses dhe prindërve të saj, për blerjen e këtij apartamenti kanë shërbyer të ardhurat e siguruara nga: (1) punësimi i prindërve; (2) një pjesë e të ardhurave nga shitja e pasurisë nr. ***, z. k. ***, apartamentit 2+1 në qytetin e Përrenjasit (paratë për çmimin e dakordësuar janë marrë më parë me këste, sipas shpjegimeve të prindërve të bashkëjetueses); (3) të ardhura nga aktiviteti i dyqanit që kanë pasur te oborri i shkollës (para dyqanit kanë bërë tregti ambulante); (4) babai i bashkëjetueses për shkak se ka dalë në pension rreth vitit 1993 (punonjës miniere nëntokë) ka bërë punë të ndryshme si tregti, kambist, agjent i kompanive të sigurimit; (5) kursime familjare (sipas shpjegimeve të nënës së bashkëjetueses ka pasur dhe depozita në bankat e kohës); (6) kredi të marra në ProCredit Bank; (7) të ardhura*

⁴⁸ Subjekti ka vënë në dispozicion: (i) dosjen e pensionit të shtetases B.M; (ii) dosjen e pensionit të shtetasis P.M; (iii) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 25.4.2006; (iv) leje mjedisi nr. * prot., datë 14.1.1998, në emër të shtetases B.M; (v) librezë shëndetësore; (vi) vërtetim datë 3.3.2001 e Bashkisë Përrenjas; (vii) vërtetim të Bashkisë Përrenjas; (viii) kthim përgjigjeje e ISP Bank datë 25.4.2024, si dhe nxjerrje llogarie në Credins Bank; (ix) kthim përgjigjeje e ProCredit Bank nr. OP-***, datë 23.4.2024; (x) kthim përgjigjeje e DRT Elbasan nr. *** prot., datë 7.5.2024; (xi) kthim përgjigjeje e DRT Elbasan nr. *** prot., datë 7.5.2024; (xii) nxjerrje llogarie bankare e Raiffeisen Bank, z. P.M, shoqëruar me disa kontrata depozite; (xiii) nxjerrje llogarie bankare e Raiffeisen Bank, znj. B.M; (xiv) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për periudhën 16.2.2005 – 20.7.2006, për shtetasen M.M; (xv) kthim përgjigjeje e Raiffeisen Bank nr. *** prot., datë 9.5.2024.

*nga para “të investuara” në firmat piramidale “P” e “Xh”, si dhe në shoqërinë “***” që ushtronte aktivitetin e saj në qytetin e Përrenjasit deri rreth vitit 2010”.*

114. Pasi analizoi shpjegime dhe provat⁴⁹ e paraqitur nga subjekti, Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare kreditë e marra nga shtetasja B.M, pasi:

- i. Në kontratën e kredisë datë 14.4.2005 për marrjen e huas në shumën 300,000 lekë nga ProCredit Bank, objekti është përcaktuar për rinovim, për rrjedhojë kjo kredi nuk mund të ketë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në Elbasan.
- ii. Kontrata e kredisë datë 27.12.2006 për marrjen e huas në shumën 300,000 lekë rezulton të jetë marrë pas blerjes së apartamentit në Elbasan.

114.1 Gjithashtu në këtë analizë nuk janë përfshirë të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë së paluajtshme, e cila rezulton të jetë shitur në vitin 2006, pas blerjes së apartamentit.

114.2 Komisioni konstaton se subjekti në përgjigje të këtij pyetësori sërish, si në rastin e automjetit tip “Ford”, është përpjekur që të shmangë njohjen me bashkëjetuesen e tij në vitet 2005 – 2006, sikundër ka deklaruar në pyetësozin standard. Ky deklarim i subjektit duket se është bërë për të përjashtuar nga analiza financiare pasurinë apartament me qëllim arritjen e një rezultati pozitiv në vlerësimin e kriterit të pasurisë.

115. Komisioni, duke marrë në konsideratë që:

- a. ky apartament: ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit të bashkëjetueses së tij të deklaruar në deklaratën *Vetting*; është deklaruar nga bashkëjetuesja e tij në DPV/2014; është blerë gjatë kohës që ajo njihej me subjektin e rivlerësimit;
- b. bashkëjetuesja e subjektit duke filluar nga viti 2006 ka punuar në Tiranë, ndërkohë që subjekti për të gjithë periudhën e rivlerësimi ka punuar në Elbasan;
- c. përpjekjen e subjektit për të shmangur njohjen me bashkëjetuesen e tij në kohën e blerjes së këtij apartamentit,

- Ka kryer një analizë financiare mbi mundësinë e blerjes së këtij apartamenti. Komisioni, me qëllim mosrëndimin e pozitës së bashkëjetueses së subjektit, analizën e ka kryer duke përfshirë të gjitha të ardhurat e familjarëve të saj, si dhe vetëm pagesën për blerjen e apartamentit dhe shpenzimet jetike. Nga analiza financiare⁵⁰ duket se bashkëjetuesja e subjektit dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në vlerën -1,397,100.33 lekë.

116. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi⁵¹ se: *“Lidhur me pasuritë e paluajtshme të krijuara nga bashkëjetuesja e tij, ato janë pasuri vetjake e bashkëjetueses, në kuptim të nenit 77 të Kodit të Familjes, të krijuara tërësisht nga të ardhurat e saj dhe të familjes së saj së origjinës, përpara se të merrte statusin e personit deklarues për efekt të bashkëjetesës në vitin 2014... Nga shpjegimet e bashkëjetueses dhe prindërve të saj, për aq sa mbajnë mend, apartamenti është blerë dhe është paguar edhe sipërfaqja e përbashkët në fillim me kontratën*

⁴⁹ (i) Kartelë Ilogarie Banka e Kursimeve, B.M; (ii) shkresë dërguar ***; (iii) vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan; (iv) vërtetim nr. *** prot., datë 18.10.2016, e ***; (v) vërtetim nr. *** prot., 26.1.2017, i Bibliotekës Kombëtare; (vi) vërtetim për bazën e vlerësuar datë 3.5.2024, ISSH; (vii) nxjerrje Ilogarie M.M, Tirana Bank.

⁵⁰ Shihni tabelën nr. 10 të rezultateve të hetimit.

⁵¹ Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

e sipërmarrjes. Më pas, pasi ndërtuesi është pajisur me certifikatën e pronësisë, është bërë kontrata përfundimtare e shitjes ku çmimi, sipas shpjegimeve të bashkëjetueses dhe prindërve të saj, është çmim i diktuar nga ndërtuesi për efekte tatimore, çmim i pranuar prej tyre për sa kohë që ata me këtë kontratë bëheshin pronarë edhe ligjërisht me “tapi”...Në kushtet kur prindërit e saj nuk janë persona të lidhur, ata nuk mund të hetohen sikur ata të mbartnin këtë cilësi. Ata duhet të vlerësohen në drejtim të faktit nëse kanë pasur mundësi kumulative për krijimin e të ardhurave, sikundër edhe është trajtuar gjerësisht në Kolegj... Në vitet 2005 – 2006, kur janë kryer veprimet e para juridike të bashkëjetueses, nuk ka pasur një lidhje me të, por thjesht njohje shoqërore... Veprimet juridike të kryera nga ana e saj, në një kohë përpara se të konsolidohej marrëdhënia njerëzore, nuk mund t’i atribuohen atij, e aq më pak procesit të rivlerësimit⁵²....Deklarimi i kësaj pasurie nga bashkëshortja në DPV/2014 është kryer mbi bazën e detyrimit ligjor për deklarimin e çdo pasurie që ajo ka disponuar në çastin e deklarimit, por kjo nuk përbën pasuri në bashkëpronësi, dhe sigurisht që ai nuk ka dhënë asnjë lloj kontributi për krijimin e saj... Nga shkresa kthim përgjigjeje e DRT Elbasan nr. *** prot., datë 7.5.2024, rezulton se xhiroja e deklaruar nga PF B.M në vitin 1998 është deri në 2,000,000 lekë dhe tatimi fiks 40,000 lekë. Bazuar në ligjin e kohës, ligji nr. 8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, në nenin 2 të tij përcaktohet se “Subjekte të tatimit me kuotë fikse janë ato subjekte që realizojnë një qarkullim deri në shumën 2,000,000 lekë në vit”, të ardhurat e këtij vitit duhet të ishin përlllogaritura me një normë fitimi 60%, në vlerën 1,200,000 lekë... Në datën 14.4.2005, znj. B.M ka marrë një kredi në shumën 300,000 lekë nga ProCredit Bank, të cilën Komisioni nuk e ka konsideruar si të ardhur për blerjen e apartamentit nga ana e bashkëjetueses. Duket se kjo ka ndodhur për shkak të përshkrimit të objektit të kredisë rikonstruksion. Nga biseda që ka pasur me znj. B, i ka shpjeguar se ProCredit Bank ka qenë fillimisht fondacion i ngritur vetëm për të dhënë kredi tek bizneset e vogla e më vonë u bë bankë. Ajo ka operuar në një mënyrë më praktike se bankat e tjera, duke pranuar të dhëna reale biznesi dhe jo domosdoshmërisht bilancet formale apo deklarimet në zyrat e tatimeve... Kështu, sipas shpjegimeve të znj. B, pavarësisht se kredinë ata e donin për të blerë apartamentin për M, dhe konkretisht për të plotësuar vlerën e çmimit blerjes për apartamentin që do të bihej, e vetmja mënyrë për ta marrë kredinë ishte deklarimi i saj si kredi për biznesin. Kështu që vetë agjentja e bankës e këshilloi që të plotësonte në formularin e aplikimit “për rinovim”, në mënyrë që ajo të aprovohej nga zyrat qendrore të bankës. ...Për pagesën e datës 26.5.2005 ka shërbyer edhe depozita e B.J.M, e cila në datën 2.2.2005 ka qenë në vlerën 1,704,918 lekë, sikurse rezulton nga shkresa nr. *** prot., datë 9.5.2024, të cilën e vë në dispozicion të Komisionit”.

117. Komisioni pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjektit konstaton se sërish subjekti ka dhënë shpjegime të cilat nuk përputhen me dokumentacionin e administruar, të cilat duket se janë bërë me qëllim arritjen e një rezultati pozitiv për procesin e rivlerësimit. Më konkretisht, subjekti deklaroi se kredia e shtetases B.M në vlerën 300,000 lekë është marrë si person fizik dhe se ajo ka deklaruar në bankë se po e merr për qëllime të biznesit të saj. Ky deklarim nuk përputhet me dokumentacionin bankar të administruar gjatë hetimit me shkresën nr. OP-*** prot., datë 10.2.2021, më konkretisht dokumentin me emërtimin “Përmbledhje për Komitetin datë 13.4.2005”, në të cilin rezulton se aplikimi është bërë nga nëna e bashkëjetueses së subjektit si individ, ku deklaroi se ajo është ekonomiste dhe se kredia është kërkuar për

⁵² Subjekti përmend vendimet e Kolegjit nr. 22/2019, nr. 22/2022 dhe nr. 15/2023.

rinovimin e banesës. Ky deklaram i subjektit së bashku me deklaramet e tjera të tij do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

118. Në lidhje me pretendimin e mospërfshirjes së shumës 1,704,918 lekë, ky pretendim nuk qëndron, pasi Komisioni e ka përfshirë në analizë pavarësisht faktit se kjo shumë në fund të vitit futet në llogarinë bankare të nënës së bashkëjetueses së subjektit. Në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti të nënës së bashkëjetueses, konstatimi i subjektit është i drejtë por, për sa kohë nuk provohet qarkullimi i deklaruar dhe fitimi, Komisioni nuk mund të përfshijë në analizën financiare vlerën e pretenduar nga subjekti.

119. Në përfundim në lidhje me këtë pasuri, e cila ka shërbyer si burim për pasurinë e deklaruar në deklaratën *Vetting*, rezulton se subjekti nuk ka provuar burimin e ligjshëm të saj, për më tepër nga ana e tij është përpjekur të shmanget përgjegjësia në lidhje me këtë pasuri, duke mohuar deklaramet e bëra më parë prej tij në lidhje me kohën e njohjes me znj. M. Komisioni, duke qenë se për burimin e kësaj pasurie nuk provohet që kanë shërbyer të ardhura të subjektit, vlerëson se nuk mund të përbëjë shkak autonom për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit, por do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

120. Me aktmarrëveshjen datë 15.5.2015, shtetasja M.M, në cilësinë e “premtueses për shitje”, ka premtuar se do të shesë apartamentin në qytetin e Elbasanit kundrejt çmimit total 4,500,000 lekë, pasi të plotësojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kalimin e pronësisë. Premtuesja për blerje deklaron se i ka dhënë premtueses për shitje vlerën 1,000,000 lekë dhe diferencën prej 3,500,000 lekësh do t’ia japë në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes përpara noterit.

120.1 Në datën 21.8.2014 është lidhur kontrata e shitblerjes nr. ***. Në kontratë përcaktohet se shuma 1,000,000 lekë është likuiduar nga blerësja për shitësen sipas aktmarrëveshjes datë 15.5.2014, ndërsa shuma e mbetur si kësti i dytë është depozituar në llogarinë e noterit.

120.2 Në datën 21.8.2014, blerësja e apartamentit ka depozituar shumën 3,500,000 lekë në llogarinë e noterit publik.

121. Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëjetueses në Tirana Bank rezulton se:

- Në datën 22.9.2014 është transferuar shuma 3,500,000 lekë nga noteri publik M.L.
- Në datën 15.10.2014 është depozituar *cash* shuma 1,000,000 lekë.

122. Në përfundim, në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij apartamenti, duke marrë në konsideratë konkluzionet më lart, janë përfshirë me rezervë në analizën financiare për blerjen e apartamentit në rrugën “M.Gj” (me kushtin që subjekti të provonte burimin e ligjshëm të të ardhurave të bashkëjetueses së tij për blerjen e këtij apartamenti).

123. Pas kalimit të barrës së provës subjekti u mbështet në shpjegimet në pikën 116 më lart, duke shtuar se apartamenti në qytetin e Elbasanit nuk është pjesë e deklaratës *Vetting* dhe, për rrjedhojë, nuk duhet të analizohet nga Komisioni.

124. Komisioni pasi analizoi shpjegimet e subjektit vlerëson se përfshirja në procesin e rivlerësimit të apartamentit në qytetin e Elbasanit është në përputhje me legjislacionin për procesin e rivlerësimit pasi, së pari është një pasuri e deklaruar në deklaratat periodike vjetore dhe, së dyti është burim për një pasuri të deklaruar në deklaratën *Vetting*. Për të mos rënë në përsëritje të analizës në lidhje me këtë apartament, Komisioni vlerëson se nga ana e subjektit

nuk u provua burimi i ligjshëm për blerjen e tij, por duke marrë në konsideratë që paratë për shitjen e këtij apartamenti janë përfituar nëpërmjet sistemit bankar, si dhe janë transferuar nëpërmjet sistemit bankar tek shitësi, ato do të përfshihen në analizën financiare.

B. Kursimet e prindërve

125. Subjekti së bashku me deklaratën *Vetting*, si dhe gjatë hetimit, ka depozituar dokumentacion⁵³ për të provuar të ardhurat e prindërve të bashkëjetueses së tij.

125.1 Komisioni përveç dokumentacionit të depozituar nga subjekti ka kryer një hetim të plotë në lidhje me të ardhurat e prindërve të bashkëjetueses së tij, nga ku ka rezultuar se:

125.2 QKB-ja⁵⁴ informon se:

- P.M figuron i regjistruar si person fizik, pajisur me NIPT L***L. Bashkëlidhur ekstrakti historik “P.M”. Nga verifikimi i ekstraktit rezulton se është regjistruar në datën 8.7.2010, me fushë veprimtarie “Rritje, peshkim dhe tregtim të peshqve”, me vend ushtrimi aktiviteti tek liqeni i Belshit.
- P.M dhe B.M kanë 75 aksione në shoqërinë “A”, me NIPT J***N.
- B.M figuron e regjistruar si person fizik me vendimin nr. **, datë 16.1.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd. Bazuar në këtë vendim rezulton se znj. M është regjistruar për ushtrimin e aktivitetit si shitëse artikujsh shkollorë dhe prodhimeve gjysmë të gatshme (hamburger).

125.3 DTR Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 26.2.2021, konfirmon se P.M figuron i regjistruar si tatimpagues pranë këtij institucioni, me datë regjistrimi 8.7.2010, me aktivitet “Kultivimi i peshkut, kultura ujore”, me status person fizik. Sipas të dhënave në sistem rezulton se subjekti gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit nuk ka deklaruar dhe paguar asnjë detyrim tatimor dhe në datën 16.11.2012 ka kaluar në status pasiv.

125.4 ISSH-ja, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 18.9.2023, si dhe kthim përgjigjes nr. *** prot., datë 23.4.2024, ka vënë në dispozicion të dhënat për kontributet e shtetasve P.M e B.M, për periudhën 1995 e vazhdim, si vijon:

⁵³ Subjekti ka vënë në dispozicion: (i) vërtetim nr. *** prot., datë 16.1.2017, nga ALUIZNI Elbasan, që konfirmon se shtetasi P.M ka aplikuar si vetëdeklarues në procesin e legalizimit nr. *** prot., datë 26.11.2014, për objektin “shtesë banimi”, me adresën pallati nr. **, Lagjja nr. *, Përrenjas; (ii) vërtetim nr. ** prot., datë 16.1.2017, nga ALUIZNI Elbasan, që konfirmon se shtetasi P.M ka aplikuar si vetëdeklarues në procesin e legalizimit me nr. ** prot., datë 25.8.2006 për objektin lokal (byrektore), me adresë rruga “Q.S”, Përrenjas; (iii) vetëdeklarim nr. ** prot., datë 25.3.2006, për objektin lokal (byrektore) e ndërtuar në vitin 1998; (iv) planvendosje e sheshit të ndërtimit; (v) vendim nr. *, datë 16.9.1997, për dhënie shesh ndërtimi nga Bashkia Përrenjas, me sipërfaqe 12 m² dhe numri i kateve 1; (vi) shkresë nr. ** prot., datë 29.9.1997, e Kryetarit të Bashkisë Përrenjas, drejtuar Zyrës së Urbanistikës së Rrethit; (vii) vendim datë 19.10.1998, nga Bashkia Përrenjas, për dhënie shesh ndërtimi; (viii) kontratë shitblerjeje nr. **, datë 25.4.2006; (ix) kontratë shitblerjeje nr. **, datë 15.1.2007; (x) nxjerrje llogarie bankare datë 25.10.2016 në Societe Generale Albania Bank, në emër të shtetasit P.M; (xi) nxjerrje llogarie bankare datë 25.10.2016 në Raiffeisen Bank, në emër të shtetasit P.M; (xii) derdhje *cash* në arkë, Raiffeisen Bank, datë 9.1.2009, nga shtetasi P.M në vlerën 300,000 lekë; (xiii) certifikatë familjare datë 24.10.2016, sipas së cilës bashkëjetuesja e subjektit në datën 2.5.2016 ka qenë në të njëjtën përbërje familjare me prindërit e saj; (xiv) shkresë nr. *** prot., datë 25.10.2016, nga DRSSH Elbasan; (xv) ekstrakt regjistrimi në QKR të subjektit “A”, me NIPT J***N; (xvi) vërtetim nr. ** prot., datë 28.10.2016, nga A, që konfirmon se shtetasja B.M ka përfituar të ardhura nga paga për periudhën 1.1.2007 – mars 2012, në vlerën 1,846,174 lekë; (xvii) vendim nr. ** regj., datë 16.1.1998, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Librazhd; (xviii) shkresë nr. ** prot., datë 25.10.2016, nga DRSSH Elbasan.

⁵⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 9.2.2021.

- P.M ka përfituar pension pleqërie për periudhën 1.9.1995 – 30.4.2024, me masë mujore aktuale 31,863 lekë;
- P.M ka përfituar nga ligji nr. 29/2019 për periudhën nga korriku 2019 shtesë, me masë mujore aktuale 3,621 lekë;
- B.M ka përfituar pension pleqërie për periudhën 16.1.2013 – 31.3.2024.

126. Komisioni bazuar në të dhënat e mësipërme ka kryer një analizë financiare⁵⁵ mbi mundësinë e prindërve të bashkëjetueses së subjektit, duke marrë në konsideratë faktin se në datën 18.9.2015 babai i saj ka depozituar në llogarinë nr. *** EA, nën komentin “P.M derdhje në llogarinë e vajzës kursime familjare”, shumën 700,000 lekë.

126.1 Nga analiza financiare rezulton se prindërit e bashkëjetueses së subjektit kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhurimin e shumës 700,000 lekë.

127. Komisioni, duke iu referuar burimeve të analizuara më sipër, ka kryer një analizë financiare⁵⁶ për blerjen e apartamentit, duke pranuar me rezervë shumën 4,500,000 lekë të përfituar nga shitja e apartamentit të bashkëjetueses së subjektit në qytetin e Elbasanit.

127.1 Nga analiza financiare duket se bashkëjetuesja e subjektit dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, për sa kohë janë përfshirë me rezervë të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në qytetin e Elbasanit.

128. Në përfundim në lidhje me këtë pasuri, subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, pasi nuk provoi se për blerjen e apartamentit në qytetin e Elbasanit bashkëjetuesja e tij kishte të ardhura të mjaftueshme të ligjshme, për rrjedhojë subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

129. Tërhequr dhe mbyllur depozita Plus në Credins Bank⁵⁷ në datën 10.6.2015 (principal + interes). Vlera: 126,193 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: Kursime nga paga. Transfertë nga llogaria e pagës në *** Tiranë.

130. Tërhequr dhe mbyllur depozita në Credins Bank⁵⁸ në datën 10.6.2015 (principal + interes). Vlera: 341,738 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: Kursime të prindërve dhe interesi bankar.

Hetimi⁵⁹ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

131. Nga nxjerrja e llogarive bankare pranë Credins Bank rezulton se:

- i. Në datën 23.7.2011, bashkëjetuesja e subjektit ka çelur llogarinë nr. ***, duke transferuar fonde nga llogaria e pagës në mënyrë periodike.

⁵⁵ Shihni tabelën nr. 11 të rezultateve të hetimit.

⁵⁶ Shihni tabelën nr. 11 të rezultateve të hetimit.

⁵⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: tërheqje *cash* datë 10.6.2015 në Credins Bank.

⁵⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: tërheqje *cash* datë 10.6.2015 në Credins Bank.

⁵⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave të nivelit të dytë; kthim përgjigjeje e Credins Bank nr. *** prot., datë 23.3.2021.

Kjo llogari kursimi ka gjeneruar interesa dhe në datën 10.6.2015 mbyll depozitën duke tërhequr të gjithë shumën prej 126,225.19 lekësh.

- ii. Në datën 13.1.2009, bashkëjetuesja depoziton në llogarinë nr. ***, nën komentin “Derdhje cash çelje depozite 3-mujore”, shumën 200,000 lekë.

Kjo depozitë ka gjeneruar interesa dhe në datën 17.4.2012 gjendja e saj është 300,000.69 lekë, shumë të cilën e transferon në depozitën nr. ***, me afat maturimi 12-mujor.

Depozita nr. *** ka gjeneruar interesa dhe në datën 10.6.2015 është mbyllur, duke u tërhequr e gjithë shuma prej 343,237.65 lekësh.

Në përfundim të hetimit konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të bashkëjetueses së subjektit. Ajo ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin.

132. Depozitë në Tirana Bank⁶⁰ datë 10.6.2015. Vlera: 467,500 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: Depozita të Credins Bank të mbyllura më lart.

133. Depozitë në Tirana Bank⁶¹. Vlera: 700,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: Kursime të prindërve.

134. Depozitë në Tirana Bank⁶² datë 28.9.2015. Vlera: 500,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: Hua pa interes, pa afat, të xhaxhait J.M.

Konstatimi i ILDKPKI-së:

- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit të shumës 500,000 lekë nga xhaxhai i bashkëjetueses, shumë e cila është depozituar në Tirana Bank dhe është përdorur për blerjen e apartamentit me sip. 60 m², Tiranë.*

Hetimi⁶³ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

135. Në lidhje me depozitat në shumat 700,000 lekë dhe 467,500 lekë, Tirana Bank konfirmon deklaramin e bashkëjetueses së subjektit.

135.1 Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëjetueses së subjektit në Tirana Bank rezulton se në datën 28.9.2015 shtetasja Zh.M ka depozituar shumën 500,000 lekë, me emërtimin “Dhënie borxhi”. Ky depozitim është deklaruar si hua nga bashkëjetuesja e subjektit.

135.2 Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se huadhënësit kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënie e huas.

135.3 Në lidhje me këtë hua, bashkëjetuesja e subjektit po në deklaramin *Vetting* deklaronte se ajo është marrë për blerjen e apartamentit dhe se është shlyer nga babai i saj në datën 21.10.2015.

135.4 Si burim për shlyerjen janë deklaruar kursimet dhe depozita në Raiffeisen Bank. Komisioni ka kryer një analizë financiare⁶⁴ mbi mundësinë e prindërve të subjektit për shlyerjen

⁶⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaramin *Vetting* depozitë në arkë datë 6.10.2015, në Tirana Bank.

⁶¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaramin *Vetting* depozitë në arkë datë 18.9.2015, në Tirana Bank.

⁶² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaramin *Vetting* depozitë në arkë datë 28.9.2015, në Tirana Bank.

⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave të nivelit të dytë; kthim përgjigjeje e Credins Bank nr. *** prot., datë 23.3.2021; kthim përgjigjeje e Raiffeisen Bank nr. *** prot., datë 15.2.2021.

⁶⁴ Shihni tabelën nr. 14 të rezultateve të hetimit.

e huas. Nga analiza financiare duket se prindërit e bashkëjetueses së subjektit kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kthimin e huas prej 500,000 lekësh.

135.5 Në përfundim të hetimit konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të bashkëjetueses së subjektit. Ajo ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin.

136. Tërhequr dhe mbyllur depozita në Credins Bank⁶⁵ në datën 22.9.2015 (principal + interes). Vlera: 214,549 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: Kursime personale + kursime të prindërve dhe interes bankar.

137. Tërhequr në datën 22.9.2015 në llogarinë e pagës të Raiffeisen Bank⁶⁶ shuma 204,000 lekë. Vlera: 204,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: Kursime nga paga në ** Tiranë.

138. Depozitë në Tirana Bank⁶⁷ datë 22.9.2015. Vlera: 418,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: Depozita e Credins Bank + të ardhura nga paga tërhequr në Raiffeisen Bank.

Hetimi⁶⁸ dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

139. Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëjetueses së subjektit në Credins Bank rezulton se ajo në datën 22.9.2015 ka tërhequr shumën 214,549.3 lekë.

139.1 Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëjetueses së subjektit në Raiffeisen Bank rezulton se ajo në datën 22.9.2015 ka tërhequr shumën 204,000 lekë.

139.2 Në datën 22.9.2015, bashkëjetuesja e subjektit ka depozituar shumën 418,000 lekë në Tirana Bank, duke deklaruar si burim tërheqjet e mësipërme në Credins Bank dhe Raiffeisen Bank.

139.3 Në përfundim të hetimit konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të bashkëjetueses së subjektit. Ajo ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin.

140. Tërhequr dhe mbyllur depozita në Tirana Bank⁶⁹ në emër të znj. M.M (principal + interes). Shuma 194,728 lekë, mbetur pas blerjes së shtëpisë, tërhequr në datën 5.10.2015, e përdorur për mobilim të pjesshëm të shtëpisë. Vlera: 4,500,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: Shitja e pasurisë nr. ***, apartament në Elbasan, viti 2014, blerë në vitin 2006 me kursime familjare.

⁶⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* tërheqje *cash* datë 22.9.2015, në Credins Bank.

⁶⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* tërheqje nga llogaria në Raiffeisen Bank, në datën 22.9.2015.

⁶⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* depozitë në Tirana Bank, datë 22.9.2015, nga znj. M.M.

⁶⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, drejtuar bankave të nivelit të dytë; kthim përgjigjeje e Credins Bank nr. *** prot., datë 23.3.2021; kthim përgjigjeje e Raiffeisen Bank nr. *** prot., datë 15.2.2021; kthim përgjigjeje e Tirana Bank nr. *** prot., datë 11.2.2021.

⁶⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) certifikatë e depozitës në Tirana Bank, datë 15.10.2014; (ii) kërkesë datë 22.9.2015, nga znj. M.M, për prishjen e depozitës në Tirana Bank; (iii) tërheqje në Tirana Bank datë 10.5.2015, nga M.M, të vlerës 194,728 lekë; (iv) certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë nr. ***, në z. k. ***, vol. ***, fq. ***, (v) kontratë sipërmarrjeje datë 26.5.2005; (vi) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 21.6.2006.

Trajtuar në pasurinë apartament në Rr. M.Gj.

141. Tërhequr dhe mbyllur depozita në BKT⁷⁰ në datën 16.11.2015 në emër të znj. M.M (principal + interes). Shuma 102,543 lekë përdorur për mobilim të pjesshëm të shtëpisë. Vlera: 102,543 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: Kursime personale, të ardhura nga paga.

142. Depozitë në BKT⁷¹ datë 17.1.2011 në emër të M ose B.M, në shumën 470,000 lekë (gjendje deri më 31.12.2014). Vlera: 470,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: Kursime të prindërve dhe interes bankar.

Hetimi⁷² dhe analiza financiare-juridike e kryer nga Komisioni

143. Në datën 16.11.2015, bashkëjetuesja e subjektit ka tërhequr shumën 102,543 lekë nga llogaria e përbashkët e saj me nënën në BKT.

143.1 Në datën 20.3.2015 është hapur depozitë dyemërore e bashkëjetueses dhe nënës së saj në shumën 470,142.15 lekë.

143.2 Nga nxjerra e llogarive bankare pranë BKT-së rezulton se:

- Në datën 14.6.2010, nëna e bashkëjetueses së subjektit, znj. B.M, ka transferuar nga llogaria e pagës në llogarinë rrjedhëse mbështetëse nr. ***V shumën 160,000 lekë. Gjendja e llogarisë së pagës në datën 13.6.2010 është 164,277.67 lekë.
- Në po këtë datë është hapur depozita dyemërore nr. ***R, me mbajtës M dhe B.M, në shumën 160,000 lekë, me afat maturimi 3-mujor.
- Në datën 18.5.2011, B.M ka transferuar nga llogaria e pagës me gjendje 163,993.86 lekë në llogarinë rrjedhëse mbështetëse nr. ***V shumën 150,000 lekë.
- Në datën 24.5.2013, B.M ka transferuar nga llogaria e pagës në llogarinë rrjedhëse mbështetëse nr. ***V shumat 50,195.75 lekë dhe 25,000 lekë.
- Në datën 27.5.2013, fondet e llogarisë rrjedhëse janë bashkuar me shumën e depozitës 3-mujore dhe shuma e plotë prej 447,320.36 lekësh është transferuar në depozitë me afat 1-vjeçar nr. ***. Kjo depozitë në datën 31.12.2014 është në vlerën 470,000 lekë dhe në datën 27.5.2014 maturohet në vlerën 504,804.72 lekë.

144. Në përfundim të hetimit konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të bashkëjetueses së subjektit. Ajo ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin.

KONSTATIME TË TJERA

145. Në lidhje me huan e marrë në NBG Bank

Konstatimi i ILDKPKI-së:

⁷⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: (i) konfirmë transferim nga llogaria në llogari në BKT, në datën 16.11.2015; (ii) nxjerrje llogarie bankare datë 23.8.2015 në BKT.

⁷¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* nxjerrje llogarie bankare në BKT, datë 25.10.2016, në emër të M ose B.M, të depozitës në vlerën 470,000 lekë, çelur në datën 24.5.2013.

⁷² Kthim përgjigjeje e BKT-së nr. *** prot., datë 16.2.2021.

- *Subjekti nuk ka deklaruar shlyerjet e kredisë me bashkëkredimarrës familjarët e tij, respektivisht në vitin 2010 në shumën 1,157,964 lekë dhe në vitin 2012 në shumën 1,868,889 lekë, si dhe burimin e krijimit të këtyre shumave, në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë 2010, 2011 dhe 2012.*
- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin financiar të shlyerjeve para afatit të kredisë në NBG Bank, në shumën totale 3,100,000 lekë pasi, sikurse deklaroi në vitin 2009, subjekti është bashkëkredimarrës me familjarët për efekt të ardhurash, pasi familjarët nuk i kishin të ardhurat që kërkonte banka. Gjithashtu, subjekti rezultoi kredimarrës dhe jo bashkëkredimarrës, sikurse ka deklaruar në vitin 2009.*

146. Subjekti, në datën 25.9.2009, me kontratë kredie nr. *** ka marrë kredi në shumën 3,100,000 lekë pranë NBG Bank. Qëllimi i marrjes së kredisë ka qenë blerja e një apartamenti në rrugën “K e P”. Bashkëmbajtës në këtë kredi kanë qenë shtetasit G, R dhe D.H dhe garantore ka qenë shtetasja N.H.

146.1 Kjo kredi rezultoi e deklaruar nga subjekti në DPV/2009, ku ai ka deklaruar se është bashkëkredimarrës me familjarët e tij për efekt të ardhurash, pasi ata nuk i kishin të ardhurat që kërkonte banka.

147. Nga nxjerrja e llogarisë në NBG Bank rezultoi se:

- Në datën 15.10.2009 është disbursuar kredia në shumën 3,100,000 lekë. Bazuar në dokumentin kërkesë për transferim fondesh datë 15.10.2009, subjekti i rivlerësimit i ka paguar shumën 3,100,000 lekë shoqërisë “****” sh.p.k. Tek detajet e pagesës përshkrimi është “Pagesë për blerje apartamenti nga Neritan Hoxha”.
- Në datën 18.3.2010 është depozituar shuma 1,155,000 lekë, e cila është përdorur për shlyerjen e pjeshme të kredisë në datën 14.4.2010.
- Në datën 12.4.2012 është depozituar shuma 1,050,000 lekë, e cila ka shërbyer për likuidimin pjesor të kredisë.
- Në datën 28.12.2012 është depozituar shuma 859,000 lekë, e cila ka shërbyer për shlyerjen totale të kredisë.

147.1 Për të garantuar këtë kredi, fillimisht është vënë në hipotekë me kontratën nr. ***, datë 25.9.2009, pasuria e subjektit në Selitë dhe më pas është vënë në hipotekë me kontratën nr. ***, datë 27.1.2010, pasuria në rrugën “M.T”.

147.2 Komisioni, bazuar në të dhënat e mësipërme nga ku provohet që kredia është marrë dhe përdorur nga subjekti, i ka kërkuar shpjegime në lidhje me gjetjet gjatë hetimit.

148. Subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1⁷³ ka shpjeguar se: *“Siç kam deklaruar edhe në DPV/2009, në pyetësorin standard, kjo kredi është marrë në vitin 2009 te NBG Bank (aktualisht ABI Bank) nga prindërit.*

⁷³ Subjekti ka bashkëlidhur: (i) faturë të FSHU-së, shtator 2020, në emër të shtetasit M.S, me adresë rruga “R. Sh”; (ii) faturë e FSHU-së, mars 2024, në emër të shtetasit F.K, për të njëjtën adresë; (iii) kërkesë për shlyerje kredie të babait të tij, datë 12.12.2012; (iv) kërkesë për transferim fondesh, datë 8.1.2013; (v) kontratë nr. ***, datë 21.1.2021; (vi) kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 17.10.2005; (vii) kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 24.6.2009; (viii) mandatarkëtim për shlyerjen e kredisë nga shtetasit D.H, N.H, G.H dhe R.H, në total në shumën 3,773,561.1 lekë.

Për të garantuar marrjen e kredisë së prindërve, këta të fundit, por edhe banka, më kërkuan që të isha bashkëkredimarrës edhe unë, pasi për shkak të pagës dhe funksionit dhe të qenit klient i rregullt i bankës në shlyerjen e kredisë ekzistuese, konsiderohesha person me stabilitet me të ardhura, duke i krijuar bankës siguri e garanci dhe njëkohësisht siguri në miratimin nga bordi i Bankës së kredisë të kërkuar nga prindërit... Bashkëkredimarrës në të jemi 3 fëmijët madhorë (unë, G dhe D), babai R dhe mamaja dorëzanëse, pra gjithë familja.

Nga faturat e bankës (mandatarkëtime) të ruajtura prej prindërve rezulton se këstet e kësaj kredie janë shlyer prej tyre dhe vëllait G e motrës D, që kanë jetuar me prindërit gjatë shlyerjes së kësaj kredie... Burimi për të ardhurat për shlyerjen e saj kanë qenë të ardhurat dhe kursimet e familjes (pa mua, pasi unë kisha filluar të jetoja te F). Edhe kërkesat për shlyerjen e saj (bashkëngjitur) janë bërë nga babai.

*Kjo kredi është marrë nga prindërit me qëllim “blerjen e një apartamenti” te rruga “K.P”, Tiranë... që prindërit i kishin premtuar motrës që do ia blinin që ajo të fillonte jetën e saj. ...shuma e parave të marra nga banka nuk u përdor për “blerjen e apartamentit”. Për shkak të njohjes familjare me administratorin e “****” i është kërkuar nga prindërit ky favor (kontrata e sipërmarrjes) dhe vlera e parave të kredisë së kaluar në llogari të shoqërisë i janë dorëzuar prindërve. Kjo shpjegon edhe faktin e shlyerjes së shpejtë të kësaj kredie nga prindërit (duke e shlyer para kohe). Pra në asnjë moment prindërit nuk janë bërë as pronarë dhe as posedues të apartamentit te K.P, Tiranë, sipas kontratës së sipërmarrjes”.*

149. Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti rezulton se:

- a. Babai i subjektit ka lidhur kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 24.6.2009, për apartamentin me sipërfaqe ndërtimi 100.3 m² (apartamenti *, seksioni *, me soxhorno, 2 dhoma gjumi, 2 tualete, korridor), si dhe sipërfaqe verande 26 m². Për të njëjtin apartament është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 17.10.2005, në vijim të së cilës është lidhur edhe kontrata nr. ***, datë 21.1.2021, lidhur midis shoqërisë “***” sh.p.k. dhe shtetasit M.S, për blerjen e një apartamenti me sipërfaqe 89 m² dhe sipërfaqe verande 23 m², kati *, në rrugën “R.Sh”.
- b. Në datën 12.12.2012, babai i subjektit ka paraqitur kërkesë për shlyerje kredie dhe si burim për shlyerjen e saj ka deklaruar tekstualisht: *“Burimi i fondeve për shlyerjen e kësaj kredie janë kursimet e mia, të familjes time dhe para të marra hua tek të njohurit e mi”.*

150. Komisioni konstaton se subjekti në lidhje me këtë kredi ka dhënë deklarime kontradiktore, të cilat nuk përputhen me deklaratimet e tij ndër vite, konkretisht:

- i. Shpjegimet e subjektit në lidhje me situatën e supozuar se kredia është marrë për blerjen e një apartamenti për motrën e tij deklarohen për herë të parë nga ana e tij në këtë pyetësor. Gjithashtu, subjekti deklaroi për herë të parë që paratë nuk janë përdorur, por janë kthyer, duke u likuiduar kredia.

Subjekti, deri në përgjigjet e pyetësorit të parë në lidhje me këtë kredi, ka dhënë shpjegimet e mëposhtme:

- Në DPV/2009 ka deklaruar: *“Bashkëkredimarrës për kredinë për efekt të ardhurash, pasi familjarët nuk kishin të ardhurat që kërkonte banka”.*

- Në procesverbalin e ILDKPKI-së, në datën 21.3.2016, në lidhje me këtë kredi ka deklaruar: *“Duke qenë se unë në NBG Bank isha kredimarrës që në vitin 2008 për blerjen e apartamentit për të garantuar marrjen e kredisë që do të merrnin prindërit, kjo bankë më kërkoi që unë të isha bashkëkredimarrës... shlyerjet e kësaj kredie janë bërë kryer nga familjarët e mi, si burim për shlyerjen e tyre kanë qenë kursimet familjare dhe të ardhurat nga aktiviteti privat i babait tim në peshkim”.*
 - Në pyetësorin standard ka deklaruar: *“Siç kam shpjeguar edhe në ILDKPKI, me bankën kam qenë në marrëdhënie kredie më parë (kredia prej 20,000 euro) dhe nga banka u kërkua që unë si familjar i tyre dhe me të ardhura të qëndrueshme, si në vlerë ashtu edhe për shkak funksioni, të isha bashkëkredimarrës për t’u aprovuar kredia më shpejt dhe, në këto kushte, ishte më e garantuar aprovimi i kësaj banke nga bordi përkatës i bankës. Theksoj se kjo kredi nuk është përdorur nga unë (për këtë shkak dhe nuk është përmendur më pas në DPV-të pasardhëse) dhe janë paguar kështu e është shlyer nga prindërit dhe familjarët e mi. Gjendja aktuale e shlyer totalisht”.*
- ii. Subjekti edhe në përgjigjet e dhëna në pyetësorin nr. 1 është kontradiktor në lidhje me shlyerjen e kredisë, pasi fillimisht deklaroi se burimi kanë qenë të ardhurat e prindërve të tij dhe më pas deklaroi se kjo kredi nuk është përdorur, duke u kthyer. Ky deklarim i subjektit nuk përputhet as me deklaratimet e babait të tij në datën 12.12.2012, ku ai ka deklaruar si burim kursimet e tij dhe hua.
- iii. Subjekti është kontradiktor në deklaratimin e tij se familjarët e tij nuk i kishin të ardhurat që kërkonte banka, ndërkohë që babai i tij deri në 1 mars 2010 ka pasur depozitë në vlerën 24,613 euro pranë bankës në të cilën është marrë kredia, vlerë e cila për më tepër është përdorur si garanci për kredinë e marrë nga subjekti.
- iv. Deklarimet kontradiktore të subjektit vijojnë, pasi ai ka deklaruar se nuk ka jetuar me prindërit e tij, ndërkohë që është marrë dhe shlyer kjo kredi (kredia është marrë në shtator të vitit 2009 dhe është shlyer në vitin 2012), deklarim i cili nuk përputhet me deklaratimet e tij në pyetësorin standard, ku ka deklaruar se: *“Apartamenti është bërë i banueshëm që nga fundi i vitit 2009, mbase nga muaji nëntor i atij viti. Kam filluar të jetoj aty me ditë, kryesisht fundjavave në fillim. Kryesisht jetoja në banesën në S dhe me prindërit, ndërsa nga nëntori i vitit 2010 kam jetuar në këtë apartament në zonën e F”.*

151. Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti duket se kjo kredi nuk është marrë për blerjen e një apartamenti, pasi rezulton se i njëjti apartament për të cilin babai i subjektit ka lidhur kontratën e sipërmarrjes i është shitur më herët një shtetasi tjetër. Me këtë shtetas është lidhur edhe kontrata e shitblerjes. Për rrjedhojë, duket se nga ana e subjektit dhe babait të tij janë kryer veprime fiktive në lidhje me këtë kredi. Ndërkohë, subjekti nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacion për kthimin e shumës nga shoqëria tek ai apo familjarët e tij. Në këtë periudhë ka qenë në ndërtim apartamenti në rrugën “M.T” dhe kjo shumë mund të ketë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të ndërtimit të këtij apartamenti.

151.1 Në vijim, Komisioni konstaton se deklaratimet e subjektit në pyetësorin nr. 1 nuk janë në të njëjtën linjë me deklaratimet e tij ndër vite, por as me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, për rrjedhojë duket se nga ana e tij është bërë përpjekje për të kryer deklarim të pasaktë, si dhe për të fshehur përdorimin real të kësaj kredie. Ky konstatim përforcohet edhe nga fakti

se kjo kredi është marrë në të njëjtën periudhë kur është krijuar pasuria apartament me sipërfaqe 131 m², duke u ngritur dyshime që mund të jetë përdorur për përfundimin e këtij apartamenti.

151.2 Në lidhje me shlyerjen e kësaj kredie, subjekti ka depozituar dokumentacion provues se depozitimet në llogarinë e tij për shlyerjen e saj janë kryer nga familjarët e tij. Nga dokumentacioni i administruar dhe depozituar nga subjektit nuk provohet se familjarët e tij kishin të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kryerjen e këtyre depozitimeve.

152. Në përfundim, duke marrë në konsideratë: (i) përpjekjen e subjektit për të fshehur përdorimin real të kësaj kredie; (ii) mungesën e të ardhurave të mjaftueshme të ligjshme të familjarëve të subjektit për shlyerjen e saj; (iii) deklaratimet kontradiktore të subjektit në lidhje me burimin e shlyerjes së kësaj kredie; si dhe (iv) të faktin që kredimarrës është subjekti, pasi kjo kredi është depozituar në llogarinë e tij dhe jo të ndonjë familjari të tij – Komisioni ka përfshirë në analizën financiare marrjen dhe shlyerjen e kësaj kredie.

152.1 Nga analiza financiare⁷⁴ duket se subjekti nuk ka pasur mundësi për shlyerjen e kësteve të kredisë për vitin 2010 në vlerën 1,249,298.93 lekë, për vitin 2011 në vlerën 217,993.57 lekë dhe për vitin 2012 në vlerën 2,555,880.4 lekë.

153. Në përfundim në lidhje me kredinë në shumën 3,100,000 lekë konstatohet se:

- i. Kredia është disbursuar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, i cili ka bërë edhe transferimin e saj tek shoqëria “****” sh.p.k.
- ii. Subjekti gjatë hetimit është përpjekur të japë deklaratime të pasakta me qëllim fshehjen e përdorimit real të kësaj kredie.
- iii. Kjo kredi mund të jetë përdorur për përfundimin e apartamentit me sipërfaqe 131 m².
- iv. Subjekti është përpjekur për të disatën herë për të shmangur veten nga përfshirja në një marrëdhënie e cila mund të penalizojë procesin e tij të rivlerësimit të pasurisë.
- v. Prindërit e subjektit nuk kanë pasur nevojë për të marrë kredi, për sa kohë ato kishin një depozitë në të njëjtën bankë në vlerën 24,000 euro (2,566,988.84 lekë) dhe nuk kishin qëllim, siç deklaroi subjekti, për blerjen e ndonjë pasurie.
- vi. Prindërit e subjektit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për shlyerjen e kësaj kredie.
- vii. Kredia është shlyer në llogarinë e subjektit, ndërkohë që llogaria mund të hapej në emër të kredimarrësve të tjerë pa asnjë pengesë ligjore.

154. Për sa më sipër, duket se:

- i. Subjekti nuk ka dhënë deklaratime të sakta, duke u përpjekur të fshehtë përdorimin real të kësaj kredie.
- ii. Subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për shlyerjen e kësaj kredie.

155. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi⁷⁵ se në vitin 2010 ka qenë në cilësinë e bashkëkredimarrësit në kontratën e kredisë së datës 14.10.2009, në shumën 3,100,000 lekë dhe

⁷⁴ Shihni tabelën nr. 11 të rezultateve të hetimit.

⁷⁵ Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

me afat maturimi 15.10.2024, marrë prej familjes së tij pranë ish-NBG Bank, sot ABI Bank... Përfshirja e tij në këtë kontratë kredie erdhi si pasojë e faktit se bankës i kërkohej që një prej kredimarrësve të paktën të gëzonte një pagë të lartë dhe siguri e qëndrueshmëri punësimi... Për shkak të nevojës dhe urgjencës së babait për të siguruar burime për të blerë një apartament, si dhe për shkak të marrëdhënies shumë të ngushtë, i ka ardhur shumë natyrshëm të bashkohej me të gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes për të firmosur si bashkëkredimarrës në këtë kredi... Në lidhje me shlyerjen e kësaj kredie, sqaron se fakti që kjo kredi nuk është paguar prej tij provohet qartësisht nga të gjitha mandatet e pagesave të kryera nga familja e tij... Shlyerjet pjesore të parakohshme për këtë kredi janë kryer:

- Në datën 18.3.2010, nga babai i tij R.H është depozituar shuma 1,155,000 lekë, e cila është marrë nga banka për shlyerjen pjesore të parakohshme të kredisë, më datë 14.4.2010.
- Në datën 12.4.2012 është depozituar shuma 1,050,000 lekë, e cila ka shërbyer për likuidimin pjesor të kredisë.
- Në datën 28.12.2012 është depozituar shuma 859,000 lekë, e cila ka shërbyer për shlyerjen totale të kredisë.

Shumat e shlyera e kanë burimin tek gjendja cash në banesë, e administruar nga prindërit, dhe konkretisht:

- a) Nga kthimi i shumës mbi 3 milionë lekë nga administratori i shoqërisë “***” sh.p.k., veprim i cili ka ndodhur brenda një jave nga disbursimi i kredisë, në datën 15.10.2009;
- b) Pas tërheqjes së depozitës së lënë si cash kolateral për kredinë e tij po në NBG Bank. Depozita me afat është thyer para afatit dhe është tërhequr nga babai me pjesë nga data 1 deri në 16 mars 2010.

Shuma prej 22,500 euro, të cilat prindërit dispononin, ndodhej e ngurtësuar në NBG Bank si cash kolateral për kredinë prej 20,000 euro të marrë në fillim të vitit 2008. Në momentin e nevojës për të blerë një apartament tek K.P, për motrën e tij u gjykua që do të duhej të merrej edhe një kredi, përveç depozitës së ngurtësuar të babait, e cila mund të merrej prej tij në çdo moment që prindërit do të kishin nevojë. Në vitin 2009, tregu i pasurive të paluajtshme ishte rritur dhe një apartament kushtonte më shumë se 25 apo 30 mijë euro. Kur prindërit do të ishin gati për të blerë një apartament, depozita e tyre, e vendosur si cash kolateral, do të thyhej dhe do të zëvendësohej me kolateral pronë, veprim i cili ndodhi në vitin 2010... Subjekti ka kërkuar që shlyerja e kësaj kredie të mos përfshihet në analizën e tij, si dhe pretendon se prindërit e tij kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për shlyerjen e saj.

156. Pasi analizoi shpjegimet dhe provat⁷⁶ e paraqitura nga subjekti, Komisioni vlerëson se ato nuk janë bindëse. Pavarësisht pretendimeve të subjektit që kjo kredi nuk është marrë nga ana e tij, Komisioni do të bazohet në kontratën e kredisë, e cila është nënshkruar nga subjekti, ku rezulton se ai është kredimarrës. Për më tepër, kredia është disbursuar në llogarinë e tij, si dhe nga ana e tij janë kryer veprimet në lidhje me përdorimin e saj. Është e vërtetë që depozitimet për shlyerjen e kësaj kredie janë bërë nga familjarët e subjektit, por për sa kohë ai nuk arriti të

⁷⁶ (i) Deklaratë noteriale nr. ***, datë 8.7.2024; (ii) kontratë hipoteke nr. ***, datë 25.9.2009; (iii) kontratë hipoteke nr. ***, datë 27.1.2010; (iv) kontratë kredie datë 25.9.2009.

provonte të ardhurat e ligjshme të tyre, shumat e kredituara do të konsiderohen në analizën financiare të subjektit.

157. Në lidhje me deklaratat noteriale të depozituara, ato nuk kanë vlerë provuese, pasi nuk përputhen me dokumentacionin zyrtar të kohës të administruar gjatë hetimit administrativ, nga ku provohet që veprimet në lidhje me këtë kredi janë kryer nga subjekti i rivlerësimit. Për më tepër, deklaratat noteriale nuk shoqërohen me dokumentacion provues, duke mbetur në nivel deklarativ.

158. Në lidhje me pretendimin e subjektit se shuma 3,000,000 lekë është kthyer brenda javës, për rrjedhojë është kjo vlerë që ka shërbyer për shlyerjen e kredisë, është i pabesueshëm, pasi ai nuk përputhet me dokumentacionin e kohës, më konkretisht:

- a. Deklaratën e bërë nga babai i tij për shlyerjen pjesore të kredisë, ku si burim nuk rezulton të jetë deklaruar kthimi i kredisë, duke u provuar në këtë mënyrë që kjo kredi është përdorur dhe ka pasur një destinacion për të cilën subjekti ka refuzuar ta deklarojë.
- b. Nxjerrjen e llogarisë bankare, nga ku rezulton se kjo kredi nuk është shlyer menjëherë, por për një periudhë 3-vjeçare.

159. Në lidhje me pretendimin e subjektit për përdorimin e shumës 22,000 euro për shlyerjen e kësaj kredie, Komisioni vlerëson se ajo mund të merret në konsideratë, duke u përfshirë në analizën e vitit 2010, por nga ana tjetër, duke qenë se nuk provohet burimi i ligjshëm i kësaj vlere, sërish e bën të cenueshëm justifikimin me burime të ligjshme të shlyerjes së kredisë në vitin 2010. Deklarimi i subjektit për përdorimin e shumës 22,000 euro për shlyerjen e kredisë përforcon dyshimet e Komisionit se depozita prej 22,000 euro në fakt ka qenë e subjektit, pasi bazuar edhe në vetë deklaratimet e tij ka shërbyer për shlyerjen e një kredie të marrë prej tij, për të cilën nuk u arrit të evidentohet destinacioni real i saj.

160. Në lidhje me pretendimin e subjektit për të ardhurat nga peshkimi të babait të tij, ato bazuar në analizën e mësipërme të Komisionit, por dhe në deklaratimet e babait të subjektit (ku nga ana e tij nuk rezulton të jetë deklaruar në bankë si burim për shlyerjen e kësaj kredie), nuk do të merren në konsideratë. Nga ana e subjektit, krijimi i këtyre të ardhurave mbetet në nivel deklarativ.

161. Në përfundim të hetimit mbeti e paqartë për Komisionin përdorimi i kësaj kredie, duke e bërë të pamundur analizimin e plotë të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit. Nga ana e tij është vijuar të jepen deklaratime kontradiktore, të cilat e kanë bërë të pamundur dhënien e një vlerësimi të plotë për këtë kredi. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se subjekti ka tentuar të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë kredinë e marrë në NBG Bank në shumën 3,100,000 lekë, duke deklaruar të dhëna të pavërteta apo të pasakta, ose duke mos i deklaruar fare ato, me qëllim që procesi i kontrollit e verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të subjektit të rivlerësimit. Subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk është treguar bashkëpunues me Komisionin, në kuptim të nenit 48 të po këtij ligji.

162. Në këto kushte, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të subjektit marrjen dhe kthimin e kësaj kredie, duke u bazuar në dokumentacionin e kohës, nga ku rezulton që të gjitha

veprimet janë kryer nga llogaria bankare e subjektit. Fakti se shumat e depozituara janë kryer nga familjarët e tij vlerësohet se është irrilevante, pasi ato janë bërë për efekt të faktit se subjekti ka qenë në punë në Elbasan, si dhe nga ana e tij nuk u provua burimi i ligjshëm i të ardhurave të familjarëve të tij.

162.1 Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shlyerjen e kredisë për vitin 2011 në vlerën 217,993.57 lekë dhe për vitin 2012 në vlerën 2,555,880.4 lekë.

163. Në DPV/2010, subjekti deklaron hua marrë vëllait G.H, në vlerën 100,000 lekë

163.1 Në lidhje me këtë hua, në pyetësonin standard subjekti ka sqaruar: *“Kam marrë hua te vëllai im G.H, në shumën 100,000 lekë të reja, në vitin 2010 (deklaruar më parë në DPV-të përkatëse). Gjendja aktuale e kësaj huaje është e pashlyer akoma, pasi vëllai ka deklaruar se nuk ka pasur nevojë për kthimin e saj”*.

163.2 Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se vëllai i subjektit ka depozituar shumën 68,300 lekë, në datën 16.3.2017, me emërtimin “Shlyerje detyrimi”, në llogarinë e subjektit në Credins Bank.

163.3 Në lidhje me këto konstatime, subjekti në përgjigje të pyetësonit nr. 1 ka shpjeguar se: *“Shuma e marrë hua vëllait G.H edhe sot nuk i është kthyer, pasi vëllai ka deklaruar se nuk ka pasur nevojë për kthimin e kësaj huaje. Arsyeja e marrjes së kësaj huaje në shumën 100,000 lekë ka qenë për nevoja personale të miat në atë vit (2010).*

Në statement-in e bankës(DPV/2017) në llogarinë e pagës si prokuror (ku kam edhe kartën e debitit të lidhur me këtë llogari) është pasqyruar në fletën nr. 2 se në datën 1.3.2017 (pra disa ditë para) unë kam bërë blerjen e një bilete avioni online nëpërmjet kësaj karte debiti, bileta ka kushtuar 68,300 lekë (ekuivalentimi i valutës me kursin e bankës). Bileta është prerë në emër të bashkëjetueses së vëllait G, shtetases V.D, me destinacion Kanadanë, ku edhe aktualisht jetojnë së bashku me familjen e tyre. Me orientimin tim, po në këtë llogari nga ku u ble kjo biletë, vëllai, G, ka derdhur shumën 68,300 lekë, që është vlera e biletës dhe ndaj është bërë përshkrimi “Shlyerje detyrimi”, pra detyrimi i lindur për blerjen e biletës për bashkëshorten e tij”. Bazuar në përgjigjet e subjektit rezulton se kjo hua është ende e pashlyer.

163.4 Për sa më sipër, duket se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* huan në shumën 100,000 lekë, marrë vëllait të tij në vitin 2010.

163.5 Komisioni pasi analizoi shpjegimet e subjektit vlerëson se pavarësisht vlerës së vogël subjekti duhej ta kishte deklaruar këtë hua në deklaratën *Vetting*, por kjo pasaktësi e subjektit nuk përbën shkak autonom për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit.

164. Nga hetimi i Komisionit është konstatuar se në kontratat e *overdraft*-it të viteve 2014, 2015, 2016 dhe 2017 në Credins Bank adresa e deklaruar nga subjekti është rruga “M.T”, Tiranë. E njëjta adresë (rruga “M.T”, p. **, ap. *, Tiranë, Shqipëri) është deklaruar nga bashkëjetuesja e subjektit në kontratën e lidhur me Tirana Bank. Kjo adresë konfirmohet edhe në dokumentin kërkesë për transfertë fondesh, datë 2.10.2015, të Tirana Bank.

165. Drejtoria Vendore ASHK Tiranë Jug, me shkresën nr. ** prot., datë 2.3.2021, ka vënë në dispozicion të Komisionit kartelën e pasurisë nr. ***, z. k. ***, me adresë rruga “M.T”, sh. *,

ap. *, me sipërfaqe 131 m². Ky apartament rezulton në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, z. R.D.H, fituar me leje legalizimi nr. ***, datë 30.9.2009.

166. Në lidhje me këtë apartament, subjekti në pyetësorin nr. 1⁷⁷ ka deklaruar: “Në këtë apartament kanë jetuar prindërit e mi dhe familjarët (vëllai G, motra D) deri në momentin që janë shkëputur nga prindërit dhe kanë filluar jetesën në familjet e tyre. Unë me bashkëjetuesen kam filluar të banoj në këtë apartament që nga periudha dhjetor 2022, siç e kam deklaruar dhe në DPV/2022. Aktualisht, ky apartament përdoret nga unë, bashkëjetuesja M.M dhe dy djemtë tanë. Pronësia e apartamentit është e prindërve të mi. Unë dhe bashkëjetuesja mund ta kemi deklaruar si adresë vetëm për efekte postare, adresë e sigurt, ku mund të gjendeshin prindërit prezent, por për të jetuar aty, siç shpjegova, kemi filluar të jetojmë në dhjetor 2022.

Në lidhje me shpenzimet e kryera për këtë apartament nuk jam në gjendje të jap informacion, pasi unë nuk kam qenë i përfshirë në këtë proces, është marrë babai, R. Për shkak të gjendjes shëndetësore (vuan prej rreth 4 vitesh nga parkinsoni), me gjithë përpjekjet e mia për të marrë informacion, nuk kam mundur të marr një informacion të saktë e të plotë...

Për sa i përket mobilimit të apartamentit në kohën që kanë jetuar familjarët e mi, sipas shpjegimeve të prindërve (mamasë kryesisht) një pjesë e mobilimit janë shfrytëzuar mobilitet/pajisjet e banesës paraardhëse. Në total, për një periudhë 2-3 vjeçare është bërë një shpenzim rreth 200,000 lekë. Kuptohet gjatë viteve të jetesës në këtë apartament prindërit dhe familjarët që kanë jetuar aty kanë bërë edhe shpenzime normale që vinin si rezultat i përdorimit/amortizimit të mobilieve dhe pajisjeve, ndërsa mobilimi aktual i apartamentit (banoj unë aktualisht) është bërë me të ardhurat nga paga e kursime familjare në shumën 500,000 lekë (deklaruar në DPV/2023). Bashkëngjitur DPV/2023.

Në momentin që unë kam filluar të banoj në këtë apartament, kam bërë rikonstrukcion të tij. Shpenzimet për këtë rikonstrukcion janë deklaruar në DPV/2022 dhe burimi i shpenzimeve kanë qenë kursime e të ardhura nga paga ime dhe të ardhurat e bashkëjetueses. Bashkëngjitur DPV/2022”.

167. Pasi analizoi shpjegimet e subjektit në lidhje me këtë apartament, Komisioni konstaton se ato nuk janë bindëse. Nga hetimi i Komisionit duket se ky apartament është përdorur nga subjekti duke filluar nga viti 2014, kohë në të cilën subjekti ka deklaruar bashkëjetesën me znj. M. Subjekti është përpjekur të mos japë shpjegime të detajuara në lidhje me këtë apartament duke pretenduar sëmundjen e babait të tij, ndërkohë që për apartamentin në rrugën “H.P”, i cili sërish ka si burim të ardhurat e babait, subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara që u përkasin viteve 1992 – 1998.

167.1 Në kushtet që subjekti ka konfirmuar se ka në posedim këtë apartament, si dhe bazuar në dyshimet për fshehje pasurie, Komisioni ka kryer një analizë financiare për mundësinë e prindërve të subjektit për këtë apartament, ku konstaton se subjekti më shumë se një herë deklaroi se mobilimi i apartamenteve është bërë me mobilitet në banesën e mëparshme. Edhe në këtë rast subjekti ka bërë të njëjtin deklaram. Ky deklaram i tij nuk përputhet, pasi banesa e

⁷⁷ Subjekti ka bashkëngjitur: (i) llogarinë bankare në NBG Bank, krijuar në dhjetor të vitit 2007; (ii) pjesë të DPV/2022, ku ka deklaruar shkëmbimin e këtij apartamenti, si dhe shpenzime rikonstrukcioni në vlerën 400,440 lekë; (iii) pjesë të DPV/2023, ku subjekti ka deklaruar mobilimin në shumën 500,000 lekë; (iv) kontratë nr. ***, datë 14.6.2002; (v) kontratë shitjeje datë 6.9.1993.

mëparshme e prindërve është ajo në rrugën “H.P”, e cila vijon të jetë e banueshme për sa kohë është dhënë me qira dhe duket se është bërë me qëllim shmangien e një vlerësimi të plotë të Komisionit për këtë pasuri, e cila duket se nuk është përdorur asnjëherë nga prindërit e subjektit.

168. Në kushtet kur subjekti nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me kohën dhe vlerën e ndërtimit të këtij apartamenti, Komisioni është bazuar në ortofotot e pallatit ku ndodhet apartamenti, nga ku rezulton se është ndërtuar në periudhën 2007 – 2015. Meqenëse Komisioni e ka të pamundur për të përcaktuar saktësisht kohën e ndërtimit të këtij apartamenti, analiza financiare dhe kostoja e ndërtimit sipas EKB-së do të bëhet referuar vitit 2009, kohë në të cilën është bërë edhe regjistrimi i tij.

169. Nga analiza financiare⁷⁸ duket se prindërit e subjektit dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vlerën 3,483,664.97 lekë. Në lidhje me këtë vlerë, ajo duket se përputhet me shumën e kredisë së marrë nga subjekti në vitin 2009, të cilën ai ka deklaruar se nuk e ka përdorur. Për rrjedhojë, bazuar edhe në konkluzionet në pikën 153, duket se kredia është përdorur për mbulimin e shpenzimeve të këtij apartamenti.

170. Në përfundim, në lidhje me këtë apartament, konstatohet se:

- Ai është përdorur nga subjekti dhe bashkëjetuesja e tij duke filluar të paktën nga viti 2014.
- Prindërit e subjektit duket se nuk e kanë përdorur këtë apartament.
- Subjekti duket se ka përdorur shumën 3,100,000 lekë të marrë kredi nga NBG Bank në vitin 2009 për mbulimin e shpenzimeve të këtij apartamenti.
- Prindërit e subjektit duket se nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për ndërtimin e tij, por as për shlyerjen e kredisë.
- Subjekti nuk ka dhënë shpjegime të plota, duke u përpjekur të shmangë Komisionin nga kryerja e një analize të plotë financiare në lidhje me këtë apartament.
- Subjekti ka deklaruar zotërim të këtij apartamenti në vitin 2022, duke i lënë në përdorim prindërve të tij një apartament me sipërfaqe 58 m².
- Subjekti e ka rinovuar dhe mobiluar këtë apartament duke shpenzuar një vlerë të deklaruar prej 900,440 lekësh.

Për rrjedhojë, duket sikur ky apartament është në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

171. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi⁷⁹ se *kjo pasuri është fituar nga familja e tij sipas lejes së legalizimi nr. ***, datë 30.9.2009, në emër të babait, shtetasit R.H. Ai nuk ka dhënë asnjë kontribut për krijimin e kësaj pasurie, nuk gëzon asnjë të drejtë pronësie mbi të dhe, për pasojë, nuk ka pasur detyrim për deklarimin e saj për qëllime të procesit të rivlerësimit. Këtë pasuri për herë të parë e ka deklaruar në DPV/2022, kur ka vendosur të banojë me bashkëjetuesen e tij (pasurinë përdorim) dhe dy fëmijët, në kushtet kur kjo banesë ofron hapësirë më të përshtatshme për jetesën e katër personave, si dhe bazuar në marrëdhënien e ngushtë familjare që ka me prindërit e tij... Fakti i deklarimit të adresave në kontratat e overdraft-it të vitit 2014, 2015, 2016, 2017 në Credins Bank, lidhet për të vetmen arsye që kjo*

⁷⁸ Shihni tabelën nr. 15 të rezultateve të hetimit.

⁷⁹ Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

adresë e vendosur pranë bankës ka ardhur vetëm si pasojë e plotësimit të saj të njëjtë nga të dhënat e mëparshme të disponuara nga familja e tij...

Fakti i përdorimit të kësaj pasurie nga prindërit e tij provohet me një sërë aktesh shkresore si vijon, deklaron subjekti:

- *Referuar pagesave utilitare, sikundër janë faturat tatimore të shitjes së energjisë elektrike të datës 2.5.2012 e në vijim, aktmarrëveshjes për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike të datës 12.3.2015, e nënshkruar mes OSHEE-së dhe nënës së tij N. H, procesverbaleve dhe mandateve të arkëtimeve të datave 12.5.2015 e 14.7.2015, konsumator të kësaj pasurie ka qenë vetëm familja e tij për periudhën përkatëse.*
- *Referuar praktikës së aplikimit të kryer nga ana e babait të tij dhe nënës për pajisje me vizë kanadeze, babai ka referuar pikërisht adresën ku ka banuar në vitin 2018, ap. **, rruga “B. Xh”.*
- *Referuar kontratës së pajtimtarit për shërbimin publik telefon fiks, të datës 1.7.2011, si dhe të librezës së pagesës së saj, rezulton që këto pagesa janë kryer nga babai i tij.*
- *Referuar faturave tatimore të shitjes në “**” sh.p.k. për blerje pajisjesh nga nëna e tij, rezulton se në deklarinimin e adresës së saj të vendbanimit, në datat 7.6.2019 dhe 12.6.2019, është rruga “B.Xh”, ndërtesa *, shk. *.*
- *Referuar kontratës për shërbimet e telekomunikacionit ***, të lidhur në datën 20.10.2017 midis kësaj shoqërie dhe babait të tij, rezulton se ky shërbim është lidhur pikërisht për pasurinë e ndodhur në adresën rruga “B.Xh”, p. **, k. *.*
- *Referuar edhe shkresave kthim përgjigjeje të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, këto shkresa i janë drejtuar shtetasit R.H, në adresën e deklaruar rruga “B.Xh”, p. **.*

171.1 Subjekti sërish jep shpjegime në lidhje me kredinë në shumën 3,100,000 lekë, duke deklaruar se nëse do të ishte paraqitur nevoja për të marrë kredi për ndërtimin e shtesës tek rruga “M.T” (në pronësi të prindërve të tij), prindërit... do të shkonin në bankë për të marrë kredi për ndërtimin e banesës, banka do të kishte kërkuar një kredimarrës/garantor me statusin dhe të ardhurat e tij, pra përsëri do të ishte përfshirë edhe ai si bashkëkredimarrës. Pra, nuk ka asnjë arsye logjike se përse do duhej të merrte kredi për një pronë tjetër që të investohej në pronën në rrugën “M.T”, ndërkohë që mund të kërkohej një kredi nga prindërit e tij, direkt për ndërtimin e shtesës së apartamentit në rrugën “M.T”...

171.2 Më tej, subjekti vijon shpjegimet e tij duke deklaruar se në mars të vitit 2010, babai i kërkoj që të tërhiqte edhe paratë e vëna si kolateral për kredinë e tij, pasi i duheshin për të bërë edhe pagesa të tjera. Paralelisht, ai priste përfundimin e punimeve - finitura të shtesës së apartamentit të tij, sepse ky ishte edhe kushti i pagesës për pjesën e mbetur të çmimit, pra babai posedonte gjendje cash në shtëpi shumën 3 milionë lekë dhe 24,000 euro, të cilën e tërhoqi me pjesë nga depozita e ngurtësuar si cash kolateral. Fillimisht bëri një shlyerje të rëndësishme të kredisë në NBG Bank, nuk preferoi ta bënte të gjithën njëherësh, pasi nuk dihej nëse pagesat për banesën mund të dilnin jashtë preventivave të parashikuara... finiturat e brendshme për shtesën e apartamentit përfunduan në pranverën e vitit 2010 dhe rreth muajit maj-qershor babai bëri edhe disa pagesa pjesore deri në kompletimin e plotë të pagesës, që u takonte punimeve të kryera gjatë periudhës 2008 – verë 2009 dhe ndonjë finiturë të kryer gjatë fillimit të vitit 2010... Në lidhje me koston e shtesës së ndërtuar me sip. 131 m², ajo është përlllogaritur

nga Komisioni bazuar në çmimin e referencës së EKB-së dhe si vit ndërtimi është konsideruar viti 2009... Nga ortofotot e vitit 2007 duket që janë ngritur 5 katet e shtesës dhe është vendosur çatia. Nga bisedat e kohës me babain ka mësuar se ndërtimi është shtrirë në kohë; ai ka filluar qysh në vitin 2006 dhe për vitet 2006 e 2007 shtesa kishte arritur në më pak se gjysmën e volumit të punimeve. Pagesat janë bërë për secilin vit. Ndërtimi ka vijuar përgjatë vitit 2008 dhe ka mbaruar në mesin e vitit 2009. Për shkak të disa finiturave të brendshme të cilat u përfunduan në vitin 2010, edhe pagesa e tretë u bë në vitin 2010... Pagesat janë kryer sipas ecurisë së punimeve. Kështu, nga bisedat me prindërit, volumin dhe vlerën e paguar të punës do ta ndante:

- në vitin 2006 janë kryer 20% të punimeve ose, e shprehur në sipërfaqe punimesh, 26 m²;
- në vitin 2007 janë kryer 25% e punimeve ose 33 m²;
- në vitin 2008 deri në verën e vitit 2009 janë kryer 55% e punimeve ose 72 m²;

Duke përdorur çmimet e EKB për vitet 2006 – 2008, atëherë kostoja e gjithë ndërtimit do të ishte 3,457,365 lekë⁸⁰ ...Sa i takon mundësisë financiare të prindërve për të paguar ndërtimin e banesës, meqenëse pagesat janë kryer në vitet 2006, 2007 dhe 2010...

172. Pasi analizoi shpjegimet dhe provat⁸¹ e paraqitura nga subjekti, Komisioni vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti edhe pas kalimit të barrës së provës nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve të tij për ndërtimin e këtij apartamenti. Ai nuk arriti të provonte që ky apartament është përdorur nga prindërit e tij, për më tepër nuk dha asnjë shpjegim të qartë në lidhje me destinacionin e kredisë në shumën 3,100,000 lekë.

172.1 Depozitimi i deklaratave noteriale gjatë procesit të rivlerësimit nuk mund të merret në konsideratë, pasi ato nuk përputhen me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ dhe nuk mund të prevalojnë mbi vetë deklaratimet e subjektit dhe bashkëjetueses së tij në bankat e nivelit të dytë, ku ata me vullnetin e lirë të tyre kanë deklaruar si adresë banimi këtë pasuri. Për rrjedhojë, edhe pretendimi i subjektit se adresa është vënë nga punonjësja e bankës nuk qëndron, për sa kohë e njëjta adresë është deklaruar nga subjekti dhe bashkëjetuesja e tij pikërisht në kohën e deklaratimit të bashkëjetesës në deklaratën periodike vjetore.

173. Subjekti ka përmendur vendimin nr. 10/2020 të Kolegjit, i cili nuk gjen zbatim në rastin e subjektit, pasi atij i ka kaluar barra e provës për fshehje pasurie. Pikërisht bazuar në këtë orientim të Kolegjit, Komisioni nuk i ka kaluar barrën e provës subjektit për të provuar ligjshmërinë e burimeve për blerjen e këtij apartamenti, por i ka kaluar barrën e provës për fshehje pasurie.

⁸⁰ Shpenzimet e kryera janë 661,864 lekë për vitin 2006; 818.521 për vitin 2007; 1.976.980 për vitin 2008.

⁸¹ Subjekti ka depozituar: (i) deklaratë nr. ***, datë 8.7.2024; deklaratë nr. ***, datë 8.7.2024; deklaratë ***, datë 8.7.2024 (ii) kontratë pajtimtari për shërbimin e telefonisë, datë 9.1.2012; (iii) kthim përgjigjeje e FSHU-së nr. *** prot., datë 4.7.2024; fatura të OSHEE-së, pagesa të detyrimeve ndaj OSHEE-së dhe aktmarrëveshje për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura; (iv) kthim përgjigjeje e Gjendjes Civile Belsh nr. ** prot., datë 25.6.2024; nr. ** prot., datë 1.7.2024; nr. ** prot., datë 1.7.2024; (v) vërtetim i ISSH-së, datë 28.5.2024; vërtetim për bazën e vlerësuar, lëshuar nga DRSH-ja Gjyrokastër për G.H; referencë “A.G” sh.a. për shtetasin G.H; vërtetim i ISSH-së nr. *** prot., datë 28.5.2024, për shtetasin G.H; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, N. H; (vi) aplikim për vizë kanadeze; (vii) kontrata e pajtimtarit për telefonin fiks, shtetasi R.H; (viii) fatura (3 copë) lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k.; (ix) aplikim për shërbimet e telekomunikacionit “****”; (x) kthim përgjigjeje e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë nr. N-*** prot. dhe nr. R-**, datë 8.5.2018.

174. Subjekti ka vijuar të japë deklaratime kontradiktore në lidhje me këtë apartament, sikundër ka bërë me të gjitha pasuritë e tjera të deklaruara më lart. Më konkretisht:

- i. Subjekti gjatë hetimit ka refuzuar të japë informacion për kohën e ndërtimit të këtij apartamenti, duke deklaruar shprehimisht: *“Për shkak të gjendjes shëndetësore (babai vuan prej rreth 4 vitesh nga parkinsoni), me gjithë përpjekjet e mia për të marrë informacion, nuk kam mundur të marr një informacion të saktë e të plotë”*.

Ndërkohë, pas kalimit të barrës së provës, subjekti deklaroi një informacion të detajuar në lidhje me këtë pasuri, duke deklaruar si burim informacioni bisedat e kohës me babain e tij.

- ii. Subjekti në deklaratimet e tij pas kalimit të barrës së provës nuk deklaroi qartësisht se kur kanë përfunduar pagesat për këtë apartament, duke deklaruar fillimisht se pagesa e tretë u bë në vitin 2010, ndërkohë në një paragraf më poshtë subjekti deklaroi se pagesat janë bërë në vitet 2006 – 2009 dhe një pjesë për finiturat në vitin 2010, ndërsa vijon duke listuar kohën dhe vlerën e pagesave për periudhën 2006 – 2009.

Këto deklaratime të subjektit rreth banesës janë bërë për herë të parë pas kalimit të barrës së provës dhe vënies në dispozicion të analizës financiare, pasi subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim për këtë banesë, duke pretenduar se nuk kishte mundësi sepse babai i tij ishte i sëmurë. Është e paqartë për Komisionin se si subjekti brenda dy muajve ka arritur të marrë një informacion kaq të detajuar për këtë banesë, duke specifikuar jo vetëm shpenzimet për çdo vit, por edhe kohën e kryerjes së finiturave.

- iii. Sipas deklaratave noteriale të depozituara nga subjekti, prindërit e tij kanë jetuar aty duke nisur nga viti 2009 – 2010, ndërkohë që vetë subjekti deklaroi se shtëpia nuk kishte përfunduar të paktën deri në mars të vitit 2010, ku ai shpjegon se paratë e tërhequra nga NBG Bank në vlerën 22,000 euro, në muajin mars, nuk u përdorën, pasi nuk kishin përfunduar finiturat e banesës. Ky deklaratim i subjektit nuk përputhet me deklaratimin e tij në pyetësonin nr. 1, ku në përgjigje të pyetjes 1/d ai ka deklaruar se prindërit e tij kanë nisur të jetojnë në këtë apartament nga fundi i vitit 2009.

175. Komisioni vlerëson se deklaratimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës janë bërë me qëllimin e vetëm të rregullimit të analizës financiare, duke e ndarë ndërtimin e apartamentit në kohë, si dhe duke u përpjekur të shmangë kohën e marrjes së kredisë në vitin 2009 me kohën e ndërtimit të apartamentit.

176. Komisioni vlerëson se pavarësisht kohës së ndërtimit të këtij apartamenti, familja e subjektit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e tij, bazuar në analizën e kryer nga Komisioni në lidhje me depozitën e krijuar në vitin 2007 dhe për ndërtimin e apartamentit në vitin 2009. Për rrjedhojë, koha e ndërtimit të këtij apartamenti nuk ka asnjë ndikim në analizën financiare, por, nëse merret ajo e deklaruar nga subjekti, rëndon pozitën e tij, sidomos analizën e vitit 2007. Për të mos rënduar pozitën e subjektit, Komisioni do të marrë si kohë ndërtimi atë të vitit 2009.

177. Në lidhje me provat e depozituara nga subjekti, ku rezulton se kontratat e utiliteteve janë në emër të prindërve të tij, ato nuk përjashtojnë, si dhe nuk provojnë që ata janë pronarë faktikë të kësaj pasurie, pasi gjatë procesit, por edhe në kohën e dhënies së këtij vendimi, këto kontrata janë sërish në emër të prindërve, pavarësisht se posedues i apartamentit është subjekti. Fakti që kontratat e utiliteteve janë në emër të prindërve të subjektit, nuk e përjashton nga përgjegjësia

subjektin, pasi Komisioni ndaj dhe i ka kaluar barrë prove për fshehje pasurie, se kjo pasuri nuk është në emër të subjektit, por nga të dhënat e administruara duket se është pasuri e fshehur e tij.

178. Në këto kushte, duke marrë në konsideratë: (i) faktin që ky apartament është rikonstruktuar dhe mobiluar me të ardhurat e subjektit, si dhe është në posedim të tij aktualisht; (ii) shkëmbimin e këtij apartamenti me një apartament me sipërfaqe më të vogël; (iii) refuzimin e subjektit për të dhënë shpjegime të qarta dhe të plota në lidhje me kohën e ndërtimit dhe vlerën e tij; (iv) mungesën e burimit të ligjshëm të të ardhurave të prindërve të tij për ndërtimin e këtij apartamenti; (v) mungesën e burimeve të ligjshme të subjektit për ndërtimin e këtij apartamenti; (vi) dyshimeve për përdorimin e kredisë së marrë nga subjekti në vlerën 3,100,000 lekë për ndërtimin e këtij apartamenti; (vii) se subjekti nuk arriti të provojë që ky apartament është përdorur ekskluzivisht nga prindërit e tij – Komisioni krijon bindjen se kjo pasuri është në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

178.1 Për sa më sipër, subjekti ka kryer fshehje të pasurisë në kuptim të nenit 33/5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

179. Drejtoria Vendore ASHK Tirana Jug, me shkresën nr. *** prot., datë 2.3.2021, ka vënë në dispozicion të Komisionit kartelë pasurie nr. ***, z. k. ***, në rrugën “M.T”, me sipërfaqe 58.10 m², në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

179.1 Ky apartament rezulton të jetë blerë nga subjekti me kontratën nr. ***, datë 10.7.2020, në vlerën 61,750 euro. Në datën 10.7.2020, subjekti ka kaluar shumën 61,750 euro për blerje apartamenti në llogarinë e noteres A.Xh.

180. Në lidhje me këtë apartament, subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1 ka shpjeguar se: *“Apartamenti nuk është përdorur nga unë, aktualisht aty banojnë prindërit e mi. Siç kam deklaruar në ILDKPKI në vitin 2021, apartamenti për disa muaj ka qenë i pabanueshëm dhe do i nënshtrhej rikonstruktimit. Këtë e vërtetojnë dhe faturat përmbledhëse të energjisë elektrike për këtë apartament. Vlera e mobilimit të këtij apartamenti është 350,000 lekë të paguara nga unë dhe shpenzimet për mobilimin e tij janë deklaruar në DPV/2021. Gjithashtu, nga unë janë paguar edhe shpenzimet për rikonstruktimin e pjesshëm të tij në shumën 450,000 lekë, të deklaruara në DPV/2022”.*

Subjekti ka vënë në dispozicion:

- pjesë të DPV/2021, ku deklaroi se ka blerë elektroshtëpiake në vlerën 350,000 lekë;
- pjesë të DPV/2022, ku deklaroi se ka shpenzuar shumën 450,000 lekë për rikonstruksionin e pjesshëm të apartamentit.

181. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti ka deklaruar pranë NBG Bank si adresë banimi: rruga “D.B”, pallatet tek kryqëzimi ngjyrë e kuqe, shk. *, ap. *. E njëjta adresë është deklaruar edhe nga nëna e tij, N.H.

181.1 Subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1 ka deklaruar: *“Sqaroj se kjo adresë duhet të jetë adresë e deklaruar nga mamaja ime N.H me shumë mundësi gjatë veprimeve për marrjen e kredisë në lek te NBG Bank ose kur mund të ketë bërë shlyerjen e ndonjë kësti kredie te kjo bankë. Për shkak të të qenit bashkëkredimarrës, mbase sistemi i bankës mund të ketë vendosur si adresë timen edhe këtë adresë të deklaruar nga mamaja te kjo bankë. Unë nuk kam jetuar asnjëherë te kjo adresë... te kjo banesë kanë jetuar për disa kohë prindërit e mi, së bashku me*

vajzën e tyre A.H... Sipas shpjegimit të prindërve, pronari ka qenë një shtetas me emrin H, mbiemrin nuk e mbajnë mend... Unë nuk e kam njohur dhe as takuar ndonjëherë pronarin e këtij apartamenti dhe as kam jetuar ndonjëherë atje. Në këto kushte, nuk mund të vë në dispozicionin tuaj asnjë informacion apo të dhënë tjetër”.

182. Në lidhje me këtë shpjegim të subjektit, Komisioni konstaton se ai është në nivel deklarativ, i pashoqëruar me dokumentacion provues. Subjekti kishte të gjitha mundësitë të merrte të dhëna të plota në lidhje me këtë apartament, duke vënë në dispozicion të Komisionit kopje të certifikatës së pasurisë së këtij apartamenti, si dhe dokument që të vërtetojë marrjen me qira të tij. Ky detyrim rrjedh nga fakti se: (i) ky apartament është deklaruar si adresë nga ana e subjektit në bankë; (ii) prindërit e tij kanë jetuar në këtë apartament për një periudhë kohe 2-vjeçare sipas deklarimeve të subjektit, duke u deklaruar nga nëna e subjektit si adresë banimi, si dhe për të provuar që nuk kemi të bëjmë me një pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

183. Për sa më sipër, duket se subjekti është përpjekur të japë deklaram të pasaktë me qëllim shmangien e Komisionit nga një hetim i plotë në lidhje me një apartament në rrugën “D.B”, duke u ngritur dyshime se kemi të bëjmë me një pasuri të fshehur të subjektit, e cila mund të jetë tjetërsuar nga ana e tij pa u deklaruar ndonjëherë.

184. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi⁸² se *sikundër ka sqaruar Komisioni në pyetësorin nr. 1, deklarimi i kësaj adrese pranë NBG Bank ka ardhur si pasojë e deklaramit të adresës së vendbanimit të prindërve të tij në atë periudhë... Në këtë banesë kanë jetuar për një periudhë të shkurtër sipas një marrëveshjeje qiraje të krijuar me pronarin e kësaj banese, të cilit i kujton vetëm emrin, që quhej H. Ai nuk ka jetuar në këtë banesë dhe për shkak të kohës së gjatë të kaluar dhe të faktit që nuk ka titullar/nuk ka qenë ndonjëherë posedues i saj, nuk arrin të identifikojë saktë dhe qartë vendndodhjen e saj, në mënyrë që të bëjë të mundur marrjen e dokumentacioneve përkatëse pranë ASHK-së, zyrës vendore përkatëse... Kalimi i një barre të tillë prove, e cila e detyron të marrë informacion lidhur me të dhënat pasurore të një pasurie e cila nuk i përket dhe nuk është objekt i këtij procesi rivlerësimi, cenon hapur mbrojtjen e të dhënave personale të palëve të treta, të cilat asnjëherë më parë nuk kanë pasur marrëdhënie me të... Parashikimet e nenit 5⁸³ të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, parashikojnë grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave në mënyrë të drejtë e të ligjshme dhe vetëm për qëllime specifike ligjore dhe, në rastin konkret, për sa kohë ai nuk ka asnjë lidhje posedimi/përdorimi/tjetërsimi me këtë pasuri, përveçse në përcaktimin e një adrese formalisht në bankë nga familjarët e tij për qëllime të procedurave formale të saj, konkludon se nuk mund të paraqesë objektivisht të dhëna mbi një pasuri, për të cilën e ka të ndaluar marrjen e informacionit për shkak të mbrojtjes së të dhënave personale.*

185. Pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, Komisioni vlerëson se jo vetëm që nuk janë bindëse, por qartas janë bërë për të shmangur dhënien e shpjegimeve të plota në lidhje me këtë pasuri. Subjekti deklaroi se kjo pasuri është deklaruar formalisht si adresë në bankë, ndërkohë që prindërit e tij të paktën sipas deklarimeve të subjektit kanë pasur një

⁸² Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

⁸³ Neni 5 i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, parashikon “1. Mbledhja e të dhënave personale bazohet: a) në përpunimin në mënyrë të drejtë e të ligjshme; b) në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime; c) në mjaftueshmërinë e të dhënave të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim”.

marrëdhënie qiraje, për rrjedhojë e gjithë baza ligjore e cituar nga subjekti, por edhe argumentimi i tij që e ka të ndaluar të marrë informacion, nuk qëndron. Prindërit e subjektit, por edhe subjekti kanë të drejtën ligjore për të marrë informacion, pasi nuk kemi të bëjmë me një pasuri që nuk lidhet me ta, por me një pasuri që kanë pasur të paktën një marrëdhënie qiradhënieje. Për subjektin ka qenë shumë e lehtë të shkojë në këtë banesë të kontaktojë pronarin dhe të kërkojë të dhëna të plota, pasi marrëdhënia e krijuar nga prindërit e tij është një marrëdhënie e njohur nga Kodi Civil. Nëse nga ana e pronarit do të refuzohej dhënia e këtyre të dhënave, subjekti mund të paraqiste një kërkesë në Komision për marrjen e provave dhe Komisioni, në zbatim të parashikimeve të nenit 49-50 të ligjit nr. 84/2016, do të siguronte të gjithë informacionin e nevojshëm për qartësimin e kësaj pasurie. Komisioni vlerëson se këto shpjegime të subjektit, si dhe përpjekja e tij për të shmangur dhënien e një informacioni të plotë është bërë më qëllim fshehjen e kësaj pasurie, të cilën subjekti mund ta ketë blerë me kontratë porosie dhe më pas ta ketë tjetërsuar pa qenë nevoja e regjistrimit pranë ASHK-së. Meqenëse nuk u arrit të provohej fshehja e kësaj pasurie, Komisioni vlerëson se refuzimi për të dhënë shpjegime nga ana e subjektit duhet të klasifikohet sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, si dhe do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

186. Në përfundim të analizës financiare⁸⁴ prej fillimit të detyrës deri në deklaratën *Vetting*, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur mundësi financiare për krijimin e pasurive të tyre në vlerën -5,902,782.04 lekë.

187. Komisioni, duke marrë në konsideratë prapësimet dhe provat e paraqitura prej subjektit, ka pranuar një pjesë të pretendimeve të tij, të cilat mbështeten në provat si vijon:

- a. Mbi të ardhurat e prindërve subjekti ka paraqitur dokumentacion provues për të ardhurat e nënës së tij për vitin 1994, në vlerën 44,320 lekë.
- b. Mbi të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës, të cilat janë në vlerën 772,790 lekë, si dhe mundësia për kursim prej tyre në vlerën 584,879.50 lekë, janë përfshirë si likuiditet i mbartur para detyre i subjektit.
- c. Shpenzimet e pretenduara nga subjekti për udhëtimet jashtë vendit të mbuluara nga institucioni organizues për vitet 2011 dhe 2015, për të cilat subjekti ka paraqitur dokumentacion provues janë reflektuar në analizën financiare sipas praktikës së Komisionit.
- d. Përfshirja e depozitave të bashkëshortes para martesë si likuiditet i mbartur i saj në martesë në vlerën 1,023,020.35 lekë.

Për pasojë, rezultati negativ është reduktuar në vlerën -4,753,315.59 lekë.

188. Komisioni vlerëson të ndalet në pasuritë e regjistruara, të paktën formalisht, në pronësi të prindërve të subjektit, për të cilat nga hetimi rezultoi se:

- i. Prindërit e subjektit nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të justifikuar krijimin e tyre.
- ii. Këto pasuri janë përdorur nga subjekti.

⁸⁴ Shihni tabelën “Analiza financiare nga fillimi i detyrës deri në deklaratën *Vetting*” të rezultateve të hetimit.

- iii. Pasuria apartament në rrugën “M.T” është deklaruar edhe zyrtarisht nga subjekti në përdorim të tij në vitin 2022.
- iv. Subjekti gjatë procesit, por edhe pas kalimit të barrës së provës, ka dhënë shpjegime kontradiktore në lidhje me këto pasuri, duke u përpjekur të arrijë një rezultat pozitiv në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë.
- v. Subjekti në lidhje me kredinë në shumën 3,100,000 lekë, por edhe me depozitën bankare të prindërve të tij, pretendon se janë përdorur për të paguar një pjesë të vlerës së apartamentit në rrugën “M.T”, e cila në vlerësim të Komisionit është në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

188.1 Bazuar në konstatimet e mësipërme, rezulton se subjekti ka tentuar të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë këto pasuri, duke deklaruar të dhëna të pasakta ose duke mos i deklaruar fare, me qëllim që procesi i kontrollit dhe verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të subjektit të rivlerësimit. Për sa më sipër, Komisioni krijon bindjen se këto pasuri janë në pronësi/posedim të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

Qëndrimi i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

189. Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues konkludon se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë të pasurive dhe burimeve të ligjshme të tyre në deklaratën e pasurisë *Vetting*, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
- iii. Subjekti ka kryer deklaram të rremë në lidhje me çmimin e pasurisë të blerë në Gjinar Elbasan sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016
- iv. Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij sipas parashikimeve të pikës 5 të Aneksit D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- v. Subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurive në pronësi/posedim/përdorim në kuptim të nenit D/5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016 .

190. Në këto rrethana, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat sipas pikës 3 të nenit 61 të këtij ligji përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

B. KONTROLLI I FIGURËS

191. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar fillimisht një raport me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, me konstatimin për përshtatshmërinë në

vazhdimin e detyrës. Në vijim, me shkresën nr. *** prot., datë 23.1.2023, AKSIK-ja ka dërguar raportin e përditësuar për subjektin e rivlerësimit, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. **, datë 30.1.2023. Sipas këtij raporti:

- a. Subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive_____.
- b. Disponohen të dhëna për veprimtari të paligjshme, shfaqur në formën e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm me qëllim lehtësimin e pozitës së të pandehurit.
- c. Institucionet verifikuese i kanë përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Policisë së Shtetit____ku____thuhet se ka dyshime për marrëdhënie korruptive në sistemin e drejtësisë_____.

192. AKSIK-ja vijon arsyetimin:

- i. Situata pasqyron korrupsion sistematik në vetë sistemin e drejtësisë, ku për rastin në fjalë disponohen informacione për përfshirjen në veprime korruptive të një prokurori...
- ii. Informacionet që disponohen... për implikim në veprimtari korruptive... të një prokurori në periudha të shkëputura kohe e në më shumë se një rast nëpërmjet premtimit apo kërkimit të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, të çfarëdolloj përfitimi të parregullt për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën sipas kërkesave të shkronjave b dhe c të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, e bën subjektin e rivlerësimit individ që mund të vihet nën presion nga strukturat kriminale.
- iii. Çdo dyshim i arsyeshëm për kryerjen ose moskryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin, në mospërbushje të rregullt të detyrës dhe kur këto veprime ose mosveprime sjellin përfitime materiale ose jomateriale të padrejta për atë vetë apo për persona të lidhur me të, duke dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit apo të personave të tjerë, vlerësojmë se cenohet pastërtia e figurës së subjektit dhe shkalla e besueshmërisë së tij.

192.1 Për rrjedhojë, në vlerësim të të dhënave që disponohen për subjektin e rivlerësimit, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për të, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Neritan Hoxha.

193. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur⁸⁵ çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Nisur nga informacioni i ardhur, trupi gjykues, bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, analizoi provat e administruara nga ana e autoriteteve verifikuese.

194. Në lidhje me të dhënat e administruara nga ana e organeve ligjzbatuese, ato janë trajtuar në pjesën e vlerësimit profesional, për rrjedhojë Komisioni e sheh të panevojshme për të analizuar pretendimet e subjektit në lidhje me këtë kriter, për sa kohë nuk i ka kaluar barrën e provës.

⁸⁵ Referojuni dokumentacionit të gjendur në dosjen sekrete.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

195. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLP-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

196. Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore të dorëzuara nga subjekti, si dhe pesë dosjeve penale të përzgjedhura me short, nuk janë konstatuar problematika.

197. Bazuar në ankesat e administruara nga Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 14.9.2020, subjektit i ka kaluar barra e provës vetëm për një praktikë, si vijon:

- **Praktika nr. *** prot., datë 6.6.2016**, ka të bëjë me kallëzimin penal të shtetasës E.K, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për dijeni Prokurorit të Përgjithshëm.

Kallëzuesja E.K ka shpjeguar se subjekti në hetimin e kallëzimit penal të paraqitur nga ana e saj ka favorizuar palën kundërshtare (ish-bashkëshortin). Kallëzimi është marrë në shqyrtim nga Sektori i Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës të Shqipërisë, për të cilin është vendosur arkivimi, pasi kallëzimi është depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, praktikë e cila trajtohet sipas ligjit.

Në lidhje me këtë ankesë, denoncuesja pretendon se subjekti ka marrë si të pandehur atë dhe nënën e saj sikur kanë dhunuar bashkëshortin e saj, i cili i kishte dhunuar të dyja. Ankuesja pretendon se ajo nuk është pyetur gjatë hetimit, si dhe pretendon se është kanosur për jetën nga nëna e bashkëshortit të saj.

Për sa më sipër, duket sikur subjekti ka marrë në mënyrë të padrejtë si të pandehur shtetasen E. D.K, si dhe nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore.

198. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi⁸⁶ se: *“Në përfundim të hetimit, këto shtetase janë marrë të pandehura të akuzuara për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a/1 e 25 i Kodit Penal dhe çështja është dërguar për gjykim në Gjykatë, gjykim i cili u zhvillua me procedurën e gjykimit të zakonshëm... Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr. **, datë 13.1.2017, ka deklaruar fajtorë të pandehurat O.K dhe E.D (K) për kryerjen e veprës penale “Dhuna në familje”, e kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 130/a/1 dhe 25 i Kodit Penal në dëm të dhëndrit/bashkëshortit të saj B.D, duke dënuar secilën prej tyre. Ky vendim nuk është ankimuar nga të pandehurat dhe ka marrë formë të prerë në datën 23.1.2017”.*

199. Pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, Komisioni vlerëson se ato janë bindëse, pasi gjykata ka marrë një vendim të formës së prerë që mbështet pretendimet e subjektit.

DENONCIME

⁸⁶ Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur 5 denoncime, nga të cilat Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit vetëm për denoncimin e kryer nga shtetasi Th.M.

200. Denoncuesi pretendon se me vendimin nr. **, datë 24.6.2020, Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur “Ndryshimin e vendimit nr. **, datë 15.1.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec”, duke vendosur “Pranimin e kërkesës, prishjen e vendimit datë 30.11.2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, viti 2019”, duke urdhëruar organin e akuzës të vijojë hetimin.

200.1 Ai shprehet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec i ka dërguar dosjen hetimore Prokurorisë, por kjo e fundit për një periudhë 11-mujore nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, duke shpërdoruar detyrën me qëllim përfitimet vetjake.

201. Komisioni ka administruar dosjen hetimore, nga ku ka rezultuar se hetimet për këtë procedim janë kryer nga një subjekt tjetër, ndërkohë që drejtues i prokurorisë ishte subjekti i rivlerësimit. Me ndryshimet e reja ligjore pas vitit 2017, prokurori është i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij, për rrjedhojë nuk mund të ngarkohet subjekti për vonesat në procedim penal.

201.1 Ndërkohë, subjekti duhet të japë shpjegime në lidhje me faktin se pse nuk u ka kthyer përgjigje kërkesave drejtuar në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë nga shtetasi Th.M.

201.2 Në lidhje me këtë fakt, subjekti ka argumentuar se për shkak të fenomenit të lëvizjeve të shpeshta të prokurorëve në këtë Prokurori është përballur me një numër të lartë të dosjeve në hetim e gjykim, sidomos të dosjeve të mbetura stok. Për shkak të situatës së krijuar në sistem për një periudhë kohe të konsiderueshme, ngarkesa e madhe dhe volumi i punës është përballuar nga drejtuesi i Prokurorisë së bashku me një prokuror, pra në tërësi puna është përballuar vetëm nga 2 prokurorë. Situata e përshkruar më sipër ka bërë që gjatë ushtrimit të detyrës për shkaqe objektive të jetë në pamundësi për t’i kthyer përgjigje shtetasit Th.M apo edhe ndonjë qytetari tjetër. Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se ato janë bindëse.

Hetimi i Komisionit

202. Komisioni ka kryer një hetim të pavarur në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit, duke u bazuar në informacione nga burime të hapura⁸⁷ dhe në të dhënat e administruara nga organet ligjzbatuese⁸⁸, nga ku ngriheshin dyshime për përfshirje të subjektit në veprimtari korruptive.

Nga hetimi ka rezultuar:

203. Kallëzimi nr. *,** regjistruar në datën 30.3.2012, vepra penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”.

Subjekti në datën 24.4.2012 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Në këtë vendim, subjekti, ndër të tjera, analizon si vijon: “Shtetasit A.Sh dhe Q.S ...deklarojnë se kanë rreth një javë që punojnë me shkëputje në objektin në ndërtim të shtetasit H.B”.

⁸⁷ https://***.al/2021/02/12/zvarriti-hetimet-dhe-nuk-u-ndeshkua-skandali-i-prokurorit-ne-filtrat-e-vettingut
https://***.denoncimi-aksidenti-ne-pune-prokurori-zvarrit-hetimet-jam-i-zene-me-vettingun

⁸⁸ Shihni dosjen sekrete të subjektit të rivlerësimit.

Për sa i përket këtij procedimi, konstatohet se subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor në lidhje me pajisjen e shtetasit H.B me leje ndërtimi nga organet kompetente për kryerjen e punimeve, ndaj dhe i janë kërkuar shpjegime.

204. Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti pretendoi⁸⁹ se materiali hetimor i referuar me shkresën nr. ** prot., datë 28.3.2012, të Komisarariatit të Policisë Gramsh, është referuar për këtë ngjarje dhe jo për vepra të tjera penale (shkresa nr. *** prot., datë 28.3.2012, e Komisarariatit të Policisë Gramsh). Kjo vendimmarrje e prokurorit është gjetur e drejtë dhe ligjore nga zv.drejtuuesi i Prokurorisë dhe, më pas, edhe nga drejtuuesi i Prokurorisë.

205. Pasi analizoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti, Komisioni vlerëson se ato nuk janë bindëse, pasi subjekti nuk mund të paraqesë si argument referimin e veprës penale. Organi i prokurorisë është një organ i pavarur dhe, për rrjedhojë, nuk mund të mbështetet në kryerjen e hetimeve në referimet e kryera nga organet e tjera, në rastin në fjalë komisarati i Policisë. Nga analizimi i dokumentacionit të referuar konstatohet se dëmtimi i personave është bërë gjatë kohës që po ndërtonin një objekt, për rrjedhojë subjekti duhet të kryente të gjitha veprimet hetimore për të verifikuar nëse në këtë objekt po ndërtohej me leje konform legjislacionit në fuqi apo kishim të bënim me një ndërtim pa leje, i cili klasifikohet si vepër penale.

205.1 Në përfundim, duket se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorin e parashikuar nga pika 2 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

206. Kallëzimi nr. ***, regjistruar në datën 9.10.2013, vepra penale “Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”.

Subjekti në datën 11.11.2013 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal pasi, pavarësisht faktit se dëmtimet e shtetasit A.K hyjnë në kategorinë e plagosjes së rëndë, ato nuk kanë ardhur si pasojë e shkeljes së rregullave në punë.

207. Nga verifikimi i fashikullit penal konstatohet se:

- a. Nuk është urdhëruar kryerja e aktit të ekspertimit teknik në funksion të sqarimit të rrethanave të ngjarjes dhe shkaqeve të ndodhjes së saj.
- b. Nuk është thirrur për të deklaruar i dëmtuari, z. A.K.
- c. Nuk janë administruar listëpagesat e shoqërisë nga organet tatimore për të verifikuar deklarin e punësimit të të dëmtuarit dhe punonjësve të tjerë të pyetur në këtë procedim.
- d. Subjekti nuk rezulton të ketë hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë me të gjitha lejet/licencat/autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit.

207.1 Për arsyet e paraqitura më sipër, akti i vendimit të mosfillimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura. Konkluzionet e tij mbështeten në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje. Në lidhje me këtë dosje, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektivit të rivlerësimit, pasi duket se nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të cilësuar më lart (pikat a-d). Në rrethanat kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe,

⁸⁹ Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

207.2 Për rrjedhojë, vendimi i mosfillimit është i paargumentuar dhe jobindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështeten në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje.

208. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi⁹⁰ se: *“Prokurori ka arritur në konkluzion mbi bazën e dëshmitarëve okularë në vendin e ngjarjes, të cilët kanë parë e shpjeguar edhe dinamikën e kësaj ngjarjeje. Në këto rrethana, prokurori ka vlerësuar se nuk ka qenë e nevojshme kryerja e aktit të ekspertimit teknik për sa kohë ishin të sqaruara rrethanat e ngjarjes dhe shkaqeve të ndodhjes së saj... konkluzioni i prokurorit nuk është mbështetur në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje, por në aktet e dosjes... Për sa i përket mosmarrjes së deklaramit të të dëmtuarit A.K, siç edhe është pasqyruar në vendimin e prokurorit, vetë i dëmtuari nuk mund të jepte shpjegime për shkak të gjendjes shëndetësore në të cilën ndodhej dhe është dërguar në Spitalin Ushtarak, Tiranë, për ndihmë më të specializuar, ku edhe ka qenë deri në datën e bërjes së aktit mjekoligjor (18.10.2013). I dëmtuari nuk e ka kundërshtuar këtë vendimmarrje të prokurorit, konfirmuar me shkresën nr. *** prot., datë 5.7.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe vendimi është gjetur i drejtë e i bazuar nga drejtuesi i Prokurorisë. Për sa i përket faktit se subjekti nuk rezulton të ketë hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë me të gjitha lejet/licencat/autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit, kryerja e këtyre veprimeve verifikuese nuk ka asnjë rëndësi thelbësore që të ndikojë në cilësinë e këtij hetimi apo të ndikojë në vendimmarrjen e prokurorit apo aq më tepër në cilësimin juridik të veprës penale”.*

209. Pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, Komisioni vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nga analizimi i fashikullit penal konstatohet se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme. Ai nuk ka urdhëruar akt ekspertimi teknik në funksion të sqarimit të rrethanave të ngjarjes dhe shkaqeve të ndodhjes së saj, me qëllimin për të përcaktuar nëse pasojat kishin ardhur nga shkelja e rregullave në punë. I dëmtuari nuk është thirrur nga subjekti për të për të deklaruar e sqaruar rrethanat e ndodhjes së dëmtimit të tij. Subjekti nuk ka administruar asnjë dokument nga organet tatimore për të provuar punësimin e të dëmtuarit, si dhe të punonjësve të tjerë, por është bazuar vetëm në deklaramet e dëshmitarëve. Subjekti nuk ka administruar as dokumentacionin e shoqërisë për të vërtetuar faktin nëse kjo e fundit po i kryente punimet konform legjislacionit në fuqi dhe rregullave të caktuara në lejet e lëshuara për ushtrimin e aktivitetit të saj.

210. Komisioni çmon se në lidhje me këtë dosje penale, duke marrë në konsideratë faktin se kishim të bënim me një të plagosur rëndë, subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi, njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohet se: (i) subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të cilësuar më lart, në këto rrethana, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe, pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes; (ii) vendimi i pushimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështeten në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje,

⁹⁰ Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

211. Procedimi penal nr. **/2008

Në datën 15.1.2008 është regjistruar procedimi penal për veprën penale “Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë”.

Në datën 5.11.2008, subjekti së bashku me një prokuror tjetër kanë vendosur pushimin e procedimit penal.

212. Nga analizimi i fashikullit penal rezulton se:

- a. Nuk është administruar asnjë dokument për të vërtetuar faktin se viktimat dhe të dëmtuarit kishin marrë instruktimin e rregullave të mbrojtjes në punë.
- b. Nuk janë administruar listëpagesat e shoqërisë nga organet tatimore për të verifikuar deklarimin e punësimit të viktimave, të të dëmtuarve dhe punonjësve të tjerë të pyetur në këtë procedim.
- c. Nuk është administruar asnjë dokument për të vërtetuar aftësinë profesionale të viktimave dhe të të dëmtuarve.
- d. Subjekti nuk rezulton të ketë hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë me të gjitha lejet/licencat/autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit.

Për sa më sipër, duket se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore.

213. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi⁹¹ se pjesë e fashikullit të këtij procedimi penal kanë qenë libri i instruktimit të punonjësve të uzinës së çelikut, i përbërë prej 31 fletësh, si dhe rregullorja e sigurimit teknik të fabrikës, prill 2004, dokumente të sekuestruara me procesverbalin e datës 14.1.2008 nga OPGJ-ja dhe të vleftësuar nga prokurorët me vendimin e datës 15.1.2008 (faqe 81-82 e dosjes). Ekspertët e caktuar nga organi i prokurorisë për kryerjen e riekspertimit teknik në analizën që bëjnë në lidhje me këtë ngjarje, u referohen edhe neneve të rregullores së sigurimit teknik dhe librit të instruktimit. Në përfundim të hetimit nga prokurorët, në përputhje me nenin 190 të Kodit të Procedurës Penale është disponuar për dokumentet e sekuestruara në hetim, duke urdhëruar kthimin e tyre shoqërisë “K.I” sh.a. Gjithashtu, nga aktet e dosjes rezulton se OPGJ-ja me procesverbalin e datës 14.1.2008 ka sekuestruar 60 kartonë kohëshënues të punëtorëve të turnit të dytë në datën 14.1.2008 (dita e ngjarjes), që kanë qenë duke punuar në vendin e ngjarjes (faqe 83-84 e fashikullit). Sekuestrimi i këtyre dokumenteve është vleftësuar nga prokurorët e çështjes me vendimin e datës 15.1.2008 (faqe 85-86 e fashikullit). Në fashikull është administruar edhe lista emërore e punëtorëve të uzinës së çelikut, që kanë qenë në punë turni i dytë, datë 14.1.2008, nënshkruar nga drejtori i uzinës dhe vulosur (faqe 87-88 e fashikullit), në të cilën është përcaktuar edhe pozicioni i punës për secilin prej tyre.

213.1 Për sa më sipër, nuk ka qenë i nevojshëm administrimi i listëpagesave të shoqërisë nga organet tatimore për të verifikuar deklarimin e punësimit të viktimave, të të dëmtuarve dhe punonjësve të tjerë të pyetur. Duke shtuar këtu edhe faktin që shoqëria i është nënshtruar edhe

⁹¹ Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

kontrollit nga Inspektorati Shtetëror i Punës, Drejtoria Rajonale Elbasan, me të cilën organi i prokurorisë ka administruar në dosje edhe korrespondencën me këtë të fundit.

213.2 Për sa i përket konstatimit të Komisionit se prokurori subjekt rivlerësimi nuk ka hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë me të gjitha lejet/licencat/autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit, kryerja e këtyre veprimeve verifikuese nuk ka asnjë rëndësi thelbësore që të ndikojë në cilësinë e këtij hetimi apo vendimmarrjen e prokurorit, apo aq më tepër në cilësimin juridik të veprës penale, duke marrë në konsideratë edhe konkluzionet e ekspertëve në dy aktet e ekspertimit të përgatitura prej tyre.

214. Pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, Komisioni vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nga analizimi i fashikullit penal konstatohen se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme.

214.1 Pavarësisht shpjegimeve të subjektit, në fashikullin penal nuk gjendet e administruar asnjë provë për të vërtetuar që viktimat dhe të dëmtuarit kishin marrë instruktimin e rregullave të mbrojtjes në punë, si dhe kishin aftësitë e duhura profesionale. Subjekti nuk ka administruar dokumentacion nga organet tatimore për të vërtetuar punësimin e ligjshëm të viktimave dhe të të dëmtuarit. Subjekti nuk ka administruar as dokumentacionin e shoqërisë për të vërtetuar faktin nëse kjo e fundit po i kryente punimet konform legjislacionit në fuqi dhe rregullave të caktuara në lejet e lëshuara për ushtrimin e aktivitetit të saj.

214.2 Komisioni çmon se në lidhje me këtë dosje penale, duke marrë në konsideratë faktin se kishim të bënim edhe me viktima, subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi dhe gjykim të dobët, pasi evidentohet se ai nuk i ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të cilësuar më lart, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

215. Procedimi penal nr. */2009**

Në datën 18.11.2009 është regjistruar procedimi penal për veprën penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”. Në datën 25.3.2010, subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal, pasi dëmtimet hyjnë në kategorinë e plagosjes së lehtë në kuptim të Kodit Penal. Në vendim, subjekti shprehet se: *“Në momentin që ka vënë në lëvizje kovën, ajo ka prekur një gur dhe, për pasojë, kavoja e tërheqjes së kovës është kthyer mbrapsht duke e ngritur sërish kovën. Për rrjedhim, shtetasi E.Ç ka rënë brenda kovës... Në këtë moment, V.S, në përpjekje për të ndaluar funksionimin e kovës, nga shpejtësia ka shtypur gabimisht një buton, i cili ka vënë në funksion kovën...”*.

Ky përshkrim i subjektit nuk përputhet me deklarin e shtetasit V.S, i cili ka deklaruar tekstualisht: *“Unë doja të ndaloja lëvizjen e kokës së përzierësit, që të mos prekte ata e të godiste dhe nga shpejtësia kam shtypur butonin e gabuar, pra shtypa butonin që e vë në lëvizje përzierësin. Në këtë kohë, E i rrëshqiti këmba dhe ra brenda në përzierës, përzierësi bëri një rrotullim të vetëm dhe unë menjëherë e shtypa butonin për të stakuar makinerinë”*.

Pra, dinamika e ngjarjes e përshkruar nga subjekti nuk përputhet me deklarinet e dëshmitarëve, nga ku ka rezultuar se shtetasi E.Ç ka rënë në përzierës si pasojë e ndezjes së makinerisë dhe jo për shkak se kova është kthyer mbrapsht.

Në lidhje me këtë procedim janë pyetur disa punonjës të shoqërisë ku ka ndodhur aksidenti, më konkretisht shtetasit V.S, F.B, E.K dhe S.S.

216. Nga verifikimi i fashikullit penal konstatohet se:

- a. Nuk është urdhëruar kryerja e aktit të ekspertimit teknik në funksion të sqarimit të rrethanave të ngjarjes dhe shkaqeve të ndodhjes së saj.
- b. Në aktndëshminë ligjore mjekësore, datë 17.3.2010, përcaktohet se në datën 16.11.2009 është shtruar pacienti E.Ç në gjendje jo të mirë. Pasi tregohet gjendja e pacientit, vijohet duke deklaruar se po në këtë ditë është nisur për në spitalin e Ohrit.

Subjekti nuk rezulton të ketë vijuar hetimet në lidhje me gjendjen shëndetësore të të dëmtuarit, për të përcaktuar përfundimisht nëse jemi përpara plagosjes së rëndë ose jo, në mënyrë të tillë që të vendosej pushimi i procedimit.

- c. Nuk është thirrur për të deklaruar i dëmtuari, z. E.Ç.
- d. Në dokumentin lista emërore e punëtorëve, në periudhën qershor – gusht rezulton shtetasi F.B, i cili ka deklaruar se nuk është punonjës i shoqërisë, por kishte shkuar të takonte disa shokë.
- e. Në dokumentin lista emërore e punëtorëve, në periudhën shtator – nëntor 2009 rezulton se emri i shtetasit E.Ç është shtuar me dorë dhe ka një firmë në nëntor 2009.

Subjekti nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për të verifikuar së pari nëse ky emër është shtuar pas aksidentit, si dhe së dyti nëse firma është e këtij shtetasi.

- f. Nuk është administruar asnjë dokument për të vërtetuar faktin se i dëmtuari kishte marrë instruktimin e rregullave të mbrojtjes në punë.
- g. Nuk janë administruar listëpagesat e shoqërisë nga organet tatimore, për të verifikuar deklarimin e punësimit të dëmtuar dhe punonjësve të tjerë të pyetur në këtë procedim.
- h. Nuk është administruar asnjë dokument për të vërtetuar aftësinë profesionale të shtetasit V.S, si dhe marrjen nga ana e tij të instruktimit të rregullave të mbrojtjes në punë.
- i. Subjekti nuk rezulton të ketë hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë me të gjitha lejet/licencat/autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit.

Për arsyet e paraqitura më sipër, akti i vendimit të pushimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jo bindës në konkluzionet e arritura. Konkluzionet e tij mbështeten në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje.

217. Në lidhje me këtë dosje, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, pasi nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të cilësuar më lart (pikat a-i). Në këto rrethana, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe, pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Për rrjedhojë, vendimi i pushimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështetet në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjen pasqyrim në dosje.

218. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi⁹² se: “Për ndjekjen e këtij procedimi penal është caktuar fillimisht prokurori M.T, i cili me vendimin e datës 30.12.2009 ka vendosur pushimin e këtij procedimi penal, duke bërë përshkrimin e ngjarjes, si dhe duke argumentuar se nuk ka elemente të kryerjes së kësaj vepre penale nga shtetasi/punëtori V.S. Në lidhje me këtë vendimmarrje ka qenë dakord edhe zv.drejtuasi i Prokurorisë, por drejtuesi i Prokurorisë së asaj periudhe me vendimin e datës 15.1.2009 ka shfuqizuar vendimin e datës 30.12.2009 të prokurorit të çështjes për pushimin e këtij procedimi penal, duke ngarkuar prokurorin Neritan Hoxha (subjekt rivlerësimi) për kryerjen e veprimeve hetimore të përcaktuara nga drejtuesi, siç ishte kryerja e një akti ekspertimi mjekoligjor.

Prokurori Neritan Hoxha, subjekt rivlerësimi, në zbatim të detyrës së lënë nga drejtuesi i Prokurorisë, ka marrë vendimin e datës 1.3.2010 për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor, duke caktuar dhe ekspertin mjekoligjor. Sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor nr. **, datë 17.3.2010, ka rezultuar se tek i dëmtuari E.Ç është konstatuar frakturë e hapur e këmbës së djathtë dhe krahut të djathtë, dëmtime të cilat janë shkaktuar me mjet të mprehtë. Këto dëmtime hyjnë në kategorinë e atyre që kanë shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë, pra hyjnë në kategorinë e plagosjes së lehtë në kuptim të Kodit Penal. Pra, prokurori Neritan Hoxha ka kryer të vetmin veprim procedural të urdhëruar nga drejtuesi i Prokurorisë, kryerjen e aktit mjekoligjor... Në lidhje me konstatimin e Komisionit për dëmtimet e shtetasit E.Ç, dëshiroj të sqaroj se këto dëmtime kanë qenë fraktura (thyerje kocke) dhe ndaj i dëmtuari është dërguar në Ohër (Maqedoni), se atje ndodhet një spital i specializuar për këto dëmtime, por këto dëmtime, siç ka konkluduar dhe eksperti mjekoligjor, nuk kanë qenë të rrezikshme për jetën në momentin e shkaktimit të tyre (siç përcakton neni 88 i Kodit Penal).

Për sa i përket konstatimit se emri i të dëmtuarit është i shkruar me shkrim dore, referuar akteve të administruara në dosje, i dëmtuari nuk është i vetmi që ka emrin të shënuar me shkrim dore dhe emri i tij gjendet në listën e personave të instruktuar... Në dosjen hetimore rezulton se nga faqja 27 deri në faqen 54 janë administruar dokumentacioni i shoqërisë “B.N” sh.p.k., rregullorja e sigurimit teknik, si dhe lista emërore e punonjësve për periudha të ndryshme. Fakti nëse i dëmtuari kishte marrë instruktimin e rregullave të mbrojtjes në punë (ndonëse pohohet nga drejtuesi teknik i shoqërisë) do të ishte verifikuar (thelluar hetimi) nga organi i akuzës nëse do plotësohej elementi i anës objektive të kësaj vepre penale, plagosja/dëmtimi i rëndë i shtetasit E.Ç. Procedimi penal është pushuar pikërisht për këtë arsye, mungesa e elementeve të veprës penale. Për sa i përket faktit se subjekti nuk rezulton të ketë hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë me të gjitha lejet/licencat/autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit, kryerja e këtyre veprimeve verifikuese nuk ka asnjë rëndësi thelbësore që të ndikojë në cilësinë e këtij hetimi apo të ndikojë në vendimmarrjen e prokurorit, apo aq më tepër në cilësimin juridik të veprës penale”.

219. Pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, Komisioni vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nga analizimi i fashikullit penal konstatohet se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme. Ai nuk ka urdhëruar akt ekspertimi teknik në funksion të sqarimit të rrethanave të ngjarjes dhe shkaqeve të ndodhjes së saj, me qëllimin për të përcaktuar nëse pasojat kishin ardhur nga shkelja e rregullave në punë. Subjekti nuk e ka thirrur të dëmtuarin për të deklaruar e sqaruar rrethanat e dëmtimit të tij. Subjekti nuk ka vijuar hetimin

⁹² Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

për të verifikuar gjendjen shëndetësore të të dëmtuarit, për të përcaktuar përfundimisht nëse jemi përpara plagosjes së rëndë ose jo, në mënyrë të tillë që të vendosej pushimi i procedimit. Subjekti nuk ka administruar asnjë dokument nga organet tatimore për të provuar punësimin e të dëmtuarit, si dhe të punonjësve të tjerë, por është bërë bazuar vetëm në deklaratimet e dëshmitarëve. Subjekti nuk ka administruar as dokumentacionin e shoqërisë për të vërtetuar faktin nëse kjo e fundit po i kryente punimet konform legjislacionit në fuqi dhe rregullave të caktuara në lejet e lëshuara për ushtrimin e aktivitetit të saj.

220. Komisioni çmon se në lidhje me këtë dosje penale subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi, njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohet se: (i) subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të cilësuar më lart (pikat a-i). Në rrethanat kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht shkaqet e aksidentit, subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe, pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes; (ii) vendimi i pushimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështetet në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

221. Procedimi penal nr. */2005**

Në datën 20.12.2005 është regjistruar procedimi penal për veprën penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”.

Në datën 17.3.2006, subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal. Në këtë vendim, subjekti shprehet: *“Në datën 16.12.2005, në këtë objekt po hidhej beton me pompë me një mjet të firmës “E-B”, të drejtuar nga shtetasi G.K. Për të bërë punimet në objektin që po ndërtonte investitori J.T kishte punësuar shtetasit A.K, A.H, B.R, I.S,M.Ll si punëtorë ndërtimi e J.Xh si elektrikist, të cilit drejtoheshin nga shtetasi A.S... Të pyetur në cilësinë e personit që kanë dijeni për rrethanat e hetimit shtetasit G.K dhe V.C deklarojnë se janë të punësuar në firmën “E-B” dhe në datën 16.12.2005 kanë qenë duke hedhur beton... Gjatë hedhjes së betonit në soletën e katit të dytë një pjesë e armaturës është shembur duke zënë poshtë dy punëtorë... Shtetasit A.K dhe A.S deklarojnë se ata punojnë në ndërtim si ustallarë privat... Gjatë kohës që po hidhej beton soleta e katit të dytë është rrëzuar dhe janë dëmtuar disa punëtorë të cilët ishin duke punuar mbi dhe nën soletë... më pas kanë marrë vesh që elektrikisti J.Xh kishte vdekur...*

Për sa i përket rastit konkret, objekti në fshatin M me investitor shtetasin J.T, nga hetimi rezulton se ky objekt ndërtohet pa leje ndërtimi dhe projekt zbatimit. Gjithashtu në këtë objekt nuk ka të emëruar një mbikëqyrës të punimeve i cili të bëjë kontrollin për zbatimin e punimeve në këtë objekt në përputhje me kushtet teknike dhe rregullat e sigurimit teknik apo të kontrollojë materialet që u përdorën në ndërtimin e këtij objekti duke marrë masat për mënjanimin e pasojave të ardhura për sa më sipër rezultojnë se mungojnë elementet e nevojshme që fakti të parashikohet nga ligji si vepër penale”.

222. Në lidhje me këtë argumentim të subjektit konstatohet se:

- a. Objekti po ndërtohej pa leje ndërtimi dhe pa projekt zbatimi.
- b. Një prej të dëmtuarve ka ndërruar jetë duke pasur dhe një viktimë.
- c. Nga ana e investitorit nuk është marrë asnjë masë sipas parashikimeve ligjore në lidhje me ndërtimin, detyrim ligjor i cili i përkiste këtij të fundit.

- d. Nga deklaratimet e investitorit, por edhe dëshmitarëve, është konstatuar se investitori ka caktuar një drejtues punimesh.
- e. Ndërkohë që po hidhej beton, punëtorët ishin duke punuar.
- f. Për hedhjen e betonit ishte angazhuar një shoqëri juridike.

222.1 Për sa më sipër, rezultojnë elemente të nevojshme për të pasur vepër penale, elemente të cilat nuk janë analizuar nga subjekti.

222.2 Nga fashikulli penal konstatohet se:

- Shtetasi G.K ka deklaruar: *“Ne punojmë në firmën “E-B”...sot në datën 16.12.2005 kemi ardhur për të hedhur beton”*.
- Shtetasi V.C deklaron se punon tek firma “E-B”: *“Në datën 16.12.2005 së bashku me shtetasin G.K shkuam në fshatin M sipas udhëzimeve të firmës sonë ku... do të hidhnim beton në ndërtesën, pronarin e së cilës unë nuk e njoh...”*.
- Në aktin e ekspertimit teknik, një ndër shkaqet e shembjes së soletës ka qenë edhe përqendrimi i zbrazjes së betonit nga pompa, duke rritur ngarkesën në puntela të veçanta.

222.3 Nga ana e subjektit:

- a. Nuk është administruar asnjë dokument për të vërtetuar aftësinë profesionale të personave që kanë hedhur betonin, si dhe marrjen nga ana e tyre të instruktimit të rregullave të mbrojtjes në punë.
- b. Subjekti nuk rezulton të ketë hetuar në lidhje me pajisjen e shoqërisë së betonit me të gjitha lejet/licencat/autorizimet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit.
- c. Subjekti nuk rezulton të ketë urdhëruar akt ekspertimi në lidhje me gjendjen teknike të automjetit (betonieres).
- d. Nuk janë administruar listëpagesat e shoqërisë së betonit nga organet tatimore për të verifikuar deklaratimin e punësimit të punonjësve që po hidhnin beton.
- e. Nuk është pyetur i dëmtuari tjetër, shtetasi B.R.

223. Për arsyet e paraqitura më sipër, akti është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura. Konkluzionet e tij mbështeten në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje. Konkluzioni i subjektit në aspektin arsyetues mbështetet në analizimin dhe argumentimin e përgjithshëm të pasqyruar në një paragraf.

223.1 Për sa më sipër duket se subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të cilësuar më lart (pikat a-e), si dhe konstatohen rrethana të cilat duhej të ishin analizuar nga subjekti për të vendosur për mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

223.2 Për rrjedhojë, vendimi i pushimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështetet në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje.

224. Subjekti pas kalimit të barrës së provës⁹³ pretendoi se: “...Vepra penale e “Shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal, kërkon së pari ardhjen e disa pasojave të parashikuara në këtë dispozitë, të cilat janë: a) vdekja e një personi; b) plagosja e rëndë e një personi, pasoja të cilat të kenë ardhur nga mosrespektimi i rregullave në punë të përcaktuara në ligj, në aktet e Këshillit të Ministrave apo në rregulloret e sigurimit teknik, disiplinës apo mbrojtjes në punë. Si subjekt i kësaj vepre penale është personi i ngarkuar me respektimin e rregullave dhe marrjen e masave në zbatim të tyre, pra është subjekt i përcaktuar nga ligji që të ketë këtë cilësi. Pra, meqenëse kjo dispozitë kërkon mosrespektim të rregullave të përcaktuara në ligj, aktet e Këshillit të Ministrave apo rregulloret përkatëse dhe shkelja të jetë bërë nga personat e ngarkuar me respektimin e tyre, organi i akuzës i referohet legjislacionit në fushën e ndërtimit ...Për sa i përket rastit konkret, objekti në fshatin M, me investitor shtetasin J.T, nga hetimi rezulton se ky objekt ndërtohet pa leje ndërtimi dhe projekt zbatimi. Gjithashtu, për këtë objekt nuk ka të emëruar një mbikëqyrës të punimeve, i cili të bëjë kontrollin për zbatimin e punimeve në këtë objekt, në përputhje me kushtet teknike dhe rregullat e sigurimit teknik apo të kontrollojë materialet që përdorën në ndërtimin e këtij objekti, duke marrë masat për mënjanimin e pasojave të ardhura. Për sa me sipër, duke ndjekur analizën e faktit të ndodhur në datën 16.12.2005, rezulton që mungojnë elementet e nevojshme që fakti të parashikohet nga ligji si vepër penale dhe, rrjedhimisht, plotësohen kushtet për pushimin e procedimit penal... Shtetasi J.T kishte punësuar disa shtetas, ndër ta edhe viktimën J. Xh (elektricitist) dhe ky grup pune (brigadë ndërtimi njihet në zhargon) drejtohej nga shtetasi A.S (sipas deklarimeve), por kjo nuk nënkupton se në referim të ligjit ai është mbikëqyrës apo zbatues punimesh. Dispozitat ligjore dhe ato nënligjore (në fuqi në kohën e ngjarjes) përcaktojnë qartë se kush i cakton/emëron këto subjekte, mënyrën e kontrollit për caktimin e tyre... Konstatimet e Komisionit qëndrojnë, por nuk janë kryer këto veprime, pasi sipas kuadrit ligjor/nënligjor përgjegjës në kantierin/objektin e ndërtimit është mbikëqyrësi i punimeve, i cili në rastin konkret nuk ishte i emëruar/caktuar”.

225. Pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, Komisioni vlerëson se ato nuk janë bindëse. Subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me moskryerjen e të gjitha veprimeve hetimore, por është përqendruar vetëm në faktin se nuk kishim vepër penale të shkeljes së rregullave në punë, ndërkohë që nga analizimi i fashikullit penal mund të kishim kryerjen e më shumë se një vepre penale. Më konkretisht, rezulton se në vendngjarje kishim një viktimë, pra, në këtë rast, pavarësisht se nuk kishim të bënim me veprën penale të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal, vdekja e viktimës provohet se ka ardhur si pasojë e gabimeve njerëzore, për rrjedhojë mund të klasifikohej në një nga veprat e tjera penale. Gjithashtu, rezulton e provuar që objekti po ndërtohej pa leje, si dhe për hedhjen e betonit ishte angazhuar një shoqëri juridike. Subjekti nuk ka kryer asnjë hetim në lidhje me këto konstatime, për të verifikuar nëse shoqëria vepronte sipas legjislacionit në fuqi dhe nëse pajisjet e saj plotësonin kushtet teknike. Pavarësisht faktit se nuk kishte një mbikëqyrës punimesh sipas legjislacionit të kohës, rezulton se për hedhjen e betonit ishte angazhuar një shoqëri tregtare, e cila detyrimisht ka një mbikëqyrës punimesh. Subjekti nuk ka thirrur të dëmtuarin për të deklaruar e sqaruar rrethanat e ndodhjes së dëmtimit të tij. Subjekti nuk ka administruar asnjë dokument nga organet tatimore për të provuar punësimin e të dëmtuarit, si dhe të punonjësve të tjerë, por është bazuar vetëm në deklaratimet e dëshmitarëve. Subjekti nuk ka administruar as dokumentacionin e

⁹³ Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

shoqërisë për të vërtetuar faktin nëse kjo e fundit po i kryente punimet konform legjislacionit në fuqi dhe rregullave të caktuara në lejet e lëshuara për ushtrimin e aktivitetit të saj.

226. Komisioni çmon se në lidhje me këtë dosje penale, duke marrë në konsideratë faktin se kishim të bënim me një të vdekur, subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi, njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohet se: (i) subjekti nuk i ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të cilësuar më lart; në këto rrethana, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht, subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe, pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes; (ii) vendimi i pushimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështetet në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

227. Subjekti në datën 1.5.2020 ka paraqitur kërkesë për vleftësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit për shtetasit G.K dhe I.S, kërkesë e cila është shqyrtuar nga gjykata në po të njëjtën ditë.

227.1 Në këtë kërkesë rezulton se shtetasi G.K dyshohet se ka konsumuar elemente të veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i imunicionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe shtetasi I.S dyshohet se ka konsumuar veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal (përfaqësuar nga av. I.P).

228. Nga analizimi i fashikullit penal rezulton se në datën 29.4.2020 subjekti ka vendosur lejimin e përgjimit ambiental të të dyshuarve I.S dhe G.K.

228.1 Nga transkriptimi i përgjimit ambiental datë 29.4.2020 konstatohet se:

- Gjatë gjithë bisedës, shtetasi G.K i thotë shtetasit I.S që të deklarojë se ka qëlluar vetëm ai (shtetasi G.K), ndërkohë në një moment I.S thotë: “*I gjujta nja dy...*” (ky deklaram rezulton me bold në faqet e transkriptimit).

228.2 Pas këtij deklarimi, shtetasi G.K vijon të thotë se nuk e ka prekur armën me dorë.

- Në vijim, shtetasi I.S thotë: “*...po ku i gjujtëm ne thash o bab, ne kemi gjujt me ajër*” (kjo shprehje është me bold në faqen e transkriptimit).
- Shtetasi G.K në vijim të bisedave thotë: “*O vëlla po kemi shti bashkë sa her o burr, kemi shti anej sa herë, për lepra sa herë*” (kjo shprehje është me bold në faqen e transkriptimit).
- Shtetasi G.K më shumë se një herë i thotë shtetasit I.S “*Nesër do dalësh*”.

229. Nga analizimi i kërkesës për caktimin e masës së sigurimit, konstatohet se subjekti nuk ka analizuar kushtet dhe kriteret parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 për caktimin e masës së sigurimit personal, si dhe nuk janë analizuar dhe marrë në konsideratë të dhënat nga përgjimi ambiental. Subjekti me një paragraf të vetëm (i përsëritur për të dy shtetasit), pa analizuar rrethanat konkrete të secilit për të dyshuarve, por në mënyrë të përgjithshme ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” për shtetasin G.K dhe për shtetasin I.S ka kërkuar “Arrest në shtëpi”. Subjekti nuk rezulton të ketë analizuar se cilat kanë qenë arsyet që shtetasit I.S duhej t’i caktohej masa e sigurimit personal “Arrest në shtëpi”.

229.1 Për sa më sipër, duket se subjekti nuk ka argumentuar vendimin e masës së sigurimit penal, si dhe ka favorizuar shtetasin I.S në caktimin e masës së sigurimit, duke iu kaluar barra e provës.

229.2 Subjekti vetëm 3 ditë pas caktimit të masës së sigurimit personal ka kërkuar zëvendësimin e tij, duke deklaruar se bazuar në urdhrin nr. **, datë 31.1.2020, ka një seksion të posaçëm për hetimin e gjykimin e veprës penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal.

229.3 Është e paqartë kjo kërkesë e subjektit pas caktimit të masës së sigurimit personal ndërkohë që urdhri ku ai bazohet në kërkesë ka qenë në fuqi edhe në momentin që ai ka paraqitur kërkesën për caktimin e masës së sigurimit personal.

229.4 Subjekti duhet të japë shpjegime në lidhje me paraqitjen e kërkesës për zëvendësim pas caktimit të masës së sigurimit dhe jo që në momentin e parë që i është caktuar ky procedim penal.

230. Subjekti pas kalimit të barrës së provës⁹⁴ pretendoi se: *“...Në lidhje me masën e sigurimit për të arrestuarin G.K, i është kërkuar Gjykatës që duke marrë parasysh rëndësinë e faktit, sanksionin që parashikohet për këtë vepër penale (krim), rrezikshmërinë e personit (i dënues më parë), mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, si dhe rrethanat personale e familjare të tij, ndaj të arrestuarit G.K është kërkuar të caktohet si masë sigurimi ajo e arrestit në burg, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, pasi çdo masë tjetër është e papërshtatshme. Në lidhje me masën e sigurimit për të arrestuarin I.S, i është kërkuar Gjykatës që duke marrë parasysh rëndësinë e faktit, sanksionin që parashikohet për këtë vepër penale (krim, por parashikon dhe gjobë si dënim), rrezikshmërinë e personit (i padënues më parë), mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës (në një ambient larg qendrave të banuara), si dhe rrethanat personale e familjare të tij, ndaj të arrestuarit I.S është kërkuar të caktohet si masë sigurimi ajo e arrestit në shtëpi, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, duke urdhëruar që të qëndrojnë në banesën e tij, në qytetin e Peqinit.*

*Në kuadër të kryerjes së veprimeve të para hetimore nga unë prokurori SR, me vendimin e datës 29.4.2020, ora 00:50, është lejuar kryerja e përgjimit ambiantal të bisedave dhe komunikimeve midis shtetasve G.K dhe I.S, përgjim i cili do kryhej në ambientet e posaçme publike të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, duke filluar nga ora 01:00 e datës 29.4.2020 deri në orën 03:00 të datës 29.4.2020... Referuar akteve të dosjes penale, rezulton se me shkresën nr. *** prot., datë 20.5.2020 (kohë në të cilën dosja nuk ishte më në hetim nga SR), Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan ka dërguar në Prokurori materialin e transkriptuar të këtij përgjimi ambiantal së bashku me CD-në me përmbajtjen e bisedës së përgjuar (së cilës i referohet Komisioni). Këto akte janë administruar në Prokurori, në datën 21.5.2020, me numër protokolli hyrës ***. Në këto rrethana, duke mos qenë në dispozicion të prokurorit materiali i transkriptimit të përgjimit, nuk kishte se si të merrej në konsideratë përmbajtja e tij nga prokurori si në kërkesën për masën e sigurimit dhe as gjatë gjykimin të shqyrtimit të kësaj kërkesë... Në lidhje me konstatimet e Komisionit për paqartësinë e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit në këtë procedim, dua të sqaroj dhe sjell në vëmendje të Komisionit si më poshtë vijon:*

⁹⁴ Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

- Pas kryerjes së veprimeve të ngutshme, përfshirë masat e sigurimit dhe vleftësimet e kontrolleve të kryera dhe sekuestrove të bëra nga policia gjyqësore, i jam drejtuar drejtuesit të Prokurorisë me kërkesën e datës 4.5.2020 për zëvendësimin si prokuror në këtë procedim penal dhe caktimin e një prokurori të seksionit të posaçëm sipas urdhrit nr. *** prot., datë 31.1.2020 “Për organizimin e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan”, i ndryshuar, të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, duke shprehur dhe pëlqimin tim për këtë zëvendësim... Siç e përmenda më lart, fakti penal ka ndodhur në datën 28.4.2020 (periudha e kulmit të pandemisë Covid 19). Për shkak të situatës së krijuar, puna në Prokurorinë e Elbasanit për kryerjen e veprimeve hetimore/procedurale me karakter të ngutshëm është mbuluar nga drejtuesi i Prokurorisë, z. K.A dhe drejtuesit e seksioneve, prokurorët A.Sh, R.S dhe prokurori Neritan Hoxha. Kjo dhe në zbatim të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm dhe drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan në lidhje më masat për kufizimin e përhapjes së Covid 19. Bashkëngjitur vë në dispozicion të Komisionit disa praktika të kësaj periudhe, ku procedimet penale me persona të arrestuar shortheshin duke u caktuar prokurori që do të ndiqte hetimin, por veprimet e ngutshme, si urdhri për regjistrimin e procedimit penal, vleftësimet e kontrolleve dhe sekuestrove të bëra nga OPGJ-ja, kërkesat për arrestimet dhe përfaqësimi në Gjykatë e urdhrat e ekzekutimit për masat e sigurimit janë bërë nga prokurorët e lartpërmendur e, më tej, është vijuar me kërkesat e tyre drejtuar drejtuesit të Prokurorisë për zëvendësimin e prokurorit dhe kalimin e dosjes penale në seksionin përkatës dhe vijimin e hetimit nga prokurorët e kësaj Prokurorie... Kjo është arsyeja se përse SR vetëm 3 ditë pas caktimit të masës së sigurimit personal ka kërkuar zëvendësimin e tij bazuar në urdhrin nr. **, datë 31.1.2020 dhe procedimi të hetohet nga seksioni i posaçëm për hetimin e gjykimin e veprës penale, të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal”.

231. Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se ato janë bindëse në lidhje me kërkesën e heqjes dorë, duke kërkuar zëvendësimin e tij. Nga analizimi i kërkesës për caktimin e masës së sigurimit, konstatohet se subjekti nuk ka analizuar kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 për caktimin e masës së sigurimit personal, duke shfaqur mangësi në aspektin e arsyetimit ligjor, referuar pikës 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

232. Në datën 18.11.2018, subjekti ka urdhëruar regjistrimin penal në ngarkim të shtetasit A.P, i dyshuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe shtetasit K.Ll, i dyshuar për veprën penale të parashikuar nga neni 279/2 i Kodit Penal.

232.1 Në datën 19.11.2018, subjekti ka paraqitur kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit.

232.2 Nga analizimi i kërkesës për caktimin e masës së sigurimit, konstatohet se nga ana e subjektit nuk janë analizuar kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 për caktimin e masës së sigurimit personal, por ai në mënyrë formale, me një paragraf, pa analizuar rrethanat konkrete të secilit prej të dyshuarve, ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal, konkretisht:

- i. Për shtetasin K.Ll (të cilit i është gjetur në sirtarin e banakut të lokalit një mjet prerës, thikë me teh metalik dhe me dorezë me veshje plastike) ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”.

Në lidhje me këtë kërkesë, gjykata ka argumentuar se shtetasit K.Ll duhet t'i caktohet masa e sigurimit "Detyrim paraqitjeje", ku ndër të tjera argumenton: *"Marzhet e dënimit për veprën që dyshohet se ka kryer i arrestuari K.Ll, si dhe faktin që brenda të njëjtit procedim për njërin të arrestuar organi i procedimit kërkon caktimin e masës së sigurimit të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale me marzhe dënimi minimumi 5 vjet, ndërsa vepra që dyshohet i arrestuari K.Ll parashikon në minimumin 1 vit burgim"*.

- ii. Në lidhje me shtetasin A.P, i cili është arrestuar në flagrancë në kryerje e sipër të veprës penale dhe i kapur me lëndë narkotike kokainë, 0.8 gramë, subjekti ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit "Detyrim paraqitjeje", duke iu referuar vetëm sasisë së vogël të lëndës narkotike të kapur, por pa analizuar kushtet dhe kriteret për caktimin e kësaj mase.

Sikundër konstatohet, subjekti ka kërkuar "Arrest në burg" për një shtetas të cilit i është kapur një thikë në ambientet e punës, ndërkohë për shtetasin A.P, i cili është kapur me lëndë narkotike, si dhe kishte dyshime në kryerje e sipër të veprës penale, ka kërkuar një masë dukshëm më të lehtë, "Detyrim paraqitjeje". Ky konstatim i Komisionit përforcohet edhe nga argumentimi i gjykatës në vendimin e caktimit të masës së sigurimit, e cila shprehet: *"Në lidhje me llojin e masës së sigurimit personal që duhet të caktohet, gjykata vlerëson që ndaj të arrestuarit A.P të caktojë si masë sigurimi atë të kërkuar nga organi procedues... Këtu gjykata ka në vëmendje edhe nenin 244/3 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit: Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori"*.

Për sa më sipër, duket se subjekti nuk ka argumentuar vendimin e masës së sigurimit penal, si dhe ka favorizuar shtetasin A.P në caktimin e një mase sigurimi dukshëm më të lehtë.

233. Subjekti pas kalimit të barrës së provës⁹⁵ pretendoi se: *"...Nga hetimi i kryer deri në momentin e paraqitjes së kërkesës në Gjykatë për masën e sigurimit personal, ka rezultuar se ...shtetasit A.P i janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale 2 (dy) paketime ambalazh plastik me ngjyrë si të bardhë, të mbyllura me djegie, të mbushura me pluhur të bardhë, i cili ngjason me lëndën narkotike të llojit kokainë. Shtetasi A.P, në momentin që kanë ndërhyrë punonjësit e policisë, ishte i ulur në tavolinë me shtetasin G.Th, banor i qytetit të Elbasanit. Nga kontrolli i kryer në ambientet e këtij lokali, ndër të tjera, në sirtarin e banakut ku punon shtetasi K.Ll, është gjetur një mjet prerës, thikë me teh metalik, me mbishkrimin në njërën anë të saj "Stainless steel", me dorezë me veshje plastike, me ngjyrë të zezë e me këllëf, ku nga veprimet hetimore të kryera rezultonte se i përkiste këtij shtetasi... Është bërë peshimi i provës materiale e dyshuar për lëndë narkotike, sekuestruar shtetasit A.P, e cila ka një peshë të përgjithshme prej 0.8 (zero pikë tetë) gramë bashkë me ambalazhin... Arrestimi i këtij shtetasi është bërë në kushtet e flagrancës, në kryerje e sipër të veprës penale dhe i kapur me sende, prova materiale, duke plotësuar kështu kërkesat ligjore të parashikuara nga nenet 251 dhe 252 të Kodit të Procedurës Penale e, për këtë arsye, arrestimi i tij duhet të vleftësohet si i ligjshëm nga Gjykata.*

Në këto kushte, oficeri i policisë gjyqësore ka bërë arrestimin në flagrancë edhe të shtetasit K.Ll... Arrestimi i këtij shtetasi është bërë në kushtet e flagrancës, në kryerje e sipër të veprës penale dhe i kapur me sende, prova materiale, duke plotësuar kështu kërkesat ligjore të

⁹⁵ Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

parashikuara nga nenet 251 dhe 252 të Kodit të Procedurës Penale e, për këtë arsye, arrestimi i tij duhet të vleftësohet si i ligjshëm nga Gjykata.

Në lidhje me masën e sigurimit personal për të arrestuarin A.P nga prokurori SR, pasi janë analizuar rrethanat konkrete të veprës penale, rrezikshmëria e veprës dhe autorit (i padënuar), provat e mbledhura deri në atë fazë të hetimit (nuk ishin administruar ende aktet e ekspertimeve për lëndën), kriteret e përcaktuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale, përshtatshmëria e masës me nevojën e sigurimit, si dhe sanksioni i veprës penale (marrë në konsideratë sasinë e lëndës të dyshuar si kokainë dhe shpjegimit të arrestuarit që ka përdorur kokainë), është vlerësuar si masë më e përshtatshme ajo “Detyrim për t’u paraqitur para OPGJ-së”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, duke vlerësuar se kjo masë sigurimi ishte më e përshtatshme dhe u përgjigjej nevojave të sigurimit dhe rëndësisë së faktit... Bashkëngjitur parashtrimeve kam vënë në dispozicion të Komisionit edhe qëndrime të prokurorëve të Prokurorisë Elbasan në kërkesat e paraqitura në Gjykatë për masa sigurimi për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, si dhe vendimet përkatëse gjyqësore... Prokurori për të arrestuarin K.Ll i ka kërkuar Gjykatës që ndaj tij të caktohet si masë sigurimi “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. Në këtë kërkesë, prokurori ka arritur pasi ka marrë në konsideratë rëndësinë e faktit, sanksionin për veprën (mbajtja e armëve të ftohta në ambiente publike është rrethanë cilësuese e përcaktuar nga ligjvënësi), faktin që ishte administruar akti i ekspertimit teknik për thikën sekuestruar të arrestuarit K.Ll, i cili, siç parashtron edhe Gjykata në vendimin e saj, ka deklaruar se ishte thikë buke, por referuar cilësive të saj dhe pamjes fizike (e ka pasur në dispozicion edhe Gjykata aktin e ekspertimit së bashku me fotot e thikës), e cila dukshëm ishte tipike armë e ftohtë, e konfirmuar nga akti i ekspertimit dhe madje edhe me këllëf lëkure (për ta mbajtur me vete në lëvizje). Këto kanë qenë arsyet se përse prokurori ka kërkuar këtë masë sigurimi, duke vlerësuar se kjo masë sigurimi ishte më e përshtatshme dhe u përgjigjej nevojave të sigurimit.

Për sa i përket konstatimeve të tjera të Komisionit, në nenin 4 të Kodit të Procedurës Penale është sanksionuar parimi i prezumimit të pafajësisë dhe çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. Organi i prokurorisë ka marrë në analizë dhe i ka bazuar konkluzionet e tij vetëm në faktet e provuara në hetim”.

234. Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni konstaton se ato nuk janë bindëse. Subjekti në mënyrë të pashpjegueshme ka kërkuar masën e sigurimit “Arrest në burg” për një thikë dhe është kërkuar masë sigurimi “Detyrim paraqitjeje” për një person të kapur me dy qese lënde narkotike, i cili për më tepër nuk ka deklaruar asnjëherë se i ka pasur për përdorim personal. Depozitimi i subjektit të kërkesave të kolegëve të tjerë nuk mund të merren në analogji pasi rastet nuk janë asnjëherë të ngjashme, si dhe Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit për mungesë të argumentimit të vendimit. Subjekti në kërkesën për caktimin e masës së sigurimit personal nuk ka analizuar kushtet dhe kriteret parashikuar nga nenet 228, 229 dhe 230 për caktimin e masës së sigurimit personal, duke shfaqur mangësi në aspektin e arsytimit ligjor nga pika 3 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

235. Në lidhje me vijimin e procedimit, nga analizimi i fashikullit penal rezulton se:

- Në raportin e shërbimit të datës 16.11.2018 përshkruhet ngjarja e arrestimit të shtetasit A.P. Në këtë raport thuhet se kishte informacion se në lokalin “****” shpërndaheshin lëndë narkotike nga shtetasi A.P... Sapo forcat e policisë kanë hyrë, shtetasi A.P ka shkuar në banjë dhe ka mbyllur derën. Pas hapjes së derës së banjës është konstatuar se ai ishte i veshur dhe në krahun e majtë të tualetit në tokë janë gjendur dy qese me pluhur të dyshuar kokainë.
- Shtetasi A.R deklaron në datën 17.11.2018 se shtetasin A.P e ka marrë në punë në provë dhe punon si ndihmës gjatë turnit të tretë.
- Shtetasi A.P deklaron se A ka tri ditë që punon si banakier në një lokal.
- Shtetasi K.Ll në datën 17.11.2018 deklaron: “A.P e njoh si fytyrë, frekuenton lokalin ku unë punoj, por nuk kam më shumë njohje sesa si klient”.
- Shtetasi G.Th në datën 17.11.2018 deklaron se: “Unë u ula në një tavolinë në afërsi të banakut ku është kompjuteri i internetit. Në tavolinë ishte dhe një djalë, të cilin nuk e njoh me emër dhe e kam parë disa herë në lokal zakonisht pasdite dhe në orët e natës”.
- Në aktin e ekspertizës adiktologjike dhe toksikologjike për të dyshuarin A.P nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me faktin se ai plotëson kriteret e vartësisë substancore. Eksperti ka referuar vetëm faktin se nga ekspertimi toksikologjiko-ligjor rezultojnë gjurmë të metaboliteteve të lëndës drogë kokainë dhe nga pesha pa ambalazh sasia është 0.539 gramë. Më pas, eksperti ka cituar disa pasazhe teorike pa u referuar në rastin konkret. Në përfundim, ai ka deklaruar se sasia prej 0.539 gramësh lëndë droge kokainë me prekursor është dozë për përdorim vetjak, pa shkaktuar dëme serioze për jetën e përdoruesit të lëndës drogë kokainë.
- I dyshuar A.P në datën 17.11.2018 ka deklaruar se nuk ka lidhje me qeset e gjetura në banjë, si dhe pyetjes se a jeni përdorues i lëndëve narkotike, i është përgjigjur se ka konsumuar me shoqërinë cigare hashash, si dhe me raste ka provuar dhe lëndë narkotike të llojit kokainë, hera e fundit që e ka konsumuar ka qenë para 20 ditësh në qytetin e Elbasanit.

235.1 Subjekti në datën 14.6.2019 ka vendosur përfundimin e hetimeve, duke kërkuar pushimin e gjykimit dhe argumentuar se shtetasi A.P rezulton përdorues i lëndëve narkotike, kërkesë e cila me vendimin nr. ***, datë 16.9.2019, është pranuar nga Gjykata.

236. Bazuar në të dhënat e administruara më sipër, gjatë hetimit rezulton se subjekti nuk ka kryer veprime hetimore të plota konform kërkesave të vendimit unifikues nr. 1, datë 27.3.2008, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Nëse i referohemi aktit të ekspertimit adiktologjik dhe toksikologjik, ai nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në vendimin unifikues, pasi nuk i referohet individit konkret, shtetasit A.P, si dhe nuk ka asnjë përshkrim të cilësive fiziko-biologjike dhe shkallës së vartësisë të personit konkret. Në këto kushte, subjekti duhet të kërkonte një akt të ri ekspertimi në përmbushje të kërkesave të vendimit unifikues.

236.1 Subjekti nuk ka analizuar të gjitha elementet e tjera për sa i përket faktit që i dyshuari kishte shkuar në banjë në momentin që kanë ardhur forcat e policisë, duke u krijuar dyshime që ai mund të ketë pasur më shumë se dy doza, për sa kohë nuk kishte shkuar për nevoja personale. Gjithashtu, rezultojnë dëshmi kontradiktore në lidhje me punësimin e këtij shtetasi në lokal, pasi punonjësit e tij kanë deklaruar se ai ishte klient. Subjekti nuk ka kryer asnjë hetim në lidhje

me deklarimin e shtetasit A.P në organet tatimore si punonjës i lokalit “***”, si dhe nuk e ka ripyetur atë për të dhënë deklarime të plota, duke marrë në konsideratë faktin se ky shtetas ka deklaruar se nuk është përdorues i rregullt i lëndëve narkotike dhe ka mohuar faktin se lënda ishte e tij apo e kishte për përdorim personal.

236.2 Për sa më sipër, duket se vendimi i pushimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështeten në të dhëna të paverifikuara.

237. Subjekti pas kalimit të barrës së provës⁹⁶ pretendoi se: “...Në aktin e ekspertimit të datës 20.5.2019 të hartuar nga eksperti, mjeku toksikolog-adiktolog, eksperti shprehet: “Midis detajeve anamnestic-klinike mund të evidentojmë se shtetasi A.P i datëlindjes 25.11.1994, lindur dhe banues në Elbasan, i biri i A dhe F, ka një karrierë në abuzimin substancor” e më tej vijon “Kujdes!!! Shtetasi A.P në dokumentacionin shoqëruar evidentohet se në aktin e ekspertimit toksikologjiko-ligjor nr. ***, datë 30.11.2018, rezultojnë gjurmë të metaboliteve të lëndës drogë kokainë, pra është pozitiv dhe përdorues i lëndës drogë kokainë. Në aktin e ekspertimit kimik nr. ***, datë 18.1.2019, rezulton që sasia e lëndës drogë kokainë me prekursore me peshë pa ambalazh është 0.539 gramë. Për të gjitha këto individë në shqyrtim mendoj se plotëson kriteret diagnostike të vartësisë substancore sipas DSM-IV (vartësi psikologjike).

Pra, nuk qëndron pretendimi i Komisionit se akti i ekspertimit adiktologjik dhe toksikologjik nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në vendimin unifikues, pasi ai nuk i referohet individit konkret, shtetasit A.P, si dhe nuk ka asnjë përshkrim të cilësive fiziko-biologjike dhe shkallës së vartësisë të personit konkret... Nga hetimi rezultoi se nuk ka asnjë provë që të vërtetojë ose të paktën të ngrihen dyshime se personi nën hetim, A.P, sasinë prej 0.539 gramësh kokainë, që i është gjetur dhe sekuestruar, ta ketë mbajtur me qëllim për të kryer ne vijim ndonjërin apo disa nga veprimet e tjera që parashikon ana objektive e veprës penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, si shitje, ofrim për shitje, shpërndarje, tregtim, transportim, dorëzim, dërgim, dhënie marrje me çdo formë.

*Megjithatë personi nën hetim A.P ka mbajtur një sasi lënde narkotike që ishte për përdorim vetjak dhe në sasi të vogla dhe ishte përdorues i kësaj lënde narkotike, ligjvënës i ka përjashtuar nga përgjegjësia penale e, për këtë arsye, ky shtetas nuk mund të akuzohet e merrej i pandehur për veprën penale të parashikuar nga Kodi Penal. Për këto arsye, prokurori ka kërkuar në Gjykatë pushimin e çështjes, kërkesë e miratuar me vendimin nr. ***, datë 16.9.2019, të gjyqtarit të seancës paraprake”.*

Subjekti ka përmendur edhe praktika të tjera të tij në lidhje me caktimin e masës së sigurimit dhe pushimit të çështjes për raste të ngjashme.

238. Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se ato nuk janë bindëse. Në shpjegimet e tij, ai përmend një pasazh të aktit të ekspertimit, ku përmendet vetëm emri i shtetasit A.P dhe aktet e ekspertimit. Subjekti nuk dha asnjë argument se pse në aktin e ekspertimit nuk ka asnjë përshkrim të cilësive fiziko-biologjike dhe shkallës së vartësisë të personit konkret, sikundër kërkohet nga vendimi unifikues. Për sa i përket rasteve të ngjashme, Komisioni vlerëson se ato nuk përbëjnë provë për të justifikuar mungesën e argumentimit të vendimit të pushimit, si dhe të kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore. Sikundër rezulton,

⁹⁶ Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

shtetasi A.P nuk ka pranuar që lënda narkotike ka qenë për përdorim personal apo që ai është përdorues i rregullt i lëndës narkotike, duke e bërë vendimin e subjektit të cënueshëm.

238.1 Komisioni çmon se në lidhje me këtë dosje penale subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi, njohuri dhe gjykim të dobët, pasi evidentohet se: (i) Subjekti nuk ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore. Në këto rrethana, kur hetimet nuk ishin të plota dhe nuk ishin sqaruar plotësisht, subjekti duhej të vazhdonte hetimet dhe, pasi të kryheshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes; (ii) Vendimi i pushimit është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në konkluzionet e arritura, pasi mbështetet në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje, duke afektuar në këtë mënyrë indikatorët e parashikuar nga pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

238.2 Komisioni në lidhje me këtë dosje penale, bazuar edhe në informacionin⁹⁷ e administruar nga organet ligjzbatuese, vlerëson se veprimet e subjektit janë bërë me qëllim favorizimin e shtetasit A.P.

239. Nga burime të hapura ka rezultuar se subjekti ka regjistruar një procedim penal për shkeljen e rregullave të mbrojtjes në punë, pasi në Malin e Zavalinës ndërkohë që po punohej ka vdekur një shtetas.

239.1 Në lidhje me këtë procedim, duke u bazuar në të dhënat e artikullit, ku duket se viktima nuk ka qenë i regjistruar në organet tatimore, subjekti ka zvarritur hetimet për një periudhë gati 2-vjeçare dhe më pas është tërhequr nga hetimi, si dhe nga ana e tij nuk janë kryer të gjitha veprimet hetimore.

239.2 Për rrjedhojë, duket se subjekti ka zvarritur hetimet, si dhe nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore, duke i kaluar barrën e provës.

240. Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti pretendoi⁹⁸ se nga prokurori i çështjes, me vendimin e datës 24.10.2016 është marrë i pandehur A.K. Akuza i është njoftuar të pandehurit A.K, i cili, i pyetur në cilësinë e të pandehurit në datën 17.11.2016, nuk ka pranuar të japë shpjegime.

240.1 I pandehuri A.K ka depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan një kërkesë, me anë të së cilës ka kërkuar kryerjen e disa veprimeve hetimore për këtë procedim penal. Me vendimin e datës 19.12.2016 të prokurorit të çështjes është vendosur pranimi i pjesshëm i kërkesave të të pandehurit A.K, parashtruar në kërkesën e tij të datës 7.12.2016. Në datën 18.1.2017, i pandehuri A.K ka depozituar në sekretarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan një kërkesë me anë të së cilës ka kërkuar zëvendësimin e prokurorit Neritan Hoxha në këtë procedim me një prokuror tjetër... Bazuar në nenin 27, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, kam dhënë pëlqimin për zëvendësimin tim si prokuror në hetimin e procedimit penal nr. ***, datë 13.6.2015, ndaj të pandehurit A.K, i akuzuar për veprën penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal, duke i kërkuar drejtuesit të Prokurorisë të bëjë zëvendësimin me një prokuror tjetër të kësaj Prokurorie.

⁹⁷ Shihni dosjen sekrete të subjektit.

⁹⁸ Për më shumë referojuni shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

Drejtuesi i Prokurorisë me vendimin e datës 27.1.2017 ka vendosur zëvendësimin e subjektit të rivlerësimit, prokurorit Neritan Hoxha, me një prokuror tjetër të kësaj Prokurorie.

241. Pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, Komisioni vlerëson se ato janë bindëse.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

242. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, dosjeve të administruara nga Komisioni dhe denoncimeve të depozituara, trupi gjykues konstaton se subjekti në disa procedime nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale të subjektit. Komisioni, në lidhje me hetimin e procedimeve për veprën penale të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal, të kryera nga subjekti, vlerëson se është vendosur mosfillimi i procedimit penal ose pushimi i tij pa hetim ose pa kryer hetime të plota. Rezulton se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit që ka hetuar këto dosje, në disa raste ka interpretuar gabim ligjin dhe gjithashtu vendimet e marra prej tij nuk janë arsyetuar plotësisht, sipas kërkesave të Kodit të Procedurës Penale. Duke pasur parasysh legjislacionin e brendshëm dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, hetimi i rasteve që kanë të bëjnë me humbjen e jetës ose dëmtimin e rëndë të punonjësit nuk është i plotë, pasi nuk rezultojnë përpjekje serioze nga prokurori për të zbuluar se çfarë ka ndodhur. Në fakt, konstatohet se është mbërritur në përfundime të nxituara në disa raste në mungesë dhe të aktve të ekspertimit teknik. Kjo tregon mungesën e kapacitetit/aftësisë së prokurorit në aspektin e njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor⁹⁹. Rezulton se në vend që të respektoheshin parimet dhe vlerat/standardet më të larta të prokurorisë¹⁰⁰, të cilat përfshijnë detyrimin për të ndërmarrë veprime dhe për të pasur një rol aktiv në zbulimin e së vërtetës dhe detyrimin për të respektuar, mbrojtur dhe mbështetur dinjitetin njerëzor dhe të drejtat e njeriut, është shfaqur neglizhencë e vazhdueshme në një seri të qartë dhe të vazhdueshme vendimesh. Gjithashtu, Komisioni vlerëson se një shpërfillje e tillë dhe neglizhim ndaj humbjes së jetëve njerëzore nuk përputhet me rolin e prokurorit.

243. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit përbën një model pune aq të dobët, saqë rrezikon ose shkel të drejtat e qytetarëve. Me këtë model pune prokurori dështon së kryeri detyrën e tij për të respektuar, mbrojtur dhe mbështetur dinjitetin njerëzor dhe të drejtat e njeriut. Prandaj, nisur nga konkluzionet e nxjerra nga analizimi i dosjeve të mësipërme, Komisioni çmon se pozita e subjektit duhet të konsiderohet në vështrim të nenit E, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili citon: “...5. Në rast se subjekti i rivlerësimit kryen veprime për të penguar ose vështirësuar vlerësimin e tij ose rezulton se ka njohuri, aftësi, gjykim, qëndrime, ose një model pune aq të dobët saqë rrezikon ose cenon të drejtat e qytetarëve, ai konsiderohet i papërshtatshëm për të ushtruar funksionin. Në këtë rast zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.

244. Shkeljet e konstatuara në kriterin e aftësive profesionale nuk janë të tilla që mjaftojnë për të kualifikuar subjektin e rivlerësimit sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave.

⁹⁹ Referojuni pikës 3 të nenit 73 “Aftësitë profesionale të prokurorit” të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

¹⁰⁰ Referojuni nenit 75 “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

lidhje me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë

245. Në vlerësimin tërësor të procedurave lidhur me cenimin e besimit të publikut, duke vlerësuar në tërësi kriterin e pasurisë dhe atë profesional për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuar së bashku e të para në harmoni me njëra-tjetrën, tregojnë për një sjellje të subjektit të rivlerësimit në raport me detyrën, e cila do të ishte e papranueshme për të pasur besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe te roli i subjektit, si një funksionar i denjë i këtij sistemi.

246. Në këto rrethana përfshihet problematika e konstatuar në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë të evidentuara më lart, që lidhen me: (i) deklaratimet kontradiktore të subjektit në lidhje me kohën e njohjes me bashkëjetuesen e tij, si dhe përpjekjen për të përjashtuar veten e tij nga përgjegjësia në lidhje me pasuritë e krijuara prej saj; (ii) depozitimin nga ana e tij të deklaratave noteriale të cilat nuk përputhen me vetë deklaratimet e subjektit, por as me dokumentacionin e administruar nga Komisioni; (iii) deklaratimet kontradiktore në lidhje me të ardhurat dhe pasuritë e prindërve të tij; (iv) mungesën e burimeve të ligjshme të pasurive, për të cilat Komisioni ka vlerësuar se nuk mund të përbëjnë shkak më vete për shkarkimin e subjektit. Në këtë vlerësim të Komisionit mbahet në konsideratë sjellja e subjektit në lidhje me pasuritë e regjistruara formalisht në pronësi të prindërve të tij, për të cilat nga hetimi rezultoi se subjekti ka tentuar t'i fshehë ose t'i paraqesë në mënyrë të pasaktë këto pasuri, duke deklaruar të dhëna të pasakta ose duke mos i deklaruar fare ato, me qëllim që procesi i kontrollit e verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të tij dhe, për pasojë, Komisioni ngriti dyshime se këto pasuri mund të jenë në pronësi/posedim të fshehur të subjektit të rivlerësimit, por për shkak se nuk u provua plotësisht ky dyshim, ato do të konsiderohen në tërësi të rivlerësimit të subjektit.

246.1 Gjithashtu, subjekti ka shfaqur mangësi të theksuara në lidhje me vlerësimin profesional, të cilat janë analizuar gjerësisht në këtë vendim, mangësi të cilat në këndvështrim të Komisionit nuk mund të korrigjohen përmes programit njëvjeçar të Magjistraturës.

247. Në vlerësimin e Komisionit, këto rrethana do të përbënin mjaftueshëm një bazë të dhënash, mbi të cilën mund të konkludohej se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, edhe sikur të mos ekzistonin rrethanat që kanë bërë të mundur aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke bërë të zbatueshëm në mënyrë autonome paragrafin 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si një prej shkaqeve të shkarkimit nga detyra të subjektit.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve, konkludon se:

- i. Subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 , rezulton se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, referuar nenit 4, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronja “c”, si dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Neritan Hoxha, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës të Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 18.7.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Genta Tafa (BUNGO)
Relatore

Roland ILIA
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha